Tomorri qielll

perëndie

Xhevahir Cirongu

Botime, Jozef- Durrës 2018

Titulli:
Tomorri - qiell perëndie
Autor:
Xhevahir Cirongu
Redaktor:
Skënder Kapiti
Kopertina:
Anxhela Cirongu
Botues:
Jozef, Durrë 2018
ISBN 978 – 9928 – 241 – 80- 1

Falnderoj nga zemra ime zotin Petrit Bako që mundësoi botimin e librit.
I jam shumë mirënjohës atij.
Autori

Shkurt, 2018

Fjalë për autorin

Autori i librit që keni në dorë,Xhevahir Cirongu është i afirmuar në fushën e publicistikës në shtypin lokal dhe atë qëndror.Ka gamë të gjërë lëvrimi në fushën e prozës si: tregimin,reportazhin, skicën, essen-në, etj. Pasqyron në mediat elektronike shkrime të karakterit social duke pasqyruar evenimente kulturore, përkujtimore datash historike dhe festash. Në fushën e publiçistikës ka mbi dyzet vite që boton brenda kufijve të Shqipërisë dhe jashtë, deri në revistën ''Dituria'' QKSH ''Migjeni'' Boras- Suedi.
Në shkrime, konstatohet kultura e të shkruarit sa më thjesht, sa më qartë, sa më kuptueshëm pa pasur ngarkesa të panevojshme në ndërtimin e fjalisë. Veç prozës lëvron me sukses edhe poezinë të cilën hera-herës e gjen të botuar në shtypin letrar. Në poezi shfaqet me unin e tij poetik duke trajtuar tema me të cilat spikat individualiteti i formuar, ku joshet edhe lexuesi. Kjo është meritë e talentit. Me shkrimet e tija kontribon edhe në kritikën letrare e reçensione librash. Merr pjesë në përurime volumesh të autorëve të tjerë duke u alternuar të shprehi mendimet e veta vlerësuese, duke u treguar sa më modest dhe objektiv në tubime të tilla.
Ka botuar volume me poezi dhe prozë, ku është pritur mirë nga lexuesi dhe kritika. Ky volum ka larmi tematike të shprehur në gjini të ndryshme proze.
Duke përfunduar e uroj të praktikojë, po kaq suksesshëri gjini më të mëdha lëvrimi si në novelë dhe roman.

Nebi Dragoti

Kritik

‘’ Drenica e Durrësit”- djepi i historisë dhe e lirisë së Kosovës

Sapo kanë çelur lulet e marsit të vitit 2014!Dielli buzëqesh,por edhe të ‘’puthë’’ me rreze të ngrohta. Flladi i erës shpërndan aromën e luleve në atmosferë. Edhe pemët janë ngarkuar me bisqet e reja të cilat mbajnë mbi shpatullat e tyre kurorat e gonxheve të luleve. Lulet e marsit te ne shqiptarët janë të veçanta. Ato na sollën shkollën e parë shqipe në 1887. Eshtë marsi i luleve të pranverës që i gëzohemi shumë fakteve historike. Marsi i këtij viti 2014, vjen edhe më i bukur.Ai na zgjon kujtimet tona në dekada. Pikërisht, është marsi i luleve që solli lirinë e fatin dhe lirinë e Kosovës. Ai kujton ditët e stuhishme të atij viti, ku vëllezrit ‘’Kapiti’’ në durrës u bënë mbrojtësit e flaktë e ambasadorë për çështjen kombëtare. Ndërsa poeti Agim Bajrami lexon vargje të shkëputura nga libri ‘’Atdhetarizmi jeton në përjetësi’’ me autor Bedri Tahiri, nga Vushtrria e Kosovës.

‘’Ja te ndrin atje
Në ngjyrë të flamurit,
Si një krahë shqiponje
Dalë nga palc e gurit’’.
……
‘’Shtëpia e lirisë
Me lule dhe det,
Si një krahë shqiponje
Historisë i flet’’.

Lexon librin me titull’’Atdhetarizmi jeton në përjetësi’’, shumëkush sot ndjen ndjenjën e krenarisë, sepse aty pulson historia e popullit tonë në shekuj.

Për këtë,Xhevahir Spahiu, poet e akademik shprehet kështu:

‘’Dernica’’ e Durrësit është qendra kryesore e frymëzimeve atdhetare këtu buzë detit, është Tempull atdhetarie.Më vjen mirë që kjo shtëpi lirie dhe tempull i atdhetarisë, pikërisht u pagëzua nga poetët dhe artistët.Ajo e ndërshqiptarizoi këtë vend, nga i cili buroi jetësimi i çështjes sonë madhore,çlirimi kombëtar.’’

‘’Derenica’’ e Durrësit është djepi i historisë dhe i atdhedashurisë, por edhe e kulturës së kombit tonë. Një thesar që duhet vlerësuar nga të gjithë, sepse ajo është e të gjithëve. Vetiu del pyetja:Kur do legalizohet Shtëpi Muze? Kjo pyetje na mundon të gjthëve prej vitesh. Lulet e lirisë së Kosovës çelin në çdo stinë atje te ‘’Dernica’’ e Durrësit, sepse ujiten nga gjaku i 2400 dëshmorëve të UÇK-së.

Shpresojmë se qeveria e ‘’Rilindjes’’në Shqipëri dhe ajo e Kosovës, do e thonë fjalën e tyre në këtë 15 vjetor të çlirimit të Kosovës.

Foto nga e majta në të djathtë: Xhevahir Cirongu,ish kryetari i Këshillit Bashkiak Durrës z. Edmond Agolli,poeti Agim Bajrami, para Monumentit të Ushtarit të Panjohur të UÇK-së te Drenica në Durrës.

Njeriu që udhëton drejt shekullit .....

(Kujton në atë rrugëtim copëza nga jeta, 92 vjeçari, Niazi Braçaj)
Një ngjarje plot dhimbje,por atje lind edhe gëzimi!...

Të duket sikur **Muzhëncka** është fshehur në atë thelluke,ku heshturazi banorët e saj kanë ndërtuar jetën e tyre ashtu si u duhet.Ndonëse e kaluara i kishte fundosur të gjithë në varfëri;në vitet e pasçlirimit u bënë të gjitha familjet model,ku autoritetet organizonin disa seminare për ta bërë të gjithë Skraparin si Muzhëncka.Edhe pse në punën e hallet e tyre,ushtritë e huaja,që hynin e dilnin në Shqipëri si në shtëpinë e tyre,nuk i linin rehat.Kërkonin bukë nga fukarenjtë,por kërkonin edhe ato që nuk i kishin.Për këtë arsye,i dogjën e i vranë barbarisht.

Në këtë situatë të krijuar,familja e **Qerim Braçajt,**ashtu si gjithë familjet e fshatrave të asaj zone,për t'i shpëtuar barbarizmave të andartëve grekë mori rrugën e mërgimit drejt Vlorës. Në këmbë me fëmijë në krahë;sepse rrugë dhe komunikacion nuk kishte,dhe mbas disa ditëve udhëtimi,të lodhur e të raskapitur,mbrrijnë në fshatin Vranisht të Qarkut të Vlorës,ku aty u strehuanë në një familje mikpritëse dhe bujare.
- U deshën shtatë muaj pa të ktheheshin në vatrat e tyre,që i gjetën të shkrumbosura., - na thotë në rrëfenjat e tija Niazi Braçaj.
Ata nuk i harrojnë nderin e mikpritjen e vlonjatëve,por as dhimbjet që u shkaktuan nga ai largim brutal.**Qerimit** i mbeti një vajzë në varrezat e një fshati të **Mallakastrës.**
- Dhimbjet të japin ndonjëherë edhe forcë e krenari,- psherëtin prapë ai.
Dhe vazhdon së treguari:
- Kur erdhën në **Muzhënckë** te **Çuka e Haskos,**akoma po qëndronte një postë e korofillëkëve grekë,prandaj u strehuan për disa ditë në fshatin **Zogas** tek **Turhan Hysa;**derisa u larguan hordhitë greke nga **Muzhëncka.**E vetmja pasuri që u kishte mbetur,ishte një çadër,të cilën e vendosi në themelet e shtëpisë.Kur u kthye në fshat, **Qerimit** i ndodhi një tjetër fatkeqësi.Atij i vdiq gruaja,**Xhemikua,**duke i lënë dy djem dhe një vajzë.Më i madhi,**Cenua,**9-vjeç,të cilin e detyroj të martohet shumë shpejt për të rregulluar dhe rritur fëmijët.

Në vitin 1918 **Qerimi** u martua me **Fatime Sheme Myftari** nga **Visocka,**një grua nikoqire,bujare,mikpritëse,punto re dhe shumë e pastër.Mbas disa kohrave akoma në varfëri,më datën 1 Janar 1920-ës,lindi **Niaziu.**nën mbrojtjen e së vetmes pasuri që kishte, çadrën!
Lindja e djalit në familje ishte një gëzim i madh, dhe sihariqi i lindjes u përhap me disa të shtëna pushke,që u zbrazën në lagjen **Braçaj.**Sipas zakonit,të nesrmen e në vazhdim filluan gratë e fshatit të vinin për urim,me ndinjë sahan me petulla,apo byreksheqere.Mbas disa ditëve u mblodhën shokët dhe miqësia për t'i vendosur emrin djalit.Sipas zakonit në krye të djepit nën kokë të djalit; i vendosënin një armë(revolver), një abetare dhe një laps,simbole këto të trimërisë dhe të diturisë.
Kur xhaxha **Malua,**,më i afërti dhe më i moshuari shkoi tek kreu i djepit për të thyer poganikun(një kulaç me petë dhe me një monedhë në të) tha me krenari:
-T'a gëzojë emrin, Niazi!

Berati- qytet muze. Mbrohet nga UNESCO.

Kur ishim fëmijë…..

Në atë kohë kaloi një periudhë e zymtë,në një varfëri të jashtzakonshme,hrë me bukë dhe herë pa bukë,me një veshje shumë të dobët,me një fustan sit ë vajzave,me një pale opinga me lëkurë lope,si në verë dhe në dimër.
Kohën më të madhe e kalonim në lëmë,ose tek shtëpia e **Koses,**duke luajtur.Ajo ishte një shtëpi e braktisur,pa njeri.Kur kishte uri,për të ngrënë,shkonim në shtëpi dhe i kërkonim nënës për të ngrënë.Ajo, kur kish më jepte ndonjë cope bukë, dhe kur s'kishte, u jepte ndonjë oshafe fëmijëve.Por, urinë e bukës na i largonte ajo puthja e ëmbël e nënës,e cila ngashëhrohej kur s'mund të na jepte një herë bukën.Kur vinte dreka,që të tre vaktet i kthente në dy.Megjithse në moshë të vogël,mundohesha t'u vija në ndihmë prindërve me ato punë që më lejonte mosha.
Ushqimi i përditshëmishte shumë i varfër.Në mëngjes,një tigan me çorbë(Tërhana) ku hanin 9 veta s'bashku,në drekë një sasi lakra të përzjera me pak mjell ose oriz,kur kishte,në darkë diçka më mirë,një jamake me fasule dhe në kohën e dimrit edhe me mish,mbasi në muajt nëntot-dhjetor,në çfarëdo gjendje të ishte,çdo shtëpi bënte pastërma.(mish i thatë).
Me gjithë kushtet e vështira ekonomike,**Qerimi** në maj të vitit 1925 filloi të ngrinte një shtëpi dy katshe, e cila me pak punime që iu bënë ballit jug-lindor; që u dëmtua nga bombardimet e luftës Italo-Greke në vitin 1940-1941,dhe sot mbas 82 vjetëve është në gjendje shumë të mirë.

Ngritja e shtëpisë e rëndoi akoma më shumë gjendjen ekonomike,mbasi muarëm dhe para borxh.Brenda vendit nuk mund të gjente ndonjë zgjidhje tjetër,dhe iu drejtua kurbetit. Prandaj,babai i nisi të dy djemtë e mëdhenjë në moshë më të rritur për mëgrim. **Cenua,**në vitin 1927 shkoi në **Stamboll**,dhe filloi të punojë tek një bahçevan, i cili prodhonte vetëm perime. Ai ishte **Mançe** nga **Surropunji** i Përmetit.

Qyteti – Çorovodë

Puna ishte shumë e rëndë,punonin 10-12 orë në ditë me kazmë,bel dhe lopatë.**Cenua** çonte koshat me zarzavate me krahë në treg dhe kur kthehej,koshat i mbushte me plehë për bahçen. **Sulua** shkoj në**Francë** ,me dajë **Ademin** në vitin 1929 dhe u vendos në vitin 1929 dhe u vendos në qytetin **Lion,**duke punuar në një fermë Franceze.Si **Cenua** dhe **Sulua** kishin mundur të grumbullonin një sasi të paktë lekësh,por shumë pak dhe u rikthyen në atdhe.**Cenua** në vitin 1931 dhe **Sulua** në vitin 1934, dhe iu nënshtruan punës në bujqësi.

Mësuesi im i parë, Jordan Misja nga Shkodra

Banorët e **Muzhënckës** janë shumë të hetur për dije dhe kulturë. Në mëgrim **Xhelal Halilaj,Zeqir Halilaj** dhe **Hysen Dervishi,** e ndonjë tjetër nga Amerika,të cilët me mund e sakrifica dërgonin abetaren në **Shqipëri** në adresën e **Seit Skënderit** në **Frashër,**dhe atje **Muzhënckallinjtë** kishin caktuar **Tefik Nona** për t'i marrë dhe shpërndarë në fshat.

Me këto abetare mësuan shkrim e këndim,**Hysen dhe Reshat Braçaj,Zyber Nona** e ndonjë tjetër.Por, dashuria e banorëve të **Muzhënckës** u bë realitet vetëm në vitin 1935, kur u hap shkolla e parë shqipe në **Malind,** me këmbënguljen dhe kontributin e dy fshatrave.

Ndërtimi i shkollës filloi dhe mbaroi në një kohë rekord,dhe në tetor të vitit 1933,shkolla ishte gati për të filluar vitin mësimor; por s'kishte mësues. Premtimet që kishte dhënë Ministria e Arsimit nuk po realizohej edhe pse banorët përsërisnin kërkesat e tyre.

''**N**e të nënëshkruarit pleqësi e katundeve **Malind** dhe **Muzhënckë** të nënprefekturës së **Skraparit,**me sakrificën e dy fshatrave,kemi ngritur këtu e tre vjet më parë një godinë shkollore sipas sistemit modern dhe numri i nxënësve në moshën shkollore është 60-70 nxënës'' (fotokopja në arkivin e muzeut Çorovodë).

Mbas shumë përpjekjesh, komisioni për ngritjen e shkollës gjeti mësues në **Tiranë,**një djalë i shkëlqyer i quajtur **Sinan Tafaj.** (Sot është Kryetar i Shoqatës së të verbërve të Shqipërisë, ky profesor).

Lumi Osum të magjeps me kanionet e tija. Aty shkojnë me qindra e mijra vizitorë

Pas shumë bisedave me të,ramë dakord dhe lidhën një kontratë të përbashktë për të ardhur në**Malind.**Për një kohë mësimi paguhej nga banorët e fshatit që kishin fëmijët në shkollë.Kështu, u realizua dëshira e banorëve.Dhe në shtator të vitit 1935, u hap shkolla e parë në **Malind.** Mbas një cermonie madhore me nxënësit,prindërit dhe banorët e dy fshatrave,filloi viti i Ri shkollor 1935-1936, në një mjedis të shkëlqyer.Kjo e ngrohu edhe më shumë atmosferën e atyre ditëve.

Në mbarim të simestrit,mësuesi,duke vlerësuar përparimin e disa nxënësve që ishin më të avancuar se shokët, vlerësoi dhe me provimin e seksionit të arsimit,i kaloi në klasën e dytë. Si:**Haki** e **Maliq Spahiu,Niazi Braçaj,Halil Halilaj** dhe **Nevruz Xhaferri** nga **Nikollara.**

- Këta nxënës edhe nga mosha ishin më të mëdhenjë se shokët e tjerë, tregon Xha Niaziu. Dhe kujimet e Xha Niaziut s'kanë të mbaruara. Dhe kujton me mallëngjim ato vite…..

-Të gjithë nxënësit ishin shumë të sjellshëm në mësime, me gjithë kushtet e vështira që kishin si:mungesa e librave,fletoreve,energjisë elektrike,etj.Ishte e jashtëzakonshme, që ndonjë nxënës të shkonte në shkollë pa bërë detyrat,në shkollë shkonin të pastër,me disiplinë në klasë dhe jashtë saj,të dashur dhe të respektuar me njërin- tjetrin,me të moshuarit dhe në veçanti me mësuesin.

- Shkollën e mbarova në muajin maj të vitit **1938 –të,** me rezultate shumë të mira dhe për tre vjet bëra katër klasë.Dëshira dhe vullneti nuk mungonin për të vazhduar studimet,po mundësitë nuk i kasha.Shumë herë e shqetësoja babanë dhe **Cenon** për preokupimin tim që kasha për të vazhduar shkollën,por dhe ata kishin dëshirë që unë të vazhdoja.Pas shumë përpjekesh u gjend rruga që unë të vazhdoja shkollën në **Frashër** tek Abaz Abazi.Shkolla ishte me pesë klasë.Si **Abazi** dhe shoqja e tij,**Ruzja,**më kanë mbajtur dhe trajtuar si djalin e tyre të vetëm që e quanin **Haxhi.**Kësaj familje u jam mirënjohës për jetë.

Nga klasa e parë në të katërt, i drejtonte mësuesi **Kadri Skënderi,**djalë fshati,kurse klasën e pestë e mbante mësues **Jordan Misja.** Një djalë nga Shkodra,një mësues puntor,i sjellshëm,komunikues me njerëzit dhe me horizont të gjerë dijesh.Shkolla filloj dhe vazhdoi normalisht në shtator 1938 deri më 7 prill të 1939 kur Italia fashiste sulmoi dhe pushtoi Shqipërinë.Mbasi mbaruam orën e parë të mësimit,kishim dalë për pushim në oborrin e shkollës,por papritur në perëndim të

fshatit **Frashër,** dalluam 9 aeroplanë të ndarë në tre grupe që fluturonin në drejtimin tonë, dhe mbasi bënë një rrutullim mbi **Frashër-Zavalan,dhe në zonën e Kolonjës,**u larguan andej nga kishin ardhur.

Nxënësit deri në atë moment nuk dinin gjë se kush ishin dhe pse fluturonin ata aeroplanë në vendin tonë.Mësuesi pa mbaruar mirë koha e pushimit,i ulur mbi një gur, në mendime dhe pa e parë në sy i thotë kujdestarit të klasës:**Polikron!** T'i bjeri borijes(ziles)që të hyjnë nxënësit në klasë.

Mësuesi na shpjegoi se ata aeroplanë ishin italianë.Demostrojnë forcën e tyre dhe bëjnë presion mbi popullin tonë;mbasi fashizmi Italian sulmoj Shqipërinë.Si na dha disa këshilla,prej atij moment shkolla u mbyll.Në klasë ishin tre nxënës nga rrethe të tjera.Mësuesi i pyeti : --Ju,do të qëdroni pranë personave që ju kanë në kujdestari,apo do të shkoni pranë familjeve tuaja?

Të tre iu përgjegjëm me një zë:

-Ne do të shkojmë pranë familjeve tona.

Atëherë mësuesi na udhëzoi e na dha dorën,na përqafoj e na uroj rrugë të mbarë.

Në fund me keqardhje na tha:

-Në shkollë do të vini kur të njoftojmë ne!

E kam shumë të freskët atë ditë të 7 prillit të vitit 1939,kur nxënësit e një shkolle në një fshat të vogël e të ndarë në dy grupe,bisedonin kokë më kokë me mësuesit e tyre. **Jordan Misja** na fliste me urrejtje të madhe për pushtimin fashist të Shqipërisë e të tradhëtuar e lënë në rrugë nga mbreti Zog.

Mbas disa ditëve muarëm lajmin se do të fillonte mësimi.Shkuam në shkollë në vazhdim të vitit mësimor.Koha e shkëputjes nuk qe shumë e gjatë e gjatë,po mësuesi jonë tani na dukej më i pjekur,më i sjellshëm dhe më burrëror.
Orën e parë të mësimit e kaluam me zbarkimin dhe pushtimin e atdheut,për mbretin zog që nuk hodhi asnjë pushkë kundër pushtuesit,po grabiti thesarin që kish në bankën e shtetit,dhe së bashku me suitën e tij mori arratinë drejt Greqisë.
***
Mësues **Jordan Misja** më ftoj për një vizitë në shtëpi.Pasi u përshëndetëm me nënën dhe motrën e tij,**Savkën,**më prezantoi mua duke u thënë:Eshtë një shoku im! U mendova pse nuk u tha nxënësi im,po shoku im?! Heshtjen e prishi po vetë mësuesi në atë çast e më pyeti:
-Shoku **Niazi,**me çfarë t'u qeras!?
-Faleminderit,zoti mësues.Nuk dua asgjë!
Ai më tha: në klasë përdorim fjalën zotni,ndërsa jashtë mësimit fjalën shok.Mbas kësaj bisede i tha **Savkës** që t'më qeraste mua.Ajo më solli një pjatë me mjaltë dhe pak arra.Mora nja dy lugë dhe çava disa nga kokrrat e arrëve.Pata emocione,aepse ishte hera e parë në familjen e mësues **Jordanit.**Por nëna e Jordanit m'i afroi pësëri pjatën e qerasjes,ngaqë unë i largove ato. Jordani çau nja dy kokrra arra dhe i hodhi në pjatën e mjaltit dhe më ftoj që të vazhdoja.Po unë nuk munda të vazhdoja më.Gjatë bisedës mësuesi më tha se,a ke dëshirë të dëgjosh muzikë!? Pa u menduar fare i thashë si urdhëron. Ai u ngrit dhe mori një radio me bateri,e hapi dhe po dëgjonim një muzikë që nuk po më tërhiqte fare.Deri në atë kohë nuk kIsha parë dhe dëgjuar zërin e saj.Kur mbaroj mësimi më tha: A të pëlqeu muzika? Aprovova me një të tundur kokën. Dhe me kaq u ndamë.

Njeriu që udhëton drejt shekullit.
(Niazi Braçaj)

Një ditë tjetër mësuesi më tha duke më ftuar që mbasdite të shkoja tek shtëpija e tij.Mbasi kaluam një kohë me biseda dhe dëgjonim muzikë, ai filloj të kërkonte stacione të tjera.Tani më tha,do të dëgjojmë Radio Moskën.Për herë të parë nga radio e **Jordanit** kam dëgjuar deklaratën e qeverisë sovjetike, e cila dënonte Italinë fashiste që sulmoj Shqipërinë.Kjo deklaratë jepej nëpërmjet Radio Londrës.Kur mbaroj dhënia e deklaratës,mësuesi filloj të m'a shpjegonte me fjalët e veta.
Shkollën e mbarova me rezultate shumë të mira,gjë e cila më ka shërbyer shumë gjatë jetës sime, - kujton i përlotur xha Niaziu ata vite.
Por, mësuesi **Jordan Misja** udhëton e kujtohet në çdo fjalë e shkronjë.

Një udhëtim që më zgjoi kujtime….!

Simbas njoftimit të nismëtarëve,**Muahrrem e Daut Nona, dhe Kastriot Drvishi,ftohemi për një takim brezash në vendlindjen tonë në Muzhënckë të Skraparit.**
Megjithëse, mbi supe i rrinë si pëllumba 90 vitet, vendosi të shkoj në takimin midis vëllezërve, motrave dhe miqëve të ftuar,që merrnin pjesë në atë takim më 13 Shtator 2009. -
Ishte data 11 Shtator,u nisa nga Durrësi me një nga shokët më të ngushtë të jetës,**Bashkim Halilaj,-** na tregon Niazi Braçaj.

Gjatë udhëtimit për në Berat,u përlota kur pashë lapidarian e **Margarita dhe Kristaq Tutulani.** Ndjeva shumë dhimbje shpirtërore në ato çaste!.Mergarita dhe Kristaqi linden në qytetin e Beratit, në një familje patriotike e atdhetare. Pushtimin e Shqipërisë, më 7 prill të vitit 1939, e pritën me urrejtie e indinjatë. Së bashku me shumë të tjerë patriotë luftuan kundër fashizmit e ushtrisë italiane.Në shkolla e zyra, në rrugët e rrugica shkruanin parrulla kundër fashizmit.Grisnin fotografitë e Duçes etj.Në shkollë nuk pranonin të nderonin ''Alla Romane''. Nën hundën e armikut punonin ditë e natë për të hedhur të rinjtë kundër fashizmit.
-Vetëm lufta partizane mund të na sjelli lirinë,- u thoshin moshatarëve dhe njerëzve të thjeshtë e patriot që donin atdheun,**Margarita e Kristaq Tutulani.**
Veprimtaria e tyre kundër fashizmit,ra në sy të spiunëve të Gestapos, e cila i arrestoi, i torturoi me metoda më ç'njerëzore. Por nga goja e tyre nuk mundën të mësonin asgjë për shokët e tyre ilagalë.Për bazat e Partisë Komuniste Shqiptare dhe të njësiteve guerile në qytet.Gestapua i futi në makina të blinduara dhe në fshehtësi më të madhe i çoi dhe i pushkatoi në fshatin Gosë të Kavajës.
Për çështjen e madhe të çlirimit të Atdheut, nga pushtyesit e huaj,Margarita dhe Kristaq Tutulani, mbetën simbole të frymëzimit dhe atdhetarizmit për të gjithë brezat pasardhës.
…Arrijmë para varrezave të dëshmorëve të Atdheut! Para nesh shfaqet një Lapidar madhështor në hyrje të qytetit të Beratit. Na kujton 20 Shtatorin e vitit 1943.Shtabi i Përgjithshëm kishte dhënë urdhërin që në Qarkun e Beratit, të krijohej Batalioni i Rinisë, me partizanë të moshës 16-19 vjeçë.Në ditët e para të shtatorit,kishin ardhur komanda e batalionit dhe një pjesë e partizanëve.Shtabi i Qarkut Berat, më datën 14 shtator i jep urdhër komandës së batalionit,akoma të pakrijuar, të shkonte në**Bogovë të Skraparit,** për të marrë armatimin e një njësije të ushtrisë italiane që ndodhej në atë zonë.E cila, një ditë më parë kishte kapitulluar pa kushte.Në takimin e parë që bëri komanda me komandantin e tyre kolonelin''X'', i kërkoj të dorëzonte armatimin.Koloneli''X'' u tregua i gatshëm, por vetëm me një premtim: Që kuadri oficer italian të mbante armët personale. Kërkesa e tij nuk u pranua. Kështu filloi marrja në dorëzim e armatimit nga forcat partizane.
Me armatimin e marrë aty u armatosën partizanët vullentarë që vinin nga **Bogova, Fieri, Lushnja,Kuçova,Berati e Skrapari.**
Më datën 20 Shtator 1943-it, në afërsi të ish centralit elektrik, në prezencë të autoriteteve të Qarkut Berat dhe banorëve të këtij qyteti, u krijua Batalioni i Rinisë''**Margarita Tutulani'',** me një efektiv prej 150 partizanë e partizane.
Nuk kishte kaluar as edhe një muaj,nga krijimi i batalionit, dhe ushtria gjermane me bashkëpuntorët e tij,sulmoi në befasi me forca të shumta e mjete luftarake qytetin e Beratit. Sulmi filloi në orët e para të mëngjesit.Ishte data 14 tetot 1943.Partizanët e përballuan me sukses këtë sulëm.Armiku qe superior si në forca njerëzore, ashtu edhe në teknikën e armatimit luftarak. Dy autoblinda dhe një tank depërtuan në thellësi të mbrojtjes së batalionit.Ata zunë Urën e Goricës, dhe vazhduan drejt qendrës së qytetit për në gazermat e Uznovës.Dy aeroplanë luftarakë fluturuan atë ditë shumë ulët mbi qytet.Na bënin presion psikologjik.Por vendosmëria e jonë ishte e lartë ndaj këtij presioni.Në këto kushte filloj rrugën e lavdishme Batalioni i Rinisë''Margarita Tutulani''.Gjatë këtij luftimi, ushtria gjermane pati të vrarë,të plagosur dhe të zënë shumë robër.Në veçanti ishte qëndrimi heroik i partizanëve gjatë operacionit të demerit në muajin Dhjetor, dhe atë të muajit Qërshor 1944. Ku përballoj luftime të ashpra e të përgjakshme.Edhe nga forcat tona mbetën të vrarë e të plagosur. 13

Në Çorovodë....drejtë Muzhënckës

Në Çorovodë takojmë shumë shokë dhe miq.Së bashku me ta pimë nga një kafe tek klubi veror: në ajër të pastër,ujë të freskët, pastëri shembullore,etj.
U ndava me ta dhe shkova tek **Myrtezai,(vëllai cili u nda nga jeta para disa ditësh).** Sa herë që shkoja aty, do rrinim deri në orët e vona të natës. Biseda rrithte si lumi i Osumit. Një bisedë e ëmbël, si vetë buka e tokës sonë. Në mëngjes rreth orës dhjetë u nisëm drejt fshatit **Muzhënckë.**
Në këtë udhëtim Myrtezai nuk më shoqëroi,se vuante nga gjunjët.Kishte dhimbje.Udhën e kaluam duke shijuar bukuritë e natyrës: Kanionet e lumit Osum , dhe gjelbërimin e mrekullueshëm të asaj natyre jetëdhënse.
Në Çorovodë më erdhën djemtë: **Agimi me Yllin.** Makina më çoi deri tek dera e shtëpisë. Në fshat na priste **Enveri me Karafilin,** të cilët kanë shumë kohë që banojnë në **Tiranë,** me gjithë fëmijtë.Po shtëpia e tyre qëndronte ashtu siç e mbante e ndjera **Xhevri,** disa vite më parë.Ishte e pastër.Çdo gjë në vendin e vetë dhe nuk i mungonte asgjë. Ata jetonin në Tiranë, po mendjen e kanë në Muzhënckë.!Mbasi pushuam pakë, hamë drekën dhe së bashku me Enverin dhe djemtë duallëm për të parë shtëpinë ku kam jetuar kohë më parë.Nga pamja e jashtme shtëpia nuk kishte pësuar asnjë ndryshim.Hapa portën e jashtme dhe hyra në oborr.Një pamje tjetër jo e mirë m'u shfaq para syve.Mollët,hurmat dhe rrushi që dikur zbukuronin shtëpinë, mbi 60 përqind e tyre ishin tharë.Lulet e dikurshme nuk ekzistonin.Këto më lanë përshtypje se,nuk kishte Zot shtëpie! Brenda nëpër dhoma nuk hyra dot se dera ishte mbyllur me një dryn të madh.I shkova përqark shtëpisë duke shikuar me mall atë vend të dashur! Arra përballë portës ishte tharë dhe e kishin prerë. Dardha me dy llojë prodhime, kishte pësuar fatin e arrës.Mbi derickë, rrushtë, molla, qershia, dhe kumbullat, ishin pocaqisur shumë keq.Bari dhe ferrat i kishin bllokuar të gjitha.Kaluam në disa vende, kudo e njëjta gjë: mungonte dora e njeriut!.....
Më së fundi, kaluam në krye të fshatit, aty në vendin e quajtur **Fusha e Vogël, dhe Fusha e Madhe.**Që nga ai vend me hapsirë të madhe shikon Malin e Miçanit që ndan pamjen me Kolonjën.Më tutje qafën e Martës, që ndan me Korçën, Trebeshina që ndan me Përmetin. Pastaj vazhdon me Dhëmbelin që ndan me Gjirokastrën dhe Mali i Tomorrit që ndan me Beratin.Djemtë ishin shumë kuriozë dhe bënin pyetje të shumta.Gjatë kthimit takojmë **Bashkimin,** që dhe ai kishte bërë një xhiro në disa vende.Darkën e kaluam tek**Enveri.**Aty kaluam deri në orët e vona të asaj mbrëmje.
Më datën 13 Shtator u grumbulluam tek shkolla, dhe prej aty do të shkonim tek Rezervuari, ku ishte organizuar takimi. **Agimi** dhe **Ylli shkuan tek varrezat ku prehen gjyshërit, xhaxhallarë** e vendosën buqeta me lule.Fjalën e takimit e hapi Kryetari i fshatit **Mydin Halilaj.**Në atë takim folën edhe shumë shokë të tjerë.Si: **Syrja Nona, Daut Nona,Ylli Braçaj, Engjëll Halilaj, Rustem Dashi etj.**Në diskutimet e disa shokëve u theksua me forcë përfundimi i historikut të fshatit Muzhënckë. Ai ka shumë vite që eshtë bërë, por do disa ndryshime pasë këtej, ku duhen pasqyruar edhe ngjarje të tjera.Materiali i historikut të fshatit Muzhënckë, u përpunua nga një grup shokësh me në krye **Rushit Dervishi.**Ai u diskutua me të gjithë banorët e fshatit në Muzhënckë dhe rrethe të ndryshme ku ndodhen me banin banorët e fshatit.Mbas pyetjeve dhe diskutimeve maketit iu bënë edhe disa vrejtje, ku grupi i punës i mori në kosideratë.

Ky material mbeti për një kohë në shtëpinë e shokut Rushit.Me këmbënguljen time, materiali u muarë në vitin 2007 dhe më 2008, me kërkesën e tij Barjam Halilaj e mori materialin dhe u zotua t'a përpunonte brenda pesë muajve.Mbas të rishikohesh edhe një herë nga banorët e fshatit, do shkonte për ta botuar. **Pse të mbetet jetim ky historik i fshatit tonë?!**
Ku ishte shqetësimi i xha Niaziut, por edhe të tjerëve banorë të atij fshati.
Muzhëncka ka shumë kuadro të afta si: Arsimtarë, mjekë, inxhinierë, diplomat, ushtarakë, etj.që nuk iu mungojnë aftësitë për kompletimin dhe plotësimin e historikut të vendlindjes të tyre.Në këtë takim u theksua që çdo banor të bënte gjinezën e familjes së vetë sipas fiseve të fshatit.E dyta u kërkua që të bashkëpunomim me kryeplakun e fshatit që ndërmjetsimin me Komunën për krijimin e një vendi nga ku grupi i punës të bënte edhe takimet e tyre rreth këtij problem. Aty të zhvilloheshin edhe takime brezash.
Në takim u vendos që e djela e fundit të muajit Qërshor të jetë si ditë **Takimi i Brezave** në fshatin **Muzhënckë.** Mbas mbarimit të takimit u shpërndamë në grupe për të ngrënë drekën e cila vazhdoj deri vonë në një ambjent mikëpritës dhe bujar.
Nuk ka shumë kohë, dhe përsëri Niaziu shkon me disa të afërm në Muzhënckë e Çorovodë. Moshës së thyer të viteve u thotë ''Ndal'' se, unë jam ende i ri, e do udhëtoj atje drejtë vendlindjes sime. Takohet me njerëz e të gjithave brezave.Kudo mikëpritje! Kudo dashuri njerëzore.....
Me gota në dorë, ngritën dolli sipas zakonit Skraparas, për shëndetin e gjithë shqiptarëve që punojnë e jetojnë kudo nëpër botë. Por edhe për 100 vjetorin e Pavarsisë, për shqiptarët e të gjithave trevave: **Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, e Çamëri.**
Të gjitha këto u derdhën në djepin e këngës Tomarriane, me betimin''Baba Tomorr''.
Mbas ndarjes vëllazërore me ta, u nisëm për në brigjet e detit Adriatik në Durrësi.
Edhe Gjika Pastërma, i cili është nga Ziçishti i Korçës, por ka kohë që njihet me Niaziun, ka shumë për të na thënë për këtë njeri energjik që udhëton drejt shekullit.
-Me heshtjen e tija, Niaziu flet shumë,- na thotë në bisedë e sipër Gjika.

Doktor Ilir Shani – duararti që sfidon sëmundjet…!

Dikush trokiti në derën e doktor Ilir Shani me nxitim.Të trokiturat nuk reshtnin,e diçka ato luteshin për ndihmë.Një pacient ishte në gjendje shumë të rëndë shëndetësore. Në këtë kohë doktor Iliri po bënte kontrollvizitë të pacientëve të vetë që ishin shtruar në spitalin Rajonal të Qytetit të Durrësit.

-Hyr brenda! ,të lutem,- u dëgjua zëri i doktor Ilirit. Ai ashtu me pincetën në duar e fashon doli nxitimthi e hapi derën e dhomës së vizitës.Ndihmës mjekja në këtë kohë me jod po mjekonte plagën e të sëmurit.

-Më falni për shqetësimin!Doktor Ilir Shanin deshëm të takonim,-foli shpejt e shpejt i sapo ardhuri.Vimë nga Lushnja dhe,e,e,e….

-Eja,eja,-futu brenda.Qytetari u ul në karrigen aty afër.

-Ç'hall ke?! Unë jam Ilir Shani.

-Të lutem,gëzohem që të njoha! Merre këtë letër,ma ka rekumanduar doktor……

Doktor Iliri i hodhi një sy ashtu nxitimthi,por vëmendjen nuk e ndante edhe tek pacientët e tjerë.Pastaj iu drejtua të sapo ardhurit:

-Mos u shqetëso!I sëmuri do të bëhet shëndosh e mirë.-Ku është pacienti,-foli ngadalë doktor Iliri,sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

-Ja aty,në koridor,- iu përgjegj qytetari nga Lushnja.

-Silleni brenda për vizitë,-urdhëroi më së fundi ai.Pas vizitës infermierja i bëri një qetësues.I sëmuri kishte kriza nga gurët që kishte në tëmth. Si u qetësua nga dhimbjet,pacienti u shtrua në spital. I sapo ardhuri nga Plugu i Lushnjes qytetarin e quanin Islam Bako. Një burrë rreth të 75 vite që mbante mbi shpatulla;me një karakter të fortë e dashamirës ndaj personelit shëndetësor.

Doktor Ilir Shani ka lindur në vitin 1966 në Qytetin e Durrësit. Kur dilte me shokët kodrave buzëdetit të ngarkuara me ullinj e lule shumëngjyrshe i bënte pyetje vetes:
''Nga ullinjtë me vajin e tyre shërohen plagë,poe edhe lulet të zgjatin jetën.Por….lulet janë delikat e duan kujdes që tu zgjasim jetën…! Kështu edhe njerëzit duanë shërim ndaj sëmundjeve apo plagëve të ndryshme;që edhe ata të jetojnë po sa ullinjtë e kodrave!''
Ishte i vogël në ato vite, kur me vete treste në mendje këto fjalë.Një ditë në oborin e shtëpisë Iliri këputi një gonxhe karafili që ishte mbjellë në vazo.Ai po meditonte.
- Pse po mendohesh more bir,-i thonë në atë çast nëna e baba. S'ka gjë se këpute lulen se karafili lind gonxhe të tjera,- i thanë prapë prindrit në një zë. Pastaj me të qeshur i thanë se kur të rritesh do bëhesh doktor! Në këto çaste Iliri nuk foli. Si u mendua pak, më s'fundi iu ktheu përgjigje:
-Po,po dëshira ime është që të bëhem doktor kur të rritem,që t'u shërbej juve si prindër e njerzëve të tjerë…..! Duke dëgjuar këto fjalë prekëse nga djali i tyre me trup të imtë gati sa nuk fluturuan nga gëzimi prindërit e Ilirit.
-Epo mbarë të shkoftë e t'u realizoftë ëndrra more bir,- i thanë prindërit dhe e puthën atë në gush e faqe.
Vitet iknin pa u kuptuar.Edhe Iliri rritej së bashku me to.Ai i donte librat.Lexonte shumë,sa në bibliotekën e qytetit shkonte herë pas here e tërhiqte çdo lloj libri.Por më shumë atë shkencore , e sidomos të shkencës mjekësore. Me vullnet të hekurt, me pasio e dashuri për profesionin e bukur të mjekut arriti qëllimin e tij kryesor që të bëhej një ditë doktor për t'u shërbyer njerëzve.Kështu në vitin 1989 Ilir Shani kryen në Tiranë Fakultetin e Mjekësisë. Më pas ai fillon punë në spitalin e qytetit të Durrësit. Nga qytetarët Durrësak për këtë djalë punëtor e duarart si doktor dëgjon veç fjalë të mira.Por dijet ndaj profesionit nuk mbetën këtu.Ai specializohet si kirurg në Francë,Austri,Spanjë e Amerikë.
……Mbas operimit të tëmthit,megjithëse kishte edhe komplikacione të tjera,një operim i vështirë ,por që doli me sukses,pacienti Islam Bako para se të linte shtratin e spitalit u shpreh:
-''Si doktor Ilir Shani janë të rrallë në ditët e sotme…..Ai në radhë të parë është njeri me sjellje e kulturë,pastaj doktor duarartë që të shëron sëmundjet e plagët e trupit!''.
Rastet janë të shumta,madje me dhjetra e qindra që falnderojn doktor Ilirin.Me një shokun tim kishim kohë pa u takuar.Sabedin Ahmeti jeton në Seman.Ai punon me furgon.Atë ditë në spitalin e Durrësi kishte sjellë një të sëmurë.U ulëm për të pirë kafe në një lokal aty afër për ballë spitalit.Pas pak në tavolinë u ul edhe një shoku i vet.
-Unë jam Arben Profka nga Semani i Fierit,- prezantohet i sapo ardhuri. Kemi sjellë një të sëmurë në spital.Do e operojmë.Dhe për doktor Ilirin shprehet:''Kam gjashtë vite që e njoh këtë djalë si njeri e si doktor.U shërben me zell e dashuri pacientëve nga të gjitha anët e Shqipërisë!''
Dëgjon këto fjalë e natyrshëm krenohesh për doktor Ilir Shanin që ka sjellje të ngrohtë njerëzore e me profesionalizëm u shërben qytetarëve ngado qofshin ata.

Durrës,05/12/ 2011.

Poet i vargut që ndriçon si gur Xhevahiri!

Ashtu, si petalet e luleve të pranverës, atë ditë mbi tavolinën e punës po shfletoja nga galeria e albumeve fotografitë e pozuara në vite.Një e nga një, ato kalonin nëpër duart e mija si gurë të çmuar.I shikoja dhe i rishikoja me kujdes.Sa më shumë që t'i vështroja ato,aq më shumë meditoja për vitet që kisha lënë pas.Ato më zgjonin kujtime.Në fotot gjeja veten, por edhe shokët e shoqet,miqtë e të afërm. Mendimet u rrokullisën si gurë që shkëputen nga mali shkëmbor e startojnë diku. Atje në ato fotokujtimesh lexova qartë dashamirsinë e njerzëve që ishin pozuar së bashku me mua.Ato kishin ngrohtësinë e diellit pranveror.Në fotot'' pranvera'' rri e çelur në çdo stinë.S'ka gjë se në brendësinë e tyre kohët janë të largëta apo të afërta.Fotografitë kanë magjinë e tyre. Tek ato, kujtimet flenë të qeta, por edhe flasin nga gjiri tyre me një zë të ëmbël fëmije,pavarsisht se ç'kohe i përkasin. Midis fotove të shumta që gjenden në fondin tim të albumeve,në dorë më vjen si një pëllumb që zbret nga mali i Tomorrit fotografia e pozuar me Xhevahir Spahiun. Aty, te ajo foto janë: Xhevahir Spahiu, Sako Rama dhe unë!Lexova shënimin e shkruar nga pas fotos. Ajo mbante mbishkrimin 3 Gusht 2008.Vitet dalngadalë shkundin gjethet nga pema e jetës sonë.

Atë vit ishim në dasmën e një mikut tonë në Tiranë. Edhe Xhevahiri, si dashamirës i këngës popullore, e sidomas i trevës së skraparit, këndoi e hodhi vallen si një shqiponjë tomorri.Vallja e ''Pianecit''që e shoqëroi aq bukur Asim Veçani nga fshati Skënderbegas të rrethit Gramsh, ndezi edhe më shumë atmosferën e dasmës. Të gjithë pjesmarrsit duartrokitën fortë, sepse poeti me zërin dhe fjalën e tij ndriçuan si gur xehori.Por, ai recitoi edhe poezinë ''Fleta e lisit''.

'' Në dorën time
një gjethe diçka pëshpërit.
Jeta si fleta?Si fleta e lisit do të iki dhe unë një ditë. '' -Sa bukur!,- thash me vete.Kënga e vallja e asaj nate, me siguri do ta ketë dëgjuar edhe mali i Tomorrit! Por…sot poeti s'mund të flasi rrjedhshëm si një burim mali,të këndojë e vallzojë si atë natgushti të vitit 2008,të cilët yjet e hëna mbajtën ison e këngës e vallzuan me poetin Xhevahir Spahiu. Yjet me hëna ndjejnë keqardhjen sot, dhe i ''thonë'' ëmbël poetit ''Eja të vallzojmë Xhevo!'' Dikush më telefonoi ditën e 7 Marsit 2014. –Alo!, jam Agimi, më tha.Flas nga Tirana.Jemi te nëntë katshet. Po pimë kafe me disa kolegë.Njëri nga kolegët kërkon të flas me ju!Në këtë kohë isha në qëndër të Durrësit, atje te pallati i kulturës.-Me gjithë qejf, pse jo.Kam kënaqësi të bisedoj, por unë nuk e dija se me kë do flisja.Pastaj dikush fliste në anën tjetër të telefonit,por jo rrjedhshëm. Alo,o o o!E njoha nga zëri. Ishte poeti ynë kombëtar akademiku Xhevahir Spahiu.Ishte një telefonat e papritur,por ja poetët kujtohen për poetët.Nuk vonova dhe e urova për 7 Marsin, festën e mësuesit.Me gjysëm fjale, por që dilnin nga shpirti më falnderoi edhe ai. Unë u entuziazmova, por ndjeva e dhimbje, sepse Xhevua s'mund të fliste si dikur. Vështrova edhe një herë foton që mbaja në dorë. Aty ''dëgjova'' zërin e këngës e të valles, por edhe vargjet që recitoi poet Xhevua në vitin 2008. Pastaj meditova me veten time: Sëmundja e tradhëtoi Xhevahir Spahiun duke i merrë zërin,por vargun e poezisë që gugëllon nga shpirti s'mund t'ja ndali dot, sepse ajo ka forcën e Baba Tomorrit!

Durrës, 20.3 2014.

Foto:Xhevahir Spahiu, Xhevahir Cirongu,Sako Rama.Gusht 2008.

Historia e djeshme, sot udhërrëfyese për zhvillim e përparim shoqëror midis popujve

Më 21 qërshor 2014, në sallën qëndrore të Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, u zhvillua një veprimtari përkujtimore e atdhetare me temë :''Barbaritë greke në Dëshnicë dhe Shqipërinë e Jugut gjatë viteve 1913-1914''. Kjo veprimtari mbreslënse përkujtimore u organizua ng Shoqata Atdhetare ''Dëshnica''. Organizatorët e kësaj veprimtarie kishin përgatitur mjaftë mire në planin organizativ, por edhe në mbajtjen e kumtesave rreth tematikës së veprimtarisë që u zhvillua aty. Referuesit në fjalën e tyre prunë para auditorit që ishin të pranishëm në sallën e këtij muzeu, edhe fakte të reja për masakrat që kanë kryerë shovinistët grekë në vitin 193-1914 në Shqipërinë e jugut, por edhe në zonën e Dëshnicës. Fjalën përshëndetëse të kësaj veprimtarie atdhetare përkujtimore e prezantoj para të pranishëmve z. Gëzim Voda. Ai falënderoi të pranishmit në atë salle për pjesëmarrjen e tyre, por edhe ata që s'mundën dot të merrnin pjesë në atë veprimtari patriotike.

Fjalëhapja e veprimtarisë e z. Nuri Dragoi, u ndoq me interes, sepse aty u sollën fakte që dëshmonin barbarizmat që kanë kryerë në popullatën shqiptare të Shqipërisë së Jugut shovinistët grekë në vitet 193-1914. Midis të tjerave, historian Nuri Dragoi theksoi se në ato vite

barbarie që kryenë andratët grekë ndaj shqiptarëve të Shqipërisë së Jugut; u dëbuanë mbi 100 mijë veta nga rrethet Ersekë, Përmet, Skrapar, Korçë, Tepelenë, Gjirokastër, Sarandë; të cilët gjetën strehë në Berat , Fier e Vlorë. Në këtë aktivitet përkujtimor historik u mbajtë një minut heshtje në nderim të atyre që u masakruan nga shovinistët grekë në ato vite.
Me interes u ndoq edhe ligjërata që kishte përgatitur z. Kujtim Mateli, ku midis të tjerash ai theksoi se:
''Jemi mbledhur për të përkujtuar një nga ngjarjet më tragjike për krahinën e Dëshnicës dhe Jugun e Shqipërisë, siç është pushtimi i Shqipërisë në vitet e mbrapshta 1913-1914 nga fqinji ynë jugor, Greqia. Më 6 mars të vitit 1913, ra në duart e grekëve Janina, qyteti për të cilin shqiptarët kishin ngritur aq këngë e legjenda sa kishte dhe gurë kalaja që kishte ndërtuar atje, Ali Pashë Tepelena. Pas humbjes së Janinës, ranë njëra pas tjetrës qendrat kryesore të Shqipërisë jugore: Konica e Kolonja, Korça e Gjirokastra, Saranda e Përmeti, Tepelena e Skrapari. Kudo, ushtria greke kreu mbi popullsinë e pushtuar vrasje e dhunë të pa parë. Arrestoi patriotët shqiptarë për ta gjunjëzuar popullsinë. Këtë bëri dhe me njërin nga patriotët me emër të Dëshnicës, komandantin e njërës prej këtyre çetave patriotike, Riza Xhungën. Ushtroi mbi të dhunë për ta bërë pjesë të masakrave të tyre. Por kur e panë se nuk u gjunjëzua, e goditën gjersa i shkaktuan vdekjen në burgun e Janinës''.

Papa Kosta Tomorri e përshkruan kështu: '' Muarën 1500 krerë dhen e dhi dhe 100 krerë lopë, pastaj u vunë zjarrin shtëpive, i përvëluan, i bënë hi. Si mbaruan këto, katilët u kthyen në Kosinë. Nxorën burrat që kishin mbyllur dhe i shpunë në një përrua të fshatit, ku i lemerisën me thika, disave u prenë hundë, veshë, këmbë e duar. Numri i tyre qe 75 veta. Si dhanë shpirt, i lanë në atë përrua të zbuluar. Katilët u kthyen në Kosinë. Nxorën burrat që kishin mbyllur dhe i shpunë në një përrua të fshatit, ku i lemerisën me thika, disave u prenë hundë, veshë, këmbë e duar. Numri i tyre qe 75 veta. Si dhanë shpirt, i lanë në atë përrua të zbuluar''.
Studiuesi përmetar Stilian Adhami shkruan: "Më 29 maj, katilët sulen kundër fshatrave të Dëshnicës: Topojanit, Zhepovës, Kajcës, Toshkësit, Vinokashit, Ballabanit, Mazhanit etj., të cilët i plaçkitën dhe u vunë zjarrin. 300 barrë bakërre me mijëra bagëti vanë në Janinë, kurse 15 gra të Zhepovës i therën me gjithë fëmijët dhe 18 burra i vranë". Por edhe një tjetër autor dëshnicar, **Murat Murataj, banor i fshatit Toshkës shkruan:** " Në Toshkës vranë 4 burra: Ali Mukën, Muço Ismailin dhe dy djemtë e Muharrem Veizit dhe në të gjithë krahinën e Dëshnicës dogjën 957 shtëpi, kurse në Toshkës 39…" Në këtë takim të 100 vjetorit në kujtim të të rënëve në fishën e betejës për mbrojtjen e vatarave stërgjyshore, po edhe në kujtim të masakrave që

kanë kryerë shovinistët grekë në Shqipërinë e Jugut, nga foltorja e këtj takimi sollën dëshmi e fakte tronditëse edhe sot pas kaq vitesh z. Zeno Jahoj dhe Hëna Këlcyra, e bija e Ali Këcyrës që në vitin 193-1914 andartët grekë dogjën sarajet në shenjë hakmarrje sepse ata u ngritën me forcë dhe kundërshtuan pushtimin e shqipërisë së jugut nga grekërit.
Fakte janë të shumta e domethënës që i shtohen masakrave barbare që grekërit kanë kryer edhe në zonën e Tomorricës me djegien, plaçkitjen deri në vrasjen e banorëve të kësaj krahine.Në luftën kundër andartëve grekë për mbrojtjen e trojeve shqiptare, në vitin 1914 mbetet i vrarë te Tre Urat e Përmetit edhe **patrioti Razim Shabani nga Leskova e Tomorricës së Skraparit**. Në vitin 1915 në Konak të Tomorricës u mbajt Kuvendi që i cili mori vendime të rëndësishme për të luftuar kundër shovinistëve grekë që masakronin popullin në fshatrat e zonës së Korçës e të Kolonjës. Në këtë Kuvend mori pjesë edhe patrioti Sali Butka. Pas këtij Kuvendi u krijuan dy çeta komitësh: **Njëra në Kuç me komandant Nebi Alimadhi, që veproi me luftimet e saj në Panarit të Korçës, dhe tjetra në Vidhan me komandant Zenel Braçi**, që operonte në mbrojtjen e Voskopojës. Shtete shoviniste ballkanase, por edhe ato evropiane, pas Shpalljes së Pavarsisë e coptuan Shqipërinë duke aneksuar Çamërinë, Greqisë, Kosovën, Jugosllavisë, Dibrën e Madhe, Maqedonisë,si dhe një pjesë tjetër si Gucinë, Plavën e Ulqinin, Malit të Zi. Si rrjedhojë të copëtimit të këtyre trojeve, ato mbetën jashtë kufirit shtetëror të sotëm. Sot në kohën mederne dhe të civilizimit të qytetruar të kombeve, duhet korigjuar kjo padrejtësi e së kaluarës ndaj trojeve shqiptare.
Para të pranishmëve poeti Flamur Dalipaj recitoi poezinë që u kushtohej masakrave të andratëve grekë ndaj popullsisë së jugut të viteve 1913-1914-ës. Veprimtaria e organizuar nga Shoqata Atdhetare ‘’Dëshnica’’ në këtë 100 vjetor përkujtimor, duhet marrë shembull edhe shoqatat e tjera që të organizojnë veprimtari të tilla që historia të mos harrohet, por të nderohet duke mos përsëritur ngjarje të tilla të hidhura historike që kanë ndodhur midis kombeve e popujve për të jetuar gjithmonë në fqinjësi të mirë në dobi të përparimit e zhvillimit shoqëror mes tyre.

Tiranë, 21 Qërshor 2014

Atje ku ëndrrat zgjohen me nektarin e vendlindjes

Janë të shumtë krujuesit që vujnë me krijimet e tyre aq të bukura në cilësinë e botimeve të librave, falë edhe teknologjisë moderrne që ka rritur cilësisht formatin e librit nga shtypi. Por, kur shfleton librin në brendësi,aty gjen arritje cilësore artistike e të mbushin gjoksin me frymarrje plot ngjyra kolori të fjalës së shkruar. E gjithë gama e botimeve të autorëve nga trojet tona shqiptare, në themel të krijimeve kanë vendlindjen. Gjuaha e fjala e shkruar është e thjeshtë, e kapshme për gjithë lexuesit. Atdheu e fjala e bukur shqipe janë kryefjala e autorëve tanë. Aty lexuesi gjen ëndrrën e së nesërmes që do jetë më e mire, e begatë, sepse fjala e shkruar buron nga shpirti i krijuesit që në shpirt ka nektarin e vendlindjes.

@ Pikërisht,edhe autori i librit me **titull''Kur ëndrrat puthen me mua'' të mësuesit Islam Hasani**, me talentin e kulturën, lexohet qartë në horizontin e vendlindjes të fshatit Ermenj që përballë ka malin Tomorr.Ndërsa, mali Koshnicë me ujrat që rrjedhin prej tij drejtë fshatit të lindjes, i kanë dhënë autorit freskinë e mendimit që ai e shpreh aq bukur nëpër gjithë poezitë e këtj libri. Janë të spikatura plot ndjenjë **poezitë''Dashuria e malli për vendlindjen'', ''Me sytë nga Shqipëria'', ''PLagë që s'treten'',''Kuvendim stinësh'', ''Unë dhe deti'' etj.** Poeti Islam Hasani ka lindur në vitin 1960, fshati Ermenj,Tommorricë të rrethit Gramsh . Arsimin e mesëm e kryen në vendlindje dhe studimet e larta në Elbasan, dega Gjuhë-letërsi në vitin 1983.Ka punur mësues e drejtura në disa shkolla të rrethit Gramsh. Aktualisht banon në Durrës dhe punon në arsim.

@Një tjetër libër interesant që na ra në dorë para disa kohësh, është edhe libri me titull ''Tomorri,përballë nesh'' të autorit **Petrit Basha**. Libri ka mjaftë shkrime interesante.Përveç shkrime nga autori i librit aty gjen shkrime edhe të autorëve të tjerë si: **Selim Marishta,Islam Hsani, Bashkim Muka**. Në brendësi të librit lexuesi do gjejë edhe foto të ndryshme që e zbukurojnë e japin fakte nga treva e Gramshit. Të bëjnë për vete fotot e ujvarës e kataraktet e Sotirës, burimi i Kërpicës etj.

@ Në bibliotekat tona, por edhe te lexuesi ynë si në Kosovë dhe në Shqipëri, tashmë gjendet edhe libri me titull''Ramadan Zyber Bajraktari, përfaqsues i Drenicës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit''me autor shkrimtarin **Bedri Tahiri**.Në libër ofrohen të dhëna të bollshme orentuese për gjeografinë e Drenicës,onomastikën dhe mikrotoponimet, deri tek lagjet dhe fiset, duke dhënë kështu një shpjegim të nevojshëm për lexuesin mbi gjenologjinë e familjes Bajarktari. Libri ka gjithësej 154 faqe.Autori **Bedri Tahiri** në hartimin e këtij studimi historic monografik me mjaft kreativitet, e ka përdorur edhe këngën populore si mbështetje të argumentimit kryesor të ngjarjeve dhe personaliteteve të përmendur në këtë libër. Në libër zënë vend të rëndësishëm edhe pinjollët të familjes Bajraktari të Klinës, të cilët mbajtën lart bajrakun e familjes, fisit dhe të fshatrave që përfaqësonin.Ata ishin për **Azem Bejtë Galicës, Mehmet Gradicës,ShabanPaluzhës** e burrave të tjerë të kohës që ngritën lart kauzën e lirisë dhe të shtetit shqiptar.Libri ka edhe foto të ndryshme që pasqyron ngjarje të ndryshme të shtrira në kohë.**@ ''Orakuj të harruar''**, kështu e ka titullin libri me shënime dhe ese publicistike,që ka për autor**Zylyftar Hoxha**. Një libër interesant që është shkruar me aq përkushtim e dashuri për vendlindjen dhe shqipërinë tonë. Ngjarjet që përshkruhen në gjithë shënimet, ese, reportazhe, portrete të njerëzve, janë shkruar me plot ngrohtësi e dashuri nga dora e palodhur e gazetarit Zylyftar Hoxha. Autori I këtij libri ka lindur në fshatin Qafë të Skraparit.Ka mbaruar arsimin e lartë pedagogjik, dega Histori-Gjeografi. Për 35 vjet ka punuar si gazetar. Ka qënë kryeredaktor i gazettes ''Jehona e Skraparit'', Telekronist në Televizionin Shqiptar dhe bashkëpuntor i rregulli i shtypit të kohës.Ka marrë dy çmime kombëtare në gazetën ''Drita'' dhe revistën ''Nëntori'' për gjininë e reportazhit.Nga viti 2002 e këtej ka punuar në disa gazeta. Ka punuar edhe si kryeredaktor i gazetës''Dielli i Tomorrit''. Për këtë autor **Xhevahir Spahiu** shkruan:…*''Lumi, që synon detin,dhe mali që mësyn qiellin.Si një udhërrëfyes I besës,autori të merr për dore e të çon, pa ndjerë lodhje, atje ku rrojnë tomorrianët, në vatrat që mbajnë të ndezur zjarrin e trimërisë, mirësisë,urtësisë.Atje ku ngrihet dhe pihet me fund dollia e jetës:''Të paça, o mik!Me pak raki e me shumë dashuri''!*

@ Fabula e satira, por edhe poezia e **Nebi Dragoti**,është bërë pjesë e pandarë e lexuesit tonë. Autori ka vite të tëra që lëvron gjithë gjinitë letrare. Ai shkrua me plot pathos edhe shkrime me temë shoqërore e politike, por edhe reportazhe e analiza letrare, të cilat kohët e fundit kanë bërë jehonë te lexuesi ynë. Një vend të rëndësishme këto shkrime janë shplasosur me gjithë gamën e tyre nëpër faqet e shtypit tonë të përditshëm, por edhe te shtypi elektronik. Bisedon me Nebiun, pi një kafe me atë, e kryefjala është fjala e shkruar artistike. Më ranë në dorë dy librat e botura prej tij: poezi **''Shtegtime lirike'' e ''Goditje fjale''** me fibula e satira. Nga libri me poezi shkëputëm këtë strofë te poezia me titull ''Statujat'' :

''Duan mbi kokë

Diell,yje e hënë,

Vello-vesën argjend

Të Shqipërisë Nënë''. **@** Në larminë e botimeve të gazetave që botohen sot në Shqipëri, si një uragan letrar është bërë pjesë edhe gazeta letrare ***'' Muzgu''***. Kjo gazetë po tërheq çdo ditë e më shumë nga gjithë vendi e diaspora krijuesit tanë. Aty botohen krijimet letrare e gjithë krijuesëve të vjetër dhe të rinj. Kjo gazetë, është e re që del në treg. Sapo ka hyrë në vitin e dytë të jetës së saj me botues ***Mark Simoni***. Aty përfshihen botime letrare të ndryshme, paprjashtim e në gjithë fushat letrare. E veçanta e kësaj gazete është se, aty gjen faqe të veçantë botuese për tematika të llojeve e gjinive letrare, të cilat përfshihen në antologji poetike. Kjo është një risi si për nga lloji,por edhe gjithëpërfshirëse me sa më shumë autorë.Prurjet letrare të autorëve të të gjitha fushave krijuese, dhe botimet e tyre në gazetën letrare''Muzgu'', më e madhja që gjendet sot në vendin tonë. Gazeta ''Muzgu'' po kthehet dalngadalë,si një yll polar në hapsirën mbarëshqiptare të botës krijuese e letraro-artistike. E ku ka më bukur të shkruash poezi për ''Nënën'', për ''Dashurinë'', për Vendlindjen'' etj. Ja pra, këtu qëndron edhe fillimi i madhështisë letrare dhe mbështetja për gjithë krijuesit kudondodhur shqipfolës anembanë globit!

Durrës,07.Maj 2014.

Esse

Gusht 2014.- Me poetin Matian

Xhavit Gasa

Krijuesit e kudo ndodhur në gjithë globin, janë të parët që mbjellin në zemrat e njerëzve dashurijete!

Poetët ecin mbi vargun e tyre krijues të cilëve iu buron nga shpirti. Ata janë qënie si gjithë të tjerët e kësaj bote të mbadhe…! Por ja,…e veçanta që dallohen nga masa tjetër e qënieve njerëzore është vargu poetik, të cilët fjalët në rreshta që derdhin si hoje mjalti në letrën e bardhë, i bëjnë të cilëshueshëm dhe prekës atë mas tjetër të madhe njerëzish kur ata lexojnë vargun e poezisë. Vargu i poetit është magjik. Ai për lexuesin ngelet i pavdekshëm , sepse mbush hapsirën e shpirtit të tyre. S'ka shumë rëndësi se kush autor e ka shkruar vargun poetik, mjafton që ai është shkruar nga dora e poetit me drithërima këngësh e zogjësh në fluturim, me ujë të ftohtë e të kristaltë të burimeve, deri me lumin e dashurisë njerëzore me rrënjë fjale që ka pirë qumsht nga sisa e nënës, me fjalën e bukur të shqipes sonë. Edhe Perandorët e Mbretërit qysh në lashtësi, në oborrin e tyre kanë pranuar të kenë afër në radhë të parë poetët. Pse kjo afrinitet me poetët?! E pra, poetët janë profetët e fjalës diellore që ngrohin shpirtrat e njerëzve. Ata janë të dërguarit Zotit , ku me fjalën e bukur që shkruajnë të japin forcë,

mposhtin të keqen, të japin jetë. Por… krijuesi e artit kudo ndodhur në gjithë globin, janë të parët që mbjellin në zemrat e njerëzve dashuirjete!

Hapsira gjeografike dhe njohja me krijuesit e të të gjithave fushave të shkencës, duke punuar edhe në gjininë e publicistikës, kam njohur nga afër shkrimtarë apo poetë. Me ata kam patur e kam koorospodenca të ndryshme publicistike apo deri ato historike e letrare. Njohjet e kohëve të sotme është edhe më e lehtë, sepse teknologjia moderne (Interneti) na ka mundësuar të komunikojmë e njohim vlerat krijuese midis njëri-tjetërit kudo që ndodhemi , madje nga një kontinent te tjetri. Sa për ilustrim të shkrimit po japim me rezerva disa emra që të jem sa më konkret, sepse ata janë shumë e s'mund t'i shkruajmë të radhitur të gjithë në këtë esse letrare.(Prandaj ju kërkoj ndjesë atyre që s'u kam përmendur emrin!).

Interneti është bërë pjesë e jetës sonë së përditshmes. Ai tashmë na bën ''ftesë'' në gjithë veprimtarinë tonë të jetës. Falë kësaj teknologjie të kohës sonë , na ka afruar edhe më shumë me njëri-tjetrin anembanë globit. Kam ndjerë një kënaqësi të veçantë kur më është botuar shkrimi në portalin ''Fjalalirë'' e ''Gazeta kritika''. Por edhe në portualet e tjera''Zemra shqiptare'', ''Filolet'', ''Kosovarimedia'','Zeri i shqiptarëve'',''Devolli'', ''Albaniapress'', etj.
Ishte posta elektronike që mundësoi të njihja e të komunikoja me shumë shkrimtarë e poet në vende të ndryshme të kontinenteve, qofshin këta të huaj apo shqiptarë. Te fjalalirë u njoha me Fatmir Terziu, Xhavit Gasa, etj. Në portalet e ndryshme me botimet e tyre, u njoha me Drita Ademi e Adem Zaplluzha nga Prishtina, Bedri Tahiri nga Vushtrria, Bedri Neziri nga Kastrioti, por edhe me Hazir Mehmeti në Vjenë . Me Raimonda Moisiun, Përparim Hysi, Drita Lushi, Pëllumb Gorica, Faik Xhani, Sokol Demaku, Zeqir Lushaj, Baki ymeri etj. Vitet treten në valët e jetës sonë. E megjithatë, ato lënë edhe gjurmët e tyre pas. Vjen një ditë e takohesh me njerëzit e viteve të shkuar me plot mall e dashuri. Me Namik Selmanin jam takuar për herë të parë në Lezhë, viti 1980. Njohja jonë e mëparshme ishte nëpërmjet shkrimeve që botonim në gazetat e kohës. Në qytetin bregdetar takoj mbas viteve'90-të, (i ndjeri) Bashkim Çuçi, Alma Begaj, Artan Ballgjini, Fatime Kulli, Daut Hoxha, Flora Dervishi(Gjondedaj) , Gjergj Vlashi,Kadri Tarelli,Nebi Dragoti, Pjetër Cara, Skënder Kapiti, Gëzim Çela, Pëllumb Mane, Shahin Ibrahimi, Myrteza Baboçi, Myftar Gjonbalaj etj.

Te kafja ''nëntë katshe'' në Tiranë flasim për letërsinë, me poetin Xhevahir Spahiu, dhe vazhdojmë me të tjerë kolegë të fushës së artit të shkruar si: Albert Zholi, Enrieta Sina, Kastriot Caka, Zylyftar Hoxha, Kujtim Mateli, Gëzim Voda,

Nuri Dragoj, Mark Simoni, Land Lushi , Bashkim Koçi etj. Takim pas takimi edhe me Enver Cakaj nga Osoja e Skraparit, që s'i pushon pena së shkruari çdo ditë nëpër gazeta të ndryshme. Shkruajnë për të vulosur kohën tonë që ajo t'u flas brezave nesër.

Por mundësia e një kafe mirënjohje e respekti miqësor piktakohet edhe me piktorë e këngëtarë siç janë: Naim Këçuku - Durrës, Azir Aziri ngaTetova, Nuri Jaupllari- Skrapar, Ardian Traga,,Çaush Vathi ,Sali Xhaja- Durrës etj.

Por s'mund të lë pa shkruar edhe një rresht fjale që skulptorin me origjinë nga Çamëria, që atje në studion e tij me baltën e gurin e vendlindjes shqipëri lartëson shtatoret e heronjëve tanë. Dhe ai është njeriu duartë Idriz Balani.

Malli për vendlindjen të zhurit shpirtin. Atje ku të ka lindur koka, pavarsisht se ku jeton e punon, afër apo larg atdheut, te vendlindja shikon ëndrrat e jetës. Kishte disa vite pa ardhur në Shqipëri poeti Xhavit Gasa. Emigrimi e degënisi larg atje në Londër me gjithë familje. Aty u njoh edhe me shqiptarë të tjerë. Lidhën shoqëri e miqësi. Por syt e mendjen e kishin te vendlindja. Dhe ja…nëprërmjet postës elektronike në portalet bashkëbisedon e njihet edhe me mua. Flasim në distancë për artin e letërsinë. –Do vij në shqipëri më thotë e do takohemi të pimë një kafe aty në Durrës. E mirëpres ftesën e poetit Xhavit Gasa që me orgjinë është nga Zenishti i Matit. Ishte data 14 gusht 2014 kur unë takohem me poetin emigrant Xhavit Gasa që kishte ardhur nga Anglia për të shuar atë malldhimbje. Pss një telefonate, ai së bashku me një mikun e tij Sabri Dedolli , takohemi në një lokal të lagjes Shkozet. Ishte një befasi, por edhe takim miqësor poetësh sikur kishim vite që njiheshim fizikisht. Aty mësova se Xhaviti ishte nga fshati Zenisht të rrethit Mat. Udhëtojmë në vite e sjellim kujtimet tona. Thinjat e bardha që na përshëndesin aty-këtu, në kokë mbajnë të fshehura enigmat e jetës. Në vitin 1975 Xhavit kryen arsimin e mesëm bujqësor në shkollën''Ylli i kuq '' në Kamëz- Tiranë. Në vitin 1982 martohet dhe nga martesa sjell në jetë djalë i cili është i martuar. Xhaviti është bërë edhe gjysh, ndaj sot krenohet e gëzohet me nipa e mbesa që rriten si pëllumba.Ai i kujton në këtë tavolinë ku pimë birrën e fresktë dhe sytë i mbushen me lot. Xhavit Gasa ka botuar dy libra me poezi. Jo më kot njërin libër e ka titulluar''Jehonat e dhimbjes'' të cilin e ka botuar në vitin 2009. Librin e parë me poezi e boton në vitin 2008. Po përgatitet për vëllimin e tretë me poezi shqip-anglisht.

E gjithë biseda jonë ishte fokusuar te arti e letërsia. Arti i të shkruarit i bashkon njerëzit.I dhurojmë njëri-tjetërit nga një libër ku nënshkruajmë autografin tonë aty. Çaste të bukura takimesh intime që mbeten gjithmonë në memorjen e kujtimeve. Çfletoj librin e mikut tim dhe fiksoj në mendje vargjet e një poezie, të cilat poeti Xhavit Gasa i ka derdhur me aq dashuri nga shpirti i tija.

''Dua,

Që vargu im,
Në krahët e zogut
……..të fluturojë.
Me zërin e bilbilit,
……të këndojë.
Me dallgët e detit,
……të vallëzojë,
Me shpatën e Skënderbeut,
……sherret t'i ndalojë''.

E pra, njerëzit e artit e të letërsisë të çdo lloji kombësie qofshin ata, mbjellën dashurijete te njerëzimi në gjithë globin. Kur takohen poetët edhe gurët ia thonë këngës…!

Durrës, 28.08.2014.

Lulja e lirisë me rrënjë te gjaku i dëshmorëve të atdheut

(Në përkujtim të Heroit të Popullit Xheladin Beqiri (Karadaku) që ra heroikisht në Qafën e Gjarpërit më 6 qërshor 1944)

Për dëshmorët e atdheut është shkruar e do shkruhet gjithmonë. Në çdo varg të shkruar, aty gjen të freskët pika gjaku nga ku lulja e lirisë qëndron ngaherë e pa vyshkur,m e rrënjë ngulur në tokën tonë të ujitur nga gjaku i 28 mijë dëshmorëve të LANÇ. Kanë kaluar 70 vite kur djemtë e vajzat shqiptare rrëmbyenë armët e dolën maleve për larinë e atdheut. Shqipëria ishte pushtuar nga nazifashizmi gjerman. Thirrjes së atdheut për të luftuar ndaj okupatorit, iu përgjigj edhe Xheladin Beqiri (Karadaku). Qysh në fillim djali i Gjilanit që jetonte në Nivicë të Kurveleshit,rroku armën e doli malit për lirinë e shqipërisë.
''Nuk mund të rri në shtëpi, - u tha Nivicarëve djali i Kosovës. Shtëpia ime janë malet ku kanë folenë shqiponjat!''.

Si erdhi Xheladin Beqiri në Shqipëri?

Ngjarjet e vitit 1934 atje në fshatin e lindjes në Gjilan, e detyruan të kalonte fillimisht në Kukës, pastaj në Shkodër. Prej andej në myzeqe, në Fier tek disa të afrëm. Prej andej punon disa kohë në kriporen e Vlorës. Lufta italo-greke 1940 e gjen në fshatin Nivicë të Kurveleshit. Xheladin Beqipri (Karadaku) ka lindur në vitin 1905. Ai ra heroikisht në betejën e luftmeve që u zhvillua midis gjermanëve e forcave partizanëve në operacionin luftarak më 6 qërshor të vitit 1944 në Qafën

e Gjarpërit të rrethit Skrapar(zona tomorricë). Ai me babanë s'mund të duronin shtypjen serbe, dhe si rezultat të konflikteve ,familja u vu në shënjestër nga serbët. Kjo e detyroi që të kalonte drejt shqipërisë. Por edhe në shqipëri,Xheladini se pati të lehtë kalvarin e jetës së tij. Arrestohet nga italianët e greku me disa muaj burg. Kur mësojnë se nuk ishte djal nga Nivica,por një hysmeqar i ardhur nga veriu i shqipërisë e lirojnë nga burgu. Në këto kushte,biri i Kosovës rrëmben pushkën e inkuadrohet në rreshtat partizane. Kështu,Xheladin Beqiri (Karadaku) hyn në formacionin e parë të çetës partizane të Kurveleshit në vitin 1942. Më von kalon komandant i çetës ''Harjedin Tremishti'' me komisar Hasim Zeneli. Po në këtë vit pranohet Antar i Partisë Komuniste Shqiptare. Me trimëri e zgjuarsi ka marrë pjesë në shumë beteja kundër pushtuesve gjermanë në krahina të ndryshme të shqipërisë së jugut. Gjurmë që mbetën në histori është ajo e betejës së Mezhgoranit në Përmet. Me krijimin e Brigadës Parë Sulmuese emërohet zv.komandant i Batalionit Parë. Duke parë aftësitë e tija si organizator e luftëtar i zoti, si një strateg i lindur, Xheladin Beqiri (Karadaku) emërohet komandant i batalionit të pestë të Brigadës Parë Sulmuese. Ai bëhet krahu i djathtë i Mehemet Shehut,fill pas kthimit nga kongresi i Përmetit ku ishte pjesëmarrës si delegate atje. Në betejën e Qafës së Gjarpërit e Guri i Prerë,në luftime të ashpra që u zhviluan aty trup me trup midis forcave gjermane e ato parizane më 6 qërshor të vitit 1944, dhanë jetën 32 parizanë e parizane në lulen e rinisë për lirinë e shqipërisë. Midis tyre edhe biri i Kosovës, komandant Xheladin Beqiri(Karadaku),Hero i Popullit. Gjatë luftës për çlirimin e shqipërisë nga okupatori nazifashis, ai mbajti pseudonimin ''Karadaku'' emrin e malit Karadak të vendlindjes. Në qafën e Gjarpërit janë dy lapidarë, njëri është ngritur pikërisht atje ku u vra Xheladini 70 vite më parë. Edhe në Nivicë në qendër të fshatit qëndron kryelart busti i Heroit të Popullit Xheladin Beqiri(Karadaku)., atje në zemër të Labërisë trime. Dëshmorët e kombit kanë vetëm ditëlindje. Lira që gëzojmë sot i ka rrënjët te gjaku i dëshmorëve të atdheut. Ata do nderohen brez pas brezi në shekuj. Populli i Skraparit u këndon edhe këngën dëshmorëve që ranë në betejën e Qafës së Gjarpërit e Guri i Prerë.

''Qaf e Gjarpërit e Guri Prerë

U ndez lufta me furi,

Dejmtë tanë po luftojnë

‘’Karadaku’’me Myslimë

Dhe Jonuzi djalë i ri.

Edhe shumë djem, vajza të tjerë

Derdhin gjakun për liri’’.

Durrës,09.09.2014.

Esse

Mesazhi i jetës dhe veprës Sokratike në përjetimin tim

Me të vërtet jeta jonë është e çuditshme. Rrugëtojmë mbi trasenë e saj mbi shinat e ditëve e viteve dhe…ndalojmë te ai stacion së bashku me lokomotivën e jetës sonë , te shtegu humnerian i pakthyeshëm që ne e quajmë Vdekje!Lindje-Vdekje, e prap Vdekje-Lindje! Kjo metaforiane e jetës sonë që s'ndalet, por rifillon e ringjallet duke lënë gjurmët e saj pas vetes në kohën e tyre. E kjo, na bën edhe neve të mendojmë për ditët tona, për gjurmët që do lëmë pas nga jeta jonë. Mendoj çdo çast se cila fjalë e mendimi im do u flas të tjerëve nesër, që ato të japin mesazhe dinamike edhe te njerëzit e tjerë, qofshin ata me të cilët bashkëbisedoj sot, por edhe me anën e mendimit e të fjalës që si një përcjellës elektrik t'u tregojë rrugën edhe të tjerëve.Pra, atë lëvizje jete që ne jetojmë e ata të cilët do e jetojnë në vazhdimshsi. Jeta nuk ndalet, por edhe inteligjenca intelektuale rrok pas vetes dije e eksperiencat më të përparuara që e cila shpërthen me gjithë fuqinë e saj drejt së resë përparimtare, zbulon skutat e fshahta të botës ku ne jetojmë. Edhe Sokrati, filozofi grek (470-322 p,e.r.) që i cili lindi në Athinë, është gjiganti i mendimit dhe babai i etikës të filozofisë .Duke qënë i tillë gjiganti i mendimit filozofik , se si më thërret edhe mua sot në këtë pragshekulli të 21-të,që të mendoj e veproj që të kap të fshatat e jetës sime. E ndjej Sokratin në çdo qelizë të trupit tim. Kush si ai i ka dhënë njerëzimit mendimin filozofik, etik e shkencor që janë rrënja e zhvillimit e përparimit të shoqërisë njerëzore botrore!? Askush si Ai?

E ndjej, e prek mendimin e tij.Ndaj edhe vrapoj te ai. Çdo ditë unë, ti, ne, i themi veprës Sokratike Tunjatjeta për njohjen e botës që na rrethon. Hapi ynë i mendimit për te dija fillon te ky filozof që mbetet si i tillë një nga filozofët më të mëdhenj të të gjitha kohëve. Eshtë mendja sintetike e tij dhe më e rëndësishme në përgjithësi e këtij gjeniu më i gjthanshëm i antikës. Jeta jonë dhe e imja është kapitale. Prandaj e shqyrtoj në gjthësinë e saj në mënyrë sistematike, që ta bëj(ta bëjmë) sa më të bukur, që ajo të lërë gjurmët e saj mirnjohje edhe te të tjerët. Pa këtë, ajo për mua do të ishte abstrakte, e pakuptimt, shterpe dhe s'do të vlente për asgjë. Mundohem ta gëdhend gurin e fjalës me daltën e mendimit tim filozofik që buron nga shpirti im, nga qënia ime njerësore. E pse jo, edhe unë, ti, e gjithë të tjerët të rendim drejt së resë filozofike,jemi pjesë e kësaj bote materialiste. Veçoria jonë dalluese është se si qënie njerëzore kemi ndjenjë, mendim, shprehim fjalë, tingull, japim ide etj. Pra, krijomë enciklopedinë shumëplanshe të jetës sonë që unë, apo (ti, juve) i themi që të gjithë së bashku:jeta jonë!.
Unë e përjetoj me shpirt në zemër atë mendim apo fjalë që na ka lënë Sokrati ynë i madh. Filozofia e tij është vetë dielli i ngrohtë i mendimit i të gjithave shkecave të sotme, sepse pa etikë filozofike s'mund të jesh në rrugën e duhur. Si i tillë, edhe unë e përjetoj atë në rrugëtimin tim të jetës. Ai shkreptëtin si rrufe në qiell e bën dritë në shpirtin tim, te gjithë njerëzimi me filozofinë e tij aq brilante të aktivitetit mendor dhe të njohurive njerëzore të disiplinave filozofike etike shoqërore.

Sokrati e lidhi fjalën te zoti! Edhe unë rend te ai, sepse aty gjej ngrohtësinë e shpirtit. Ai shprehet nëpërmjet teje te çdo fjalë që tha. Kërkoje brenda vetes. Ai nuk të largohet gjatë gjithë jetës sonë. Falu te faltorja jote, te qënia jonë! Je vetvetja, kështu vazhdon të jetosh…! E megjithatë në jetë duhet guxim,ajo të jetë primare me guackën e mençurisë fosforishente në rrugëtimin e gjatë jetësor. Jeta është një projektsion me mendime e besim te një zot, prandaj vrapo për aty se do gjesh shpresën e vesën e jetës. Sokratin e helmuan, por mendimin filozofik të tij për te etika dhe zoti s'mundën kurrë ti helmoni, sepse ato janë gurë xehori që i mbetën njerëzimit. Koha më jep mua të reflektoj e të jap mesazhe për jetën, të shpresoj diku si Sokrati, të reflektoj mbi fenomenet shoqërore, të dalloj dritën nga errësira. Marr frymë. Ndjej lirinë time! Vështroj natyrën, qiellin e gjithçka rreth kësaj bote.

Besoj, besoj!.Aty beso edhe ti si unë në ëndrrat e mija. Projektsione e mesazhe jete përcjell edhe unë te vepra Sokratike,sepse jetoj edhe unë me ato.

.

Durrës, 04,Tetor 2014

Petrit Bako,djali nga Burranji që kapërceu oqeanin atlantik...

Jeta qënka e çuditshme. Ajo vijen e ëmbël në fillim, por ne nuk e dimë që ajo ka në trupin e saj të fsheta të shumta.Na duhet një kohë e gjatë që të depërtojmë deri diku tek enigmat e saj. Vrapojmë si një i marrë në ditët e dehura tek ajo, por s'mund ta kapim kohën që ne dëshirojmë për ta shijuar atë. Ecim, ecim pa pushuar dhe lundrojmë mbi valët e bardha plotë dritë mes vezullimeve të jetës sonë. Koha s'ndalet kurrë! Por ne e masim atë me jetët tona…! Sa bukur të ecësh mbi valën e bardhë e dritën e diellit nga ku ne rritemi e plakemi, derisa vjen një ditë e shuhemi në ugarin e plisit të dheut të pavdekshëm!

Kam biseduar me shumë njerëz me mjetet moderrne të kohës sonë që jetojmë. Kjo mundësi komunikimi më kanë bërë që të jem edhe më afër dashamirsëve e të afërme të mi.Vitet ikin si një lum me ujë të rrjedhshëm nga bora që shkrin maleve.

Kisha kohë të gjatë që s'kisha takuar apo biseduar me një të afërmin tim. Dhe ja…erdhi një ditë e unë takoj me mall e dashuri atë djalë simpatik,energjik,të dashur me të gjithë, njeriun që kapërcen kohët e këqia dhe mban vlerat e mira brenda gjirit të shpirtit tij. Ai nuk kishte ndryshuar edhe pse jeta e kishte degnisur deri atje përtej oqeaniit Atlantik. Jam Petriti,- si më dëgjon!? Ju flas nga përtej oqeanit Atlantik, më foli një ditë të bukur vjeshtë-tetori 2014-ës.



Kush është Petriti?Petrit Bako është nga fshati Burranj i rrethit Skrapar (Tomorricë). Ai ka lindur më 10 shkurt të vitit 1967. Eshtë i biri i Qani e Lima Bako. Atë ditë kur lindi Petriti, mali i tomorrit kishte hedhur supeve ''gunën e bardhë'' mbi vete e bardhësia vezullonte në gjithë krahinën e Tomorricës. Gjyshja Fize e përkëdhelte të nipin me ato duar të ashpra, por fjalët e këngën që u këndonte

nipave e mbesave ishin të bardha si bora e maleve e ngrohnin si rrezet e diellit të pranverës. Fisi bako ka kontribuar edhe në LANÇ. Në vitin 1943 gjyshi i Petritit që e quanin Demir Bako zgjidhet sekretar këshilli për fshatin Burranj. E si mos ta kujtojmë në këtë 70 vjetor të çlirimit të vendit tonë nga nazifashizmi njerëzit që sakrifukuan edhe me jetën e tyre, na thotë Petriti. Prindërit e Petritit në çdo fjalë që nxirrnin nga goja, lëshonin pjalmin e lules së jetës për djalin e tyre të pagëzuar me emrin simbolik Petrit. Edhe burimi me emrin aq të bukur Dardha, që buronte sipër fshatit Burranj, ngrinte dollinë për djalin e fshatit të sapo lindur në atë ditë shkurti të vitit 1967.Lulet çelin herët në Burranj, por atë vit manushaqja kishte çelur më herët nga vitet e mëparsheme. Kalonin vetet e Petriti rritej edhe më shumë si një lis që e mbosht furtunën e rrebeshet e kohëve. Petriti rrjedh nga një familje patriotike e atdhetare. Halla e tij që e quanin Nafije Bregu(Bako) është dëshmore e atdheut. Shkollën fillore Petriti e kryen në fshatin e lindjes Burranj. Ai kujton me plot mall mësuesen e klasës së parë Lavdie Nikollari. Kurse arsimin 8 vjeçar e kryen në Dobrenj. Nga mendja si ndahen mësuesit Islam Osmani, Vangjel Mostra (Dropulli), Islam Bako etj. Arsimin e mësëm e kryen në gjimnazin ‘’Ramiz Arianitasi’’ në Çorovodë dhe e mbaron atë në vitin 1980-1984.

-S’mund të lë pa kujtuar ata mësues të mbrekullueshëm si Sybi Koxhabelliu, Teki Bregu (drejtor i gjimnazit), Çelnik Nako, Festim Myftari etj, -na thotë ai.Por edhe shokët e klasës, Xhelil Seferasi, Dragosh Cirongu nga Leskova. Dragoshi vazhdoi për oficer ndërlidhje . Edhe Petriti mbaroi me rezultate të mira arsimin e mesëm me 9.4 mesataren . Si rrjedhojë e rezultateve të larta, ai vazhdon arsimin e lartë ,Shkollën e Bashkuar të Oficerave në vitin 1984-1988 në Tiranë. Petriti ka lënë gjurmë të mira kudo që ka punuar si oficer: Skrapar, Përmet,Leskovik, Korçë. Edhe në Pogradec, ai ka kryer me devotshmëri detyrat e ndryshme në polici.

Petrit Bako s’kishte mbushur ende 21 vjet kur mbaron arsimin e lartë.Ai ishte oficeri më i ri i batalionit me komandant batalioni Pilot Pano. Por ai kujton edhe shokët e shkollës së lartë që si hiqe nga mendja portretet e tyre. Ai kujton me dhimbje të ndjerin Lefter Lame, që i cili më von u bë edhe kryetar bashkie për qytetin e Çorovodës. Kujtesa shkon në vitet e largta e sjell sot të freskta kujtime edhe për shokët e tjerë siç janë: Myzafer Muka,Granit Muça,Luan Çollaku,por edhe presidentin Bujar Mehmet Nishani, të cilin e ka patur shokë klase në

shkollën e lartë në Tiranë . Dhe vazhdon duke sjellë vlera kujtimesh edhe për shokët e punës Behar Fehimi, Nexhmi Vrenezi, Eqerem Metani, Robert Zoto, Kastriot Caka, Flamur Vela, etj.

Në vitin 1998 lë qytetin e Pogradecit e largohet për në Amerikë. Aty ka 16 vite që punon e jeton, por malli e tret atje për te fshati i vogël në zemër të tomorricës, për te Burranji me ujë të kulluar. Petriti është i martuar. Fëmijët studiojnë në shkolla të ndryshme disa e kanë mbaruar atë , të tjerët vazhdojnë studimet. Esmeralda Bako- farmaciste, Geri Bako (Gensville Florida, për doktor një universitet me emër), Semi Bako,vazhdon të mesmen me rezultate të larta, Sara në klasën e katërtë,Alisa është më e vogla e fëmijëve, sapo ka mbushur dhjetë muajshe. Mbi të gjitha Petriti është një njeri që ruan në shpirtin e tij vlerat më të mira njerëzore. Mesazhet e këtij njeriu që ka kaluar nëpër dallgët oqeanike, janë plot guxim e dashuri edhe për njerëzit e tjerë, të cilët dashurinë për atdheun e ruajnë në damarë gjaku duke dhënë kontribute në dokumentimin e historisë të kohës që jetojmë, por dhe të vlerave artistike e kulturore që janë thesaret e një kombi**.(Myzejeni,Gëzimi,Enveri e Petriti**)

Durrës,12 tetor 2014.

Djali i Zhepovës Agron Dragoj, mbeti një dragua në pavdekësinë e historiës

(Me rastin e 40 vjetorit të lindjes të dëshmorit të atdheut A. Dragoj, si dhe 17 vjetori i rënies në krye të detyrës)

Sa herë që vijnë muajët prill, dhe pikërisht kur data shënon 20- të,për fisin Dragoj nënkupton shumë ngjarje e gëzime. Prill 2014! Sa bukur është kur vijnë të tilla stinë me aromën... e luleve dhe këngën e bilbilave!? Natyra ripërtëritet e të jep kënaqësi. Por, muaj prill i vitit 1974 atëherë kur data shënonte 20-të e po këtij muaji;vjen në jetë njëri nga djemtë e fisit Dragoj në Zhepovë të Përmetit. Buzëqeshte natyra. Gëzoheshin të afërmit e djalit të sapo lindur. Edhe gurët e ndjenin atë gëzim të asaj dite pranvere, e jo më njerëzit! Urimet shkuan gojë më gojë atë ditë prilli të vitit 1974, jo vetëm te banorët e fshatit Zhepovë, por madje lajmi shkoi deri në fshatrat Radenj e Pavar. Djalin e Zhepovës, fshatarët e zonës jo më kotë e pagëzuan para kohe ''Dragoj i Dëshnicës''.
Nënë Medine përkëdhelte foshnjen, dhe e vështronte me kureshtje në dritë të syrit. Atje, te ata sy të foshnjes së djalit të sapo lindur, pa diçka dhe mori frymë thellë. E vështroi edhe një herë. Mos më bëjnë sytë! –Ndoshta e kam nga gëzimi, tha me vete Medinea dhe e puthi në ballë djalin. E vështroi edhe një herë tjetër. Por… prapë diçka vërejti te sytë e djalit! Ishte e vërtetë, se në brendësi të syve të foshnjes së djalit ishte shkruar diçka. E lexoi me kujdes. Atje te ata dy sy ishte shkruar fjala Atdhe! Vetëm syri i nënës mund ta dallonte e lexonte atë fjalë! Ajo e mori foshnjen e vogël, e afroi pranë gjoksit, i dha qumshtë nga sisa e saj, prapë e puthi te balli dhe e vendosi mbi supin e majtë. Kush e pa këtë veprim të nënë Medine thanë me vete:''Po kjo ç'pati! Apo e ka nga gëzimi?!'' Sytë e foshnjes lëshonin dritë dhe buzëqeshte si lulet e pranverës.
Edhe Zaimi, i ati i foshnjes dukej sikur fluturonte nga gëzimi i lindjes së djalit. Ai e mbante brenda vetes dhe s'e shprente hapur lindjen e djalit të sapo ardhur në jetë. Në kodrën shkëmbore që ndodhej afër lagjes, shkoi aty dhe mori një copë gur. Pranë një shkëmbi kishin mbirë lule . Këputi një gonxhe luleje, dhe s'bashku me copën e gurit u kthye në shtëpi. U afrua te djepi ku djali po flinte gjumë, aty vendosi gurin e gonxhen e lules. Një simbolikë e trashëguar në shekuj kur lind një fëmijë për ne shqiptarët!
Nuk kaloj shumë kohë, e shtëpia e Zaim Dragoj u mbush plotë me miq, të afërm e bashkëfshatarë. Këndohej e hidhej valle! Sipas traditës ngrihej dolli për djalin e vogël të fisit Dragoj. Ishin thirrur në këtë gëzim familjar për pagëzimin e foshnjes. Me gotën në dorë Zaimi iu drejtua të pranishmëme duke u thënë:
-Mirë se erdhët miq! Foshnjen e pagëzojmë sot me emrin Agron! Ta gëzojë, uruan në një gojë të gjithë të pranishmit. Oda e miqëve oshëtinte e nuk rreshte për asnjë çast atë ditë mirësie në familjen e Zaimit e të Medines. Deri në mëngjes kur dielli po ''puthte'' vesën e mëngjesit të prillit pranveror, kënga e vallja nuk pushoi. Edhe djali i vogël i pagëzuar Agron i buzëqeshte diellit të pranverës.

Agron Zaim Dragoj

Dragojt e Zhepovës,-shkëmbfortesët nëpër stuhitë e historisë…

Të shkruah për fisin dragoj nuk është e lehtë, sepse veprimtaria patriotike e atdhetare e tyre është e mbushur me ngjarje sa të dhimbshme aq edhe me ndjenjën e krenarisë. Nëpër rrugëtimin historik ata kanë lënë gjurmë atdhetarie të pashlyeshme. Kurrë s'u mposhtën para vështirësive e armiqëve të atdheut i dolën ballë për ballë. Kohëve tinzare e gjithë armiqëve të kombit, iu qëndruan burrërisht deri edhe me jetën e tyre. Ndoshta, prandaj duhet të ketë marrë edhe mbiemrin ''Dragoj'' fisi i fshatit Zhepovë të Dëshnicës së Përmetit, që do të thotë sipas mitologjisë shqipe shpend i fuqishëm që mposht stuhitë.

Gjyshi i Agronit, një burrë fisnik që e kishte emrin Asllan Dragoj, lë punët e fshatit e shkon për punë në Kuçovë. Aty filloi punë punëtor krahu në puset e naftës. Qysh në fillim u bashkua me lëvizjen patriotike kundër pushtimit fashist të vendit tonë. Shtëpia e Asllanit u kthye një bazë e fuqishme e LANÇ.Vëllai i Asllanit, Bektash Dragoj ishte kryetar i Këshillit të LANÇ të fshatit Zhepovë.

Në vitin 1944 Asllani internohet në kampin famkeq të Mosburgut në Gjermani. Për veprimtari patriotike e atdhetare për çlirimin e atdheut nga pushtuesit.Edhe nipi i Asllanit që atëherë ishte vetëm 20 vjeç, në vitin 1943 internohet në kampin e Mosburgut të gjermanisë. Shtëpia e Bektash Dragoj në vitet 1941-1944, u bë një çerdhe e vërtetë patriotike në gjithë krahinën e Dëshnicës. Kjo familje ka pritur e përcjellë edhe figura të LANÇ si: Jaho Gjoleku, Mustafa Matohiti,Fato Berberi(Heroinë e popullit) ,Rustem Çepani etj. Gjyshja e Agronit, Mine Dragoj është nderuar nga Këshilli i Qarkut Gjirokastër me motivacionin:''Për kontributin e dhënë në LANÇ''. Po kështu edhe gjyshi Asllan Dragoj, pas vdekjes me çertifikatë për kontributin e dhënë në LANÇ, me rastin e 50 vjetorit të çlirimit të Atdheut. Sot Zaim e Medinea, familjarisht janë pasardhës të LANÇ, e bëjnë pjesë në Organizatën e Veteranëve të LANÇ të qytetit Durrës, ku edhe banojnë prej disa vitesh. Ata japin ndihmën e tyre për të mbajtur gjallë vlerat patriotike e historike duke përcjellë brezave të rinjë. Me ndjenjën e flaktë të patriotizmit e dashurisë së atdheut u rrit edhe Agron Zaim Dragoj.

Lulja e prillit vajton, ndërsa bilbili këngën trimit i këndon!...

Takojmë Zaimin, babain e Dëshmorit të Atdheut Agron Dragoj. Ai sytë i kishte ende me lotdhimbje edhe pas kaq vitesh për djalin e vrarë nga një dorë ogurzezë në lulen e rinisë. Pikërisht, atëherë ishte korrik i vitit1997, një vit i mbrapsht për gjithë shqiptarët. Agron Dragoj ka lindur më 20 prill të vitit 1974. Atëherë sapo kishin çelur lulet e bardha të prillit. Edhe gurët u gëzuan me ardhjen në jetë të djalit të prindrëve Zaim e Medine. Agroni kishte shumë ëndrra për t'i realizuar në jetë. Mbaron arsimin e mesëm në Zhepovë . Ai kishte një dashuri të madhe për njerëzit e vendlindjen. Në vitin 1993-1994 shkon ushtar pranë repartit nr. 6620 në rrethin Fier. Sjellja dhe guximi i tij që kishte fituar nga familja, edhe me vyrtytin më të lartë, patriotizmin e atdhedashurinë për atdheun; mbas mbarimit të ushtrisë caktohet në radhët e Flotës Luftarake Detare me detyrën e nënoficerit të Karrierës. Fillimisht në Durrës, më pas në Pashaliman të Vlorës. Por, mbas një kohe, ai rikthehet përsëri në Bisht-Pallë të Durrësit. Ishte korriku i vitit 1997. Kohë trazirash në Shqipëri. Shteti ishte shkërmoqur si rëra e detit. Në repart i shkojnë disa të rinjë të armatosur dhe i kërkuan atij t' lejonte për të hyrë në depot e armatimit. Ata donin që të plaçkisnin depot ushtarake dhe sidomos armët. Me zgjuarsi e gjak ftohtë,Agroni ju përgjigjet të rinjëve duke u thënë se armatimet janë transferuar diku gjetkë. As vetë ne s'dimë se ku ndodhen ato!

-Po armën tënde do na japësh neve!? Agroni i zënë ngusht me këtë pyetje u thotë me guxim:

- Nga kjo dorë s'lëshohet lehtë kjo armë! Me këtë përgjigje të rinjtë e armatosur u larguan nga reparti ushtarak i Bisht-Pallës. Ishte data 22 korrik, i vitit 1997 kur Agroni merr detyrën nga Komanda e Repartit për të shkuar me detyrë në Përmet . E mirëpriti këtë urdhër, sepse malli për njerëzit e vendlindjen po i brente shpirtin. U gëzuan të afrmit e bashkëfshatarët kur u takuan me djalin e tyre Agron. Kënga e valllja në familjen e fisit dragoj s'pushoi deri sa ra agu i ditës së re. Me disa shokë e bashkëfshatarë u nisën drejt Ballabanit. Duke zbritur rrugës poshtë për në Ballaban nga Radenji për në Pavër, bjenë në pritë nga një bandë e armatosur që

ishte bërë tmerri për zonën e Dëshnicës. Kriminelët e armatosur qëndronin të pozicionuar në pyllin e dendur matanë një përroi. Për në pazarin e tregëtisë nga zona e Dëshnicës për në Ballaban zbrisnin edhe fshatarët e fshatrave Shelq e Kajcë. -Ndal! Duart lartë. Hidhni sendet e lekët në tokë!,- bërtisnin fortë banditët.

- Kush jeni juve, mor burra!- foli Agroni. Ejani të bisedojmë si burrat këtu mes sheshit! Ne s'kemi as lekë e as armë si juve!? Banditët nuk ju bindën fjalëve të Agronit, dhe qëlluan drejt e në shenjë mbi trupin e tij. Vendosi dorën te brezi ku ishte pistoleta,por ai ra si lis i monçëm me trupin e gjakosur mbi lëndinën e barit e të luleve. Toka po thithte gjakun e djaloshit nga Zhepova. Banda që ishte liruar nga burgu i Vlorës, e që masakronte popullin e zanës së Dëshnicës ishte larguar. Më 20 prill 2014 Agroni do të festonte 40 vjetorin e lindje po të ishte gjallë. Kurse më 22 korrik do përkujtohet 15 vjetori i rënjes në krye të detyrës. Atëherë ishte vetëm 23 vjeç. Sot lulja e prillit vajton Agronin, ndërsa bilbilat i këndojnë trimit këngën e pavdekësisë.

Zaimi e Medineja kanë lindur,rritur edhe edukuar 7 fëmijë: 4 djem e 3 vajza. Djemtë:Besnik,Dëfrim,Asllan(ka emrin e gjyshit), Agron-Dëshmor i Atdheut. Vajzat:Lavdie, Flamure, Anisa. Ata kanë edhe 9 mbesa e 3 nipa. Të gjithë si yje. Njëri nga fëmijët e Zaimit që mban emrin e gjyshit Asllan,djalit të vet i ka thirrur emrin e Agronit. Agroni i vogël këtë vit 2014 mbushi 4 vjeç. Një koinçidencë kjo me 40 vjetorin e lindjes të Agronit dëshmor. Zaimi na rrëfen ngjarje e episode për Agronin me zemër të zhuritur e me lotin e ngrirë mbi faqe. Prill 2014! 20prill i vitit 1974! 22 korrik 1997! Korrik 2014-ta po afron. Njëra datë kujton 40 vjetrorin e lindjes, ndërsa tjetra 15 vjetorin e pavdeksisë në altarin e lirisë së atdheut. Dëshnica në zi! Njerëzit, gurët e pemët, zogjtë s'po këndonin…Lumi Vjosë ndalon për një çast rrjedhën e vajton trimin e Zhepovës! Heshtje! Vetëm heshtje atë ditë korriku në gjithë Dëshnicën heroike!

Këshilli i Ministrave, Komisioni Qëndror për Statusin e Dëshmorit të Atdheut, me vendim nr.572datë 07.03.2012 e shpall ''Dëshmor të Atdheut''Agron Zaim Dragoj Dëshmorët e atdheut janë të pavdekshëm!

Lot e lulegjaku në shtëpinë e Drita Alia!...

…Krisma, krisma armësh mbi fshatin Ballaban! Çfarë kishte ndodhur atje ?! Askush s’e dinte të vërtetën. ..! E para që doli rrugëve të Ballabanit, e që pyeste s’e çfarë kishte ndodhur atje mbi Ballaban, ishte nëna e Kajcës Drita Alia. Ajo la fshatin Kajcë e banonte familjarisht në Ballaban. Ju ngjit kodrës si një shqiponjë mali për te vendngjarja tragjike. Ju drodh zemra kur pa të shtrirë si një lis vigan atë djalë që u vra në pritë nga një dorë mizore. I ngrinë lotët në sy. Afrohet për t’i dhënë ndihmë së bashku me shokët që e shoqëronin në atë rrugëtim për në Ballaban. E vetmja fjalë që tha ishte:’’Ju thaftë dora atij që qëlloi djalin tim!’’ Heshtja e kobshme! I dridhej shpirti asaj nëne! Ju thanë buzët, ashtu si gjaku i djalit që ujiti tokën e barin e zhuritur . U ul në gjunjë, e ledhatoi me duar trupin e flokët, e puthi në ballë…! Pastaj, e rroku pas gjirit fortë, e mori rrugën s’bashku me djalin drejtë shtëpisë së saj. Edhe shumë të tjerë, si një lumë i vërtet njerëzish e shoqëruan nënën Drita Alia. Dielli e Vjosa vajtonin djalin e vrarë nga kriminelët pabesisht. Shtëpia e Qamil e Drita Alia, hapën derën e mortit. Ajo vajtonte me këngën e ligjërimeve sipas traditës së zonës. Pas disa orësh u mor vesh se djali i vrarë në pritë ishte nga fshati Zhepovë. Shtëpia e nënë Drita Alia u mbulua e gjitha në lot e lulegjaku që mbuluan arkivolin e Agronit. Lajmin te prindërit Zaim e Medine Dragoj në Zhepovë, e çoj Qamil Alia. Në çdo përvjetor, atje në vendgjarjen e kobshme mbi Ballaban, Dëshnicarët vendosin kurora lule . Edhe nënë Drita, shkon nga Durrësi në çdo përvjetor e vendos lule te ‘’Djali’’ i saj, që sot është Dëshmor i Atdheut. Agron Zaim Dragoj do kujtohet gjithmonë në breza.

Durrës, 20 Prill 2014.

Piktori Nuri Jaupllari,- mjeshtër i penelit dhe i ngjyrave jetësore

Janë të shumtë vizitorët në këto ditë të nxehta korriku te galeria e piktorit të talentuar Nuri Jaupllari. Aty vizitorët e të gjithë grupmoshave ndalojnë për të marrë pak freskinë e ngjyrave të pikturave që janë të shumëllojshme e të bëjnë për vete që me shikimin e parë. Në gamën e pikturave vizitori gjen vetveten dhe shpërthen e bëhet një me ngjyrat plot kolor që fillon nga portreti gjer te kompozimet e pikturave abstrakte,peizazhe,etj.Galeria e këtij piktori Skraparas gjendet afër detit në lagjen 13 Plazh të qytetit bregdetar të Durrësit. Më konkretisht te hotel ''Antalia'',ku piktori Nuri Jaupllari ka mbi 8 vite që punon e krijon në atë galeri. Janë të shumta ekspozitat që ka hapur Nuriu, jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë vendit. Këto ditë piktori

Nuri Jaupllari merr edhe vlersime për punimet e tija në shkallë ndërkombëtare në fushën e pikturës, pikërisht nga Akademia e Arteve Evropiane.
Edhe ftesat e këto ditëve për të merrë pjesë në ekspozitat më 22 korrik në Belgjikë, e në vjeshtë në Gjenevë e Milano,janë një dëshmi vlersuese për talentin që ka ky piktor me përmasa tashmë ndërkombëtare.
Më poshtë po paraqesim disa piktura nga ky piktor që janë kompozuar kohët e fundit.

Portret

Asllan Refati (Zylyftari),- një jetë mbi medalionin e fjalës që ngroh shpirtrat e njerzëve

Vitet kalojnë si pa kuptuar në rrjedhën e tyre.Ato rrëshqasin në akullin e të përditshmes pa zhurmë. Pastaj, në udhën e tyre ato vijnë një ditë duke trokitur në memorjen tonë duke na thënë se jemi këtu, e do t'ju rrëfejmë pak histori. Dhe kjo është më se e vërtetë. Në një lokal të qytetit bregdetar të Durrësit, takohem pas kaq vitesh me një ishkuadro të viteve të largëta të shekullit që lamë pas Asllan Refati (Zylyftari). Aty , në atë kafene ishte ulur së bashku me disa bashkëmoshatarët e vetë,si: Niazi Braçaj, Fetah Bregu, Bashkim Halili etj.

Nga e majta në të djathtë: Fetah Bregu, Xhevahir Cirongu, Niazi Braçaj, Asllan Refati, Bashkim Halili. Foto nga X h. Cirongu,Durrës 2013.

-Eja,eja djalo!,- ulu këtu se ka vend edhe për ju,- foli me një zë dashamirëse ai njeri i thjesht e modest. Shikimi i tija dukej sikur ishte zënë në faj,por në brendësi të syve dukej qartë e lexohej respekti njerëzor ndaj të tjerëve. Sipër kokës mbante një kapele me strehë. Unë nuk e zgjata, por u ula diku aty afër në një cep të tavolinës.

-Epo mirë se na erdhe, - u dëgjuan përsëri të flisnin të pranishmit e tjerë. Disa nga ata i njihja se kisha pirë edhe më parë kafe në atë lokal, kurse burrin me kapele në atë çast si kushtova edhe shumë rëndësi. Kur porositën edhe për mua një kafe, ai më foli përsëri e më pyeti për shëndetin, familjen , punën e po interesohej deri në intimitetet më të vogla të jetës. Kjo më bëri përshtypje e thashë se ky njeri për sa më pyet kaq shumë duhet të më njohë. Edhe unë po e vështroja me kureshtje e po sillja në memorjen time se kush mund të ishte ky njeri sa i thjeshtë e njrëzor.

-Më fal, nuk po më njeh!,- fali ai me një buzëqeshje të ëmbël e me një ton të butë.U zura ngusht në ato çaste, sepse kishin kaluar shumë vite e s'mund të më kujtohej ai njeri ngaqë edhe kishte ndryshuar për shkak të moshës.

-Pa më vështro me kujdes, më tha ai. Ku jemi parë e takuar vite më parë!? E vështrova përsëri, dhe sikur më erdhi diçka në kujtesë, por i sigurt nuk isha se ku mund ta kisha parë atë njeri. Në bisedë ndërhyri një burrë babaxhan që unë kisha kohë që e njihja. E quajnë Njazi Braçaj që i cili është nga fshati Muzhënckë të rrethit Skrapar, por ka shumë vite që jeton në Durrës.Pastaj më tha: ''Po Asllan Refatin e ke njohur më parë!?'' . Po, - i ktheva përgjigje, e vështrimin e treta tek i panjohuri që ishte ulur në tavolinë. Unë kisha më se 27 vite pa e takuar atë njeri sa të thjesht e modest që me fjalën e ëmbël të ngrohnte shpirtin. Tek ai njeri kishte ndryshuar fizionomia, kurse thjeshtësia e fjalës jo.

Po kush është Asllan Refati (Zylyftari)?!..

Asllan Refati (Zylyftari) ka lindur në fshatin Spatharë të rrethit Skrapar të Qarkut Berat. Ishte muaji mars i vitit 1932 kur në familjen ''Zylyftari'' erdhi në jetë djali që mori emrin Asllan. Bashkëshortët Refat e Naze, prindërit e Asllanit, u gëzuan shumë atë ditë, sa edhe gurët e fshatit të Spatharës kënduan atë ditë. Po emrin si do ja thërrasim, - thanë me një frymë nga gëzimi të afërmit që shkuan për urim te familja e Refatit. Do mendohem për këtë,- u thoshte Refati atyre.Dhe sipas zakonit mbas disa ditësh në shtëpinë e Refati u shtrua darka për thirrjen e emrit të djalit të sapo lindur. Lulet e marsit sapo kishin çelur e bora kishte marrë udhën e malit e po shkrinte.Ndërsa bilbilat po këndonin se po trokiste pranvera. Edhe në shtëpinë e Refatit këndohej e gëzohej se ishin bërë me djalë.

-Gëzuar e ta pimë me fund shëndetin e djalit Asllan!,- uroj Refati të pranishmit me gotën e rakisë në dorë. Kënga e vallja, urimet zgjatën deri në mëngjes ku dielli ledhatoi me buzëqeshje kodrat mbi Spatharë. Familja e Asllanit shquhet për atdhedashuri e mirësi. I ati Refati e nëna që e quanin Naze janë marrë me punë bujqësore e blegtorale në fshat. Jetën e tyre ata ja detikuan fëmijëve e tokës atje në fshat, por kishin në shpirt edhe dashurinë për atdheun. Ndjenja e patrotizmit i kishte rrënjët si të lisave shekullorë . Në luftën italogreke më 1940-ën, familja e Refatit si gjithë familjet e tjera të Skraparit, shkojnë muhaxhir në Gjyroven e Bilçë të Beratit për

t'u shpëtuar masakrave të monarkove grekë, që në këto vite në fshatrat e Skraparit e të Tomorricës bënë masakra nga më ç'njerëzore, gjer atje sa me anën e bajonetave të armëve vranë gra shtatzana, dogjën shtëpi e plaçkitën pasuri e bagëti të banorëve të skraparasave . Kështu, familja e Refatit u kthye në fshat në maj të vitit 1941, kur çetat shqiptare po luftonin kundër pushtuesëve italianë e grekëve. Në këto rrethana, edhe familja e Refatit e përkrahu me një herë luftën nacionalçlirimtare nga viti 1943 deri më 1944 deri me çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Moskë,Janar 1960 student.

Nga e majta në të djathtë: Hajri Shehu e Asllan Refati.

- Babai u aktivizua me çetën teritoriale të fshatit, na thotë në bisedë e sipër Asllani.Kurse vetë Asllani aktivizohet me Rininë si agjitator dhe kryente detyrën e korierit. Mbas çlirimit të Shqipërisë nga okupatori nazifashist, Asllani merr pjesë në ndërtimin e hekurudhës Durrës-Peqin në vitin 1947. Më von përsëri atë e gjen në trasenë e hekurudhës Durrës- Tiranë. Kujton ato vite të stuhishme të vrullit rinor të rinisë së tij ,por edhe të bashkëmoshatarëve që derdhën djersën e gjakun për ndërtimin e Shqipërisë. Ai krenohet sot kur udhëton me tren mbi trasetë që ka punuar edhe vetë. A nuk është kjo ndjenjë e fortë atdhedashurie për Atdheun?! Ne e

ngacmojmë për të na sjellë kujtimet e rinisë të atyre viteve, ndërsa ai loton e kujton vitet e arta të punës ndërtimore që u desh shumë sakrifica. Dhe vazhdon duke na thënë se ka punuar edhe në Kombinatin e Tekstileve në Tiranë në vitet 1949- 1950.Ndje keqëardhje që ai kombinat u shkatërrua e sot nuk ka as nam e nishan , -na thotë Asllani. Por edhe për hekurudhat që kanë mbetur në mëshirë të fatit. Hekurudhat e një vendi janë arteret e atdheut, nga ku merr zhvillim e përparim ekonomija në dobi të gjithë shoqërisë. Që këtej Asllani kthehet në vendlindje Skrapar , ku ai fillon punë në Komitetin e Rinisë së Rrethi, e vazhdon në këtë detyrë deri në vitin 1966,shef i (Agipropit) i prapagandës. Në vitin 1960 emërohet sekretar i dytë i Rinisë së rrethit Skrapar.Asllani ka mbaruar arsimin e mesëm gjimnazin,e më von shkollën e lartë të Partisë. Ai ka studiuar edhe në Mosk në vitin 1960. Përkushtim në punët shoqërore, për Asllanin ishte një kënaqësi e veçant, por edhe një art më vete për t'u shërbyerë njerëzve të thjeshtë duke shprehur para tyre mendimin e fjalën e ngrohtë në dobi të edukimit të shoqërisë. Asllani mban me vete talentin e komunikimit me dashamirësi ndaj njerëzve me fjalën që zotron kur flet me ta. Prandaj ai gëzonte e gëzon respektin e gjithë shtresave shoqërore , pavarsisht se sot është në pension pleqërie. Por, puna edukative, komunikimi mes njerëzve, përkushtimi ndaj punës, i dha mundësinë që t'i jepej edhe detyra e Sekretarit të Rinisë së Rrethit Skrapar, prej vitit 1960 deri në vitin 1966.Prej këtej, Asllani emërohet në një sektor të vështirë për ato vite, si kryetar i kooperativës bujqësore në Vëndreshë. Tashmë, ky njeri i përkushtuar tërsisht ndaj fjalës e komunikimit me njerëzit merr përsipër të punojë në një zonë të largtë, në atë të Tomorricës, nga vitit 1968 deri në vitin 1971, me detyrën sekretar partie për zonën. –Ishte një punë e vështirë, por jam krenar se aty gjeta njerëz të mbrekullueshëm dhe të përkushtuar për përparim e zhvillim në gjithë fushat e jetës , na thotë Asllan Refati pas kaq vitesh. Tomorricarët janë njerëz të urtë, të punës e me kulturë.Por edhe të besës e mikpritës aq bujarë në shpirt.Aty mësova shumë gjëra, e sidomos bardhësinë e shpirtit.Që nga viti 1966, kur në tomorricë erdhi mekanika bujqësore, bujqësia mori zhvillim të madh, por krahas saj ,edhe blegtoria, vreshtaria e frutikultura. Asllani ka shkelur në çdo fshat e shtëpi Tomorricare. Në ato vite një zhvillim të paparë mori Arsimi e Kultura. U ngritën shkolla e shtëpi kulture deri shkolla të mesme, nga ku dolën shumë kuadro me arsim të mesëm e të lartë, nga ku nuk mungojnë edhe gradat shkencore që kanë marrë djemtë e vajzat tomorricare. Asllani kujton midis të tjerëve mjaftë emra tomorricarë që janë të rregjistruar në memorjen e tij, e midis tyre ne mundëm të shkëptim vetëm disa prej tyre: Ambeli Shatro, Beshir Nuhu, Remzi Cirongu, Syrja Dorrozhani, - Leskovë, Axhem Breshani e Syrja Breshani ,- Çerricë, Shaban Mezini,- Dobrenj, Ali Saliasi, - Zhepë, Zyferr Avdasi,- Rromas, Zalo Boçi,- Tërrovë, Xhemal Ismaili,- Zaloshnje, Belul Lajthia, - Gjerbës, Iljaz Musabelliu e Sabri Musabelliu, - Ujanik, Turhan Mëlova, Abedin Biraku, Rexhep Metani,- Barç, Halim Lika,- Gjogovicë, Nesim Alimadhi,- Kuç, Bajram Cane,- Kovoçanj, etj. Ata janë shumë, e të gjithë janë futur brenda zemrës sime me dashurinë më të madhe, na thotë Asllani.Të them të vërtetën, shton në bisedë e sipër Asllani, kur më emëruan sekretar të byrisë së Ndërmarrjes Bujqësore '' 5 shtatori'' në qytetin e Çorrovadës në vitin 1971-1974, nuk më erdhi mirë që unë të larohesha nga zona e tomorricës. Isha bërë me të vërtet ''Tomorricar'' si djali i saj. Pas këtyre viteve, pra nga viti 1974 gjer në 1992, Asllani punoi në komitetin e partisë së

rrethit e në telekuminkacion, deri sa në vitin 1992 del në pension pleqërie. Kalvari i punës së këtij njeriu është i gjatë, plotë vështirësi , por edhe krenari, sa medalioni i fjalës së artë ka ngrohur me qindra e mijra zemra të njerëzve të thjashtë e punëtorë.Pë kontributet e punës në vite Asllan Refati ka marrë shumë urdhëra e medalje si: ‘”Urdhër të klasit të parë’’,’’Urdhër të klasit të dytë’’, Urdhër të klasit parë për shërbime të shquara shtetrore e shoqërore’’, ‘’ Medaljen e Punës në kombinatin e tekstileve Tiranë’’, Medaljen për shërbime të shquara në ekonomi bujqësore’’.

Zaloshnje,1988.Në foto: Hetem Bakiasi, Asllan Refati, Refail Ibrahimi, Bedri Terpollari, Selim Mersinasi.

Foto me rastin e 80 vjetorit të lindjes Mars 2012.Nga e majta në të djathtë:Refat Refati (Djali) i Asllanit, Hydaie (Bashkëshortja e Asllanit), Asllani e Flora (nusja e djalit).

Me të drejtë kjo është krenari jo vetëm për Asllanin, por edhe për brezat e sotëm e të nesërm, që me mendimin e fjalën ti shërbejmë atdheut e kombit tonë. Ky është mesazhi që na përcjell sot ky njeri i punës dhe i fjalës. Edhe sot Asllanin e gjen midis shokësh e shoqesh në Organizatën e Veteranëve të Qytetit të Durrësit, ku jep kontributet e veta në edukimin shoqëror e atdhetar.

Durrës, 21.02.2013

Reportazh

O moj Shqipe që na linde,nga ty mos u ndafshim kurrë!...

''I shtrenjti Atdhe të dua
Me rrënjë lisi-pavdekësi,
Dhe trungu i trupit në plisa
Pastaj me dashuri
I putha në pafundësi.
Shqiponja krahët i përplasi
Atje mbi gurë stralli,
Shkëndija zjarri u ndezën
Në sfondin Kuq eZi
U shkrua 28 Nëntori''

***

(Me rastin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarsisë)

Në vend të prologut…

’’-Këndoni vocët e mi,se këtu jemi në gjirin e shqipes sonë,- u tha nipërve e mbesave nëna nga Suhareka në marsin e vitit 1999-ës që kishte udhëtuar mes predhave e plumbave nëpër malet e Kosovës e kishte mbritur në qytetin bregdetar të Durrësit.’’ Më kujtohet ajo natë Marsi i atij viti me shi e borë,një dimër plot zymëti që të kallte frikë.Por ,më ’’dimër i ashpër’’ ishte lufta e që zhvillonte ushtria serbe në Kosovë ndaj vëllezërve tanë. Suhareka e gjithë Kosova ishte ndezur nga flakët e luftës për liri e pavarësi! Djemtë e vajzat Kosovare, një popull i tërë ishte ngritur në këmbë ndaj okupatorit Serb, që padrejtsishtë ishte ulur gati për 100 vjet në sofrat Kosovare. Pushtuesi bëri të pamundurën që gjatë sundimit të çfaroste e t’i largonte nga trojet e tyre Kosovarët,në radhë të parë t’i ndalonte gjuhën e kulturën ,ushqimin shpirtëror,e më pas t’u merrte trojet duke i dëbuar me politikën ekonomike duke i dërguar nëpër botë;pas kësaj edhe me dhunë për t’i larguar nga trojet e vatrat e tyre shekullore. Por,ai dimër i vitit 1999 solli pranverën e lirisë në gjithë Kosovën. U desh sakrificë e madje dhe gjakë për t’i thënë okupatorit shekullor,se ky vend ka pasur e ka zot.Me qindra e mijëra djem e vajza Kosovare e nga gjithë trojet shqiptare u gjendën atje pranë vëllezërve Kosovarë.

Ishte mesi i muajit të marsit të atij vit, kur me qindra e mijra Kosovarë iu drejtuan vatrave të shqipes nga ku gjetën ngrohtësinë e diellit pranveror. Muzgu i natës kishte rënë edhe mbi kodrat e qytetit të Durrësit. Shtëpia ime ishte aty rrëzë një kodre në skajin fundor të qytetit. Jashtë frynte erë e filloi të shoqërohej me shi. Nga jashtë u dëgjuan disa të qara fëmijësh që vinin nga lartë kodrës e dëgjoheshin deri poshtë shtëpisë sime.Ime shoqe u pikëllua kur dëgjoi këto të qara fëmije doli me të shpejtë si dallandyshe, se kështu ka dhe emrin; për të parë e vështruar se nga nga vinin këto të qara. Nga organet qeveritare të asaj kohe,edhe ne kishim marrë porosi që të rrisnim vigjilencën se armiku nuk ishte vetëm në Kosovë,sepse ai vepronte edhe këtu në Shqipëri. Qëllimi ishte që të mos gjendeshim në krah të vëllezërve Kosovarë. Por edhe këtu armiku u mund se gjaku-gjakun se bën ujë! Ata ishin e janë vëllezërit tanë të një gjaku,të një gjuhe,të një tradite e zakoni,të një trualli Arbëror! -

Dëgjoj të qara fëmijësh,- më tha gruaja.Janë lart atje në kodër!? Shkuam aty me të shpejt së bashku edhe me banorët e tjerë të lagjes. U dha alarmi se kanë ardhur vëllezërit Kosovarë e duhen strehuar pranë shtëpive tona.Ishin mbi 120 veta pleqë e fëmijë. Që të gjithë u strehuan nëpër shtëpitë e lagjes sonë.Rruga i kishte raskapitur e lodhur aq shumë sa mezi qëndronin në këmbë. Unë mora për strehim gjashtë veta,të gjithë ishin pjestarë të një familje:Një nënë rreth moshës 75 vjeçare,me nusen e djalit me dy nipat e dy mbesat.

–Djali e vetëm e kam në rreshtat e UÇK-së,atje në Suharekë,- u dëgjua zëri gjysëm i mekur i asaj nënë me sy si të shqiponjës. Syt iu mbushën me lot kur pa nga ekrani i televizorit shtëpitë e shkrumbosura nga bombardimet e shkaut në Prekaz e në gjithë Kosovën. U çua në këmbë e puthi nipat e mbesat,pastaj puthi edhe fëmijët e mi: Dy vajzat e djalin….Dhe vazhdoi t’u thoshte fëmijëve se këtu jemi në shtëpinë tonë, jemi në Durrësin e Shqipes.Që nga ky çast, me

buzëqeshje pranverore e përqafime filluan të loznin s’bashku fëmijtë nëpër shtëpi. Edhe ata e ndjenin në shpirt erën e lirisë së Kosovës,pavarsisht se ishin të vegjël.Pas disa ditësh familjet Kosovare me gjithë bujarinë e pritjes nga famijlet Durrësake u vendosën në kampin e pritjes të Rashbullit. Ata vinin nga Mitrovica,Peja,Deçani,Prizreni,Gjakova,Prekazi Gjilani, Suhareka ,nga gjithë Kosova.Qeveria shqiptare dhe shqiptarët e Shqipërisë iu gjendën afër dhe ndihmuan vëllezërit e një gjaku,shqiptarët e Kosovës në marsin e vitit 1999.

…Dhe ja,së bashku me pranverën lulja e lirisë erdhi edhe në Kosovë!

…Udhëtim drejt Prizrenit…!

Shtëpia ku u mbajt Lidhja e Prizrenit më 10 Qërshar 1878.

Kishte kaluar mesi i muajit Tetor kur ne udhëtuam nga Durrësi drejt Qafë Morinës për në Kosovë. Furgoni ynë ecte ngadalë përgjatë rrugës së Kombit.Vizitorët që udhëtonin me këtë furgon,donin edhe të shikonin jo vetëm bukuritë natyrore,por edhe rrugën që gjarpëron luginës së lumit Fan. Një rrugë që të ''fton''të udhëtosh e të ndjesh kënaqësi për faktin se kjo rrugë trupëzoi pjesën tjetër të Kombit tonë të ndarë padrejtësisht nga fqinjët tanë. Kjo guid drejt Kosovës ishte e organizuar nge agjensia''Dyrrah'', ku udhërrëfyesi ynë Ahmed Ejupi herë pas here bënte edhe shpegimet e tij,sepse shumica e vizitorëve që shkonin për në Kosovë shkonin për herë të parë. Ata ishin:Abdulla Deliallisi,Genc Domi,Naxhije Guza,Nigjare Çyrbja,Nexhid Picari,Bajram Domi,Fatime Sulçe,Donika Osmani,Lavdije Çopa,Hamza Guri,Shaqir Kaçuli,Xheladin Mitraku,Avdulla Omuri,Asije Haka etj. Furgoni ishte komod e aty nuk reshti kënga,bisedat,por dhe humori qa gazmor e dashamirës ku udhëtimi nuk të rëndohej e se ndjeje lodhjen në këtë udhëtim drejt vëllezrëve të një gjaku,të një gjuhe,të një flamuri me shqiponjën në mes.Ndalesën e parë e bëmë në kompleksin''Kastrati''ku pimë ujë të ftohtë bjeshke,por dikush piu edhe kafe apo ndezi cigare në ajrin e pastër buzë lumit Fan atje në Rubik. Pas rreth dy ore mbritëm në qytetin e Kukësit,ky qytet ''Kryeqytet'' i Shqipërisë që priti e përcolli mbi 600 mijë shqiptarë të Kosovës martire në vitin 1999.Atje mbi malin Gjallicë një re e bardhë si qeleshe malsori,dukej sikur na përshëndeste neve vizitorëve që po shkonim në atë udhëtim në Prizren , aty ku lindi foshnja e parë e mendimit të bashkimit të gjithë shqiptarëve më 10 Qërshor të vitit 1878.Mbrapa lamë Kukësin ,kaluam Qaf Morinën e furgoni ynë mori rrugën drejt Prizrenit.Në orën 12 të drekës ''Puthëm'' gurët e kalldrëmta të tij. Historia e këtij qyteti është e lashtë sa dhe vetë populli shqiptar. Kalaja mbi qytet, rrugët e klldrëmta, ndërtesat e vjetra antike të ruajtura me shumë fantazi,pllakat përkujtimore,mbishkrimet nëpër objektet e ndërtimit qysh nga lashtësia, bustet dhe shtatoret e heronjëve të djeshëm dhe të sotëm, e mbi të gjitha shtëpia e Lidhjes së Prizrenit,flisnin për historinë e popullit tonë në shekuj. Qëndra e vjetër tregëtare e këtij qyteti është një pikë nervagjike tërheqëse për vizitorët që shkojnë aty,sepse të prezantohet e djeshmja me kulturën e sotme maderne. Ky prezantim i dy kulturave të fton në gjirin e vet në këtë qytet të Kosovës. Pasi bëmë rregjistrimin për fjetje në hotel ''Alvida''që ndodhej në qëndër të qytetit,vizitën e parë e bëmë në shtëpinë muze të Lidhjes së Prizrenit.Aty në grup dhe në veçanti,sipas dëshirës u bënë edhe foto përkujtimore,sepse ajo ditë dhe ky viti 2012-ës, ishte në virgjilin e madh të 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarsisë të shtetit tonë . Publicisti,poeti dhe shkrimtari Xhevahir Cirongu i dhuroi edhe dy libra kësaj shtëpie muze. Flamuri Kuq e Zi,simboli i Kombit tonë qëndronte kryelart para godinës së Lidhjes. E puthëm e u përlotëm të gjithë,sepse u deshën shekuj me radhë e lumenjë gjaku të derdhur nga ne shqiptarët që ai flamur të valëzojë hijshëm e krenar në gjithë trojet shqiptare. Në Lidhjen e Prizrenit morën pjesë edhe Boshnjak të Bosnjes dhe Selaniku(shqiptarë të asimiluar),vilajetet Prizren,Shkodër, Manastir e Janinë,që ishin pjesë e shtetit otoman. Lidhja e Prizrenit ishte e para lidhje e organizuar politikisht,administrative dhe ushtarak. Në krye qëndronin Abdyl Frashëri,Ymer Prizreni,Sulejman Vokshi,Ahmet Koronica e shumë patriotë të tjerë që sakrifikuan për kombin. Kjo pikënisje shënoi edhe kurorëzimin e Pavarsisë më 28 nëntor 1912-ës,ku gjithë delegatët e trojeve shqiptare në Vlorën heroike firmosën aktin e madh të Shpallje së Pavarsisë, e cila e shkëputi përfundimisht nga sundimi 500 vjeçar osman. Ishte plaku i urtë dhe dipllomati Ismail bej Vlora,Isa Boletini,Luigj Gurakuqi,e shumë të tjerë patriotë që do kujtohen brez pas brezi ,që me firmën e tyre formuan Shtetin e parë Shqiptar.Viti 2012 është një vit simbol për gjithë ne Shqiptarët,sepse festojmë 100 vjetiorin e shtetit tonë.Kjo na bën që të kujtojmë të djeshmen,të sotmen dhe të jemi të bashkuar për të nesrmen, që padrejtësitë e bëra në kurriz të Kombit tonë nga klanet ogurzeza të fqinjëve tanë;padrejtësia e copëtimit të trupit të

Atdheut të rivendoset drejtësia. Ne si shqiptarë historikisht kemi ndihmuar në shtetformime të tjerët. Po ne pse na coptuan qysh në foshnje të sapo lindjes së shtetformim të shtetit tonë?!
-Kjo është një padrejtësi historike që fqinjët kanë bërë ndaj nesh,-shprehet plaku 75 vjeçar Shaqir Kaçuli nga qyteti i Durrësit teksa bëri një foto para Lidhjes së shtëpisë së Prizrenit. Në mbrëmje së bashku me prizrenasit shëtitëm bulevardeve të qytetit. Mirësjellje e buzëqeshje vllazërore ngado që shkuam në atë qytet sa të lashtë e historik.

Besa –besë për ty Atdhe! (Në foto Xh.Cirongu)

…Po ku je moj "Nënë'' e Suharekës!?

Në mëngjes të asaj dite tetori,ku dielli përflakte si gjaku i kuq atje mbi kodrën e qytetit nga ku dukeshin qartë bedenat e kalasë,hëngrëm mëngjesin në restorantin e hotelit dhe u nisëm me makinën tonë për në drejtim të Sauharekës. Nga artopolani i makinës sonë këndohej këngë patrotike e atdhetare. Edhe ne këndonim rrugës për në Suharekë.Kosovarët na përshëndesnin me dorë e na uronin vizita të mbara në Kosovë.Ishte e dallueshme për gjatë rrugës se ngado ishin vendosur bustet e dëshmorëve të UÇK-së që dhanë jetën e tyre për çlirimin e Kosovës nga okupatori serb. Më tutje një pllakë mermeri me emra të

shkruar sipër saj të djemëve e vajzave Kosovare që derdhën gjakun për një Kosovë të lirë. Gjethet e pemëve kishin marë ngjyrën e gjakut në këto ditë vjeshte,ndoshta ato kanë thithur edhe gjakun e të rënëve për liri,që e sotmja dhe e nesrmja të ketë gjithmonë përjetësi!
Donika Osmanaj nuk iu nda për asnjë çast valleve e këngëve edhe pse makina ishte në ecje e sipër gjatë rrugës ngado që shkuam..Po kështu edhe Asije Haka,Nexhmije Guza,Genc Domi,Nexhid Picari,Shaqir Kaçuli etj.Shoferi ynë ishte shumë i vëmendshëm,sepse kishte nënpërgjegjësi jo pak por rreth 26 vetë. Dhe ja më së fundi makina ndaloi në Therandë(Qëndra e Suharekës). Aty na befasoi pamja mbi urë dhe kur kalojmë nëpër atë, na duket sikur futemi në botën e internetit.Konstruksioni në formën e ''@'' mbi urë,simbolit të E-malit,na krijon ndjenjën e modernizuar të jetës e vendit tonë.Sa bukur !Po kush ishte vallë ideatori i kësaj vepre kaq moderrne dhe stil brilant në estetik e arkitektor që befason vizitorin!? Këtë nuk e zbuluam dot,sepse ne nuk pushuam edhe shumë aty. Në qendër të Therandës mbi muret e një shtëpie të vjetër dy katshe ishte shkruar"Shoqata e lidhjes e invalidëve dhe viktimave civilë të luftës në Kosovë''.Në krye si gjithmonë:Flamuri kombëtar Kuq e Zi dhe ai i zyrtar i Kosovës. Unë hodha sytë atje përballë kodrave përtej fushave nga ku dukeshin qartë fshatrat që tashmë ishin rindërtuar pas lufte;e se si m'u kujtua ajo nënë e Suharekës që ishte në shtëpinë time në marsin e vitit 1999, s'bashku me nipa e mbesa e nusen e djalit, që tashmë nuk i mbaj dot mend emrin,prandaj po them ''Nëna'' e Suharekës. Djali i saj i vetëm i cili ishte rreshtuar përkrahë formacionit luftarak të UÇK,erdhi nëpër zjarrin e luftës e plumbave të shkaut e më takon në Durrës ,duke më falnderuar për kujdesin ndaj të afrëmve të tij në marsin e vitit 1999.Vitet kalojnë,por kujtesa sjell në mendje atë mikëpritje të vëllezërve tanë Kosovarë.

Jo vetëm njerëzit,por edhe toka,gurët ,pemët,lulet e çdo gjë që shikon në Kosovë,ka aromë lirie me rrënjë tek gjaku i dëshmorëve të djemëve e vajzave me në krye Komandantin legjendar Adem Jashari. Që nga Theranda, unë prapë hodha sytë në shtëpitë përtej kodrave e pyeta veten se ku mund të jetë tani ajo nënë e Suharekës!
Lamë pas Therandën e makina mori rrugën për në Lipjan.

…Në shpellën Gadime!....

Edhe për gjatë udhëtimit për në Prishtinë, ku na duhej 70 kilometra rrugë për të mbritur deri aty,Ahmed Ejupi nuk rreshti as për një çast, por na tregonte si një ciceron i plotfuqishëm për historinë dhe bëmat në shekuj të Kosovarëve për liri e pavarësi. Ai ,për faktin se është edhe me orogjinë po nga kosova,pavarsisht se është lindur dhe rritur në Durrës, pasioni i tij dhe meraku ishte që ne të njiheshim sa më shumë për t'i mësuar të fshehtat e kulturës sonë edhe të nëntokës. Lamë pas Therandën e mbas një ore arritëm në Lipjan. Rruga ishte e mirë dhe kishte gjithë sinjalistikën e duhur bashkëkohore.
–Ndalohe makinën ,-u dëgjua zëri urdhërues i Ahmed Ejupit që iu drejtua në këtë çast shoferit tonë.
-Epo ,na fal se'' ngatërrova ''rrugën,-ktheu andej djathtas se do shkojmë për në Gadime!- u dëgjua ai zë plot ëmbëlsi i udhërrëfyesit tonë.Sakaq,makina u thye mbrapsht e mori drejtimin nga rrugë që të çonte për tek shpella Gadime.Që aty ecëm rreth 5-6 kilometra dhe më s'fundi mbritëm në destinacion.
-Ja,aty ndodhet shpella,-tha prerazi Abdulla Omuri.Ai kishte qënë edhe më parë e po na tregonte se kjo

shpellë ka të veçantat e saj.Pasi premë biletat e hyrjes,ashtu siç ishim ymë s’bashku me ciceronin e shpellës.Ai filloi të na tregonte për ‘’magjinë’’e historikut dhe të përmbajtjes të asaj shpelle për nga vlerat kulturale piktoreske edukuese. Kishin ardhur për vizitë në atë shpellë edhe vizitorë nga Tepelena,sepse ne vinim nga Durrësi e Tirana,që s’bashku me ne hynë edhe ata për ta vizituar. Kjo për ne qe një befasi,sepse nuk kishim informacion më parë. Ne ndiqnim me kureshtje ciceronin Betim Tasholli, një djalë plot kulturë e mirësjellje në shpegime të formacioneve sklupturale natyrore që gjendeshin në thellësi të asaj shpelle.Shpella ishte 1.350 km. e gjatë,na ku 15 km ishte ende pa u zbuluar,e me një vjetërsi 80 milionë vjet jetë. Shpella e Mermerit në Gadime të Kosovës është zbuluar për herë të parë në vitin 1969, nga një fshatar që kishte shtëpinë sipër saj.Ajo u zbulua rastësisht,kur Ahmet Asllani,banor i fshatit po ndërtonte një shtëpi të re.Sot ajo shpellë është pasuri kombëtare e popullit Kosovar e mbarëshqiptar. Më shumë se një vepër arti natyror,kjo shpellë është edhe një dëshmi e qartë se shqiptarët kanë qënë dhe janë oktoton banorë në tokën e tyre.

Mbas kësaj vizite interesante e mbrslënse kaluam në Fushë Kosovë nga ku tokat dhe fusha e Kosovës ishte për ne vizitorët e parë shumë tërheqëse,saqë shikimi humbiste në pafundësinë e tokave pjellore të punuara si një qylim me plot prodhimtari.Më së fundi mbritëm në Prishtinë.Ora kishte shkuar rreth 12 e drekës. Nga Prizreni deri në Prishtinë kishim plotë 5 orë rrugë e vizita në qytete e Komuna.

Mirëdita, zonjë Prishtinë!...

Po,po kështu do i themi Prishtinës sonë,kësaj zonjë të bekuar nga vetë zoti! Ajo të rrëmben me bukurinë e saj qysh në fillim. Ndalojmë në qendër të qytetit.Një qytet plot gjallëri,aty ku punohet e ndërtohet,por dhe mësohet në universit e shkolla,në qendra kulturore e artistike,në Bibliotekën e qytetit hyjnë e dalin qytetarët e saj që marrin libra e informacion,aty ku bëhet politikë që e nesrmja të jetë edhe më e bukur për gjithë Kosovën,për gjithë shqiptarët. Pra,jeta aty ka ndezur motorrët e zhvillimit e të përparimit shoqëror.

Që nga çlirimi , Prishtina ka marrë një pamje e frymarrje tjetër,më domethënse e zhvillim të paparë gjatë këtyre viteve të çlirimit të saj nga Serbia.Kudo,nëpër godinat shtetrore falëvitej krenar flamuri ynë Kombëtar,krahas tij dhe ai shtetëror. Por , në këtë udhëtim nëpër Kosovë ne pamë nëpër shtëpitë e qytetarëve Kosovarë të falëvitej flamuri Kombëtar, Kuq e Zi. Me gjithëse ishte Tetor, aty 100 vjetori i Shpalljes së Paversisë dhe data 28 Nëntor 2012 kishin kohë që festimet kishin filluar. Në mbas- diten e asaj dite tetori të ndërthurur me peizazhin shumëngjyrësh natyror dhe të flamujëve të cilët valëviteshin në qiellin e kaltër të lirë e sovranë në tokën Arbërore! Prandaj ne i thamë atë ditë tetori Kosovës e Prishtinës , Atdhedashurisë e Trimërisë, Arsimit e Kulturës ,zhvillimit dhe posporitetit mbarë shqiptare në gjithë trojet tona:Mirdita zonjë Prishtinë! Largohemi nga Prishtina drejt Prekazit,Deçanit,e paskësaj dalim në Qafë Morinë për t’u kthyerë në Tiranë e Durrës. Nga kjo vizitë ne morëm

shumë kujtime me vete,por edhe me mallin për t'u kthyer përsëri atje tek vëllezërit tanë Kosovarë,- thotë në bisedë e sipër Lavdie Çopa e Fatime Sulçe.
U ndamë me njëri-tjetrin duke bërë urimin e festës së 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarsisë .

Në këto ditë Nëntori të 2012,qielli shqiptar është ndezur nga ngjyra e kuqe e flamurit të Kombit tonë në të gjitha trojet ,por edhe në gjithë shtetet atje ku punojnë e jetojnë shqiptarët!
Gëzuar 100 vjetorin!

Vendi i mikëpritjes të Kosovarëve në vitin 1999 në Qytetin e Kukësit.

Pamje nga qyteti i Kukësit

Durrës,13 Nëntor 2012

...Një kafe me pedagog Astritin

Ishte shtator i 2013, atje te pallatet me shigjeta në Tiranë kur unë takohem me pedagog Astritin. Para se të shkoja atje, atij i telefonava që nga Durrësi. Edhe ai më kishte bërë shumë telefonata më parë, bisedonim gjatë, më dërgonte edhe të falura me të njojtur të ndryshëm, por mallin s'e shuanim dot në këtë mënyrë. Një herë që nga telefoni si me shaka më tha:

-More Xhevo, kur do e pimë s'bashku një kafe!? Kam kohë pa të parë...jemi nga një fshat, e mbi të gjitha edhe të një gjaku!

-E pse jo, unë kam kërkuar nga juve disa të dhëna për shkrimin që do bëj për Bexhetin, majorin e fshatit tonë! Koha e ka lënë këtë ish ushtarak shëmbullor që dha jetën për atdheun pothuajse të harruar! Të kam dërguar edhe një E-mail, por nuk e di a e ke marrë! Po pres përgjigjen nga ju.

-Eja e bisedojmë këtu në Tiranë, më tha ai.

- Aty do vimë e takohemi, por dërgomi me E-mail ato çfar ju kam shkruar, e pastaj takohemi kur të duash. ..Dhe ato çfar kërkova unë më erdhën me postën elektronike. Nuk kaloj shumë kohë dhe shkrimin e botova në disa gazeta. Unë u ndjeva i entuziazmuar, sepse shkrova për një dëshmor të pa shpallur.Falnderimet vinin gjithandej. Ishte fillimshtatori i vitit 2013, atje në një lokal afër pallateve me shigjeta unë takohem me pedagog Astritin. Më shumë se një kafe, bisedat tona shuan mallin e viteve të kujtimeve të fëmijërisë atje në fshatin e lindjes Leskovë të Skraparit. Astriti fliste e lexonte shkrimin, por edhe lotonte për të atin që e la jetim së bashku me motrën Lume.

- Që nga ajo kohë kanë kaluar 54 vite, kur babai im ra në krye të detyrës atje në Seman të Fierit,por sot kur lexoj rreshta kujtimesh që juve si gazetar keni shkruar në gazetën ''Republika" më duket sikur bisedoj me babain tim!,- na thotë Astriti.

Dikur të rinjë, sot që të dy me thinja të bardha. Aty te ai lokal bëmë së bashku edhe një foto. Le të mbetet edhe kjo foto një kujtim që t'u flasi nesër të tjerëve.

Foto: Astrit Shatro e Xhvahir Cirongu (Shtator 2013)

‘’Drenica’’ e Durrësit dhe 15 vjetrori i çlirimit të Kosovës

(Me rastin e 15 vjetorit të hyrjes së NATO-s në Kosovë,qërshor 1999 e të çlirimit të mbarë kosovës martire).

Sa herë që marrin vizitorët e ndryshëm rrugën për në Shqipëri, ata do stacionojnë pak çste te memoriali ‘’Luftëtari i Lirisë’’ në qytetin bregdetar të Durrësit. Qytetit të Durrësit i është shtuar edhe një simbol tjetër, që na tregon e do na tregojë në shekuj historinë e bashkimit të të gjithave trojeve shqiptare. Prill 1939! Prill1999!Vite lufte në këto dy ngjarje me rëndësi jetike për popullin shqiptar. Njëri vit ’39, i kobshëm për popullin shqiptar. Atëherë kur ‘’Sorrat’’ e zeza Musoliane zbarkuan dhe pushtuan Shqipërinë. Ishte 7 prilli i vitit 1939-ës. Qielli i shqipes u nxi dhe toka rënkonte nga çizmja e fashizmit Italian. Por…Kosova martire edhe pas Luftës së Dytë Botërore, mbeti nën thundrën e serbit. Një padrejtësi e historiisë dhe e politikës së kohërave ndaj popullit të vogël shqiptar , por me shpirti të madh që në gjak ka lirnë. Familja patriotike e Sadri Kapitit ka dhënë kontributet e saj si në luftën e Dytë Botrore në çlirimin e Shqipërisë,por edhe në vitin 1999 në çlirimin e Kosovës.Sadri Kapiti ishte invalid I LANÇ. Këtë vit festojmë 70 vjetorin e çlirimit të Shqipërisë e të 15 vjetorit të çlirimit të Kosovës. Dy festa që do mbeten simbole në shekuj për ne shqiptarët.
Mbas 60 vitesh që nga viti 1939,erdhi viti plot lavdi me bekimin e ‘’Baba Tomorri’’ muaji prill me kurorë të bardha lulesh, ku qe shkruar Liria e Pavarsia e Kosovës! Ishte prilli i vitit 1999-ës!Këtë vit, shqiponjat shqiptare nga perëndimi e diaspora erdhën në Durrës; te ky qytet i lashtë e historik, pranë valëve të detit adriatik. Pikërisht, atje te vatra patriotike e pagëzuar me emrin’’Drenica e Durrësit’’ e vëllezërve ‘’Kapiti’’. Ata ishin luftëtarët e lirisë, të cilët lanë luksin e perëndimit, dhe s’kursyen përveç të tjerave, as edhe gjakun e tyre për çlirimin e gjysmës së kombit e të atdheut, të Kosovës martire.
Në atë kohë,e gjithë bota u tund si tërmet. Popujt e kombeve në gjithë globin, panë me sytë e tyre në stacionet televizive e në gazeta, barbarizmat e gjenocidin serb ndaj shqiptarëve të Kosovës. Nga ky barbarizëm i pashoq, bota e qytetëruar, s’e kishte parë më parë. Si rrjedhojë i këtij gjenocidi, nga Kosova u larguan mbi 800 mijë shqiptarë. Peshën kryesore e mbajti Shqipëria: mbi 500 mijë veta. Bijët e bijat, të Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë , nga gjithë trojet shqiptare e diaspora; ju përgjigjën trimërisht thirrjes së Atdheut, për çlirimin e Kosovës nga okupatori shekullor serb, që edhe ajo të ishte e lirë dhe e pavarur. ‘’Drenica’’ e Durrësit, u bë kryeqendra e pritjes dhe e bashkimit të të gjithë vullentarëve të lirisë, për t’i thënë përfundimisht pushtuesit serb se, ky vend këtu ka zot. U desh shumë sakrificë e gjak që të vinte dita e lirisë dhe pavarsia e Kosovës. Pikërisht, qërshori i këtij viti 2014-ës, populli shqiptar do festojë me madhështi 15 vjetrorin e Çlirimit të Kosovës e 70 vjetorin e Çlirimit nga bisha nazifashiste të Luftës së Dytë Botërore . Nëntor 1944- nëntor 2014. Shqipëria u bashkangjit kualicionit dhe frontit antifashistë botëror, qysh në fillimet e tij, me në krye aleatin tonë të madh ShBA. Pas kaq dekadash, erdhi koha që SHBA-ja iu gjend në krahë shqiptarëve, e në veçanti Kosovës. Ishte pikërisht, aleati ynë strategjik SHBA e cila udhëhoqi NATO për çlirimin e Kosovës nga okupatori serb. Dhe më pas, më 17 shkurt të vitit 2008 Kosova shpallt Shtet i Pavarur e Sovran.

Historia flet në çdo kohë, por bën edhe apel që ajo të mos harrohet kurrë. Të kujtohet e t'u flasi brezave. Sot, në qytetin e Durrëst, pas kaq vitesh nga ajo ngjarje madhore e vitit 1999, për popullin shqiptar e të Kosovës martire qëndron kryelart memoriali ''Luftëtari i Lirisë''. Aty, te ai lokal i vogël (ish dikur) buzë detit adriatik, u shkrua me gërma të arta e të lyera me gjak dëshmori Liria e Pavarësia e Kosovës. Memoriali ''Luftëtar i Lirisë'' përjetëson historinë e lavdishme të luftës së Kosovës e të kombit tonë. Përveç memorialit është shkruar edhe një libër që fletë për atë lokal të vogël, por që u kthye në një ambasadë e vërtetë diplomatikoushtarake. Libri me titull ''Atdhetarizmi jeton në përjetësi'', me autor Bedri Tahiri nga Vushtrria e Kosovës, midis ngjarjeve të tjerave të cilat janë të shumta, flet edhe për kontributin atdhetar të familjes së Sadri Kapiti. Janë të shumtë inetektualë, akademikë, diplomatë e politikanë, shoqata të ndryshme atdhetare e kulturore, që u janë drejtuar instancave më të larta shtetërore si në Shqipëri e Kosovë që ''Drenica e Durrësit'' të shpallet Muze Historik Kombëtar. Ne po sjellim disa vlerësime në këtë shkrim, sepse ato janë të shumta që kanë bërë personalitete të të gjithave fushave.
Me të drejtë gazetari Thanas Mustaqi në një reportazh të botuar në gazetën ''Zëri i popullit'' më 9 prill të vitit 2000, shkruan se, '' Populli e ka shpallur me zemër ''Drenicën'' një ''Mekë'' të atdhedashurise.''
"Sadri Kapiti ka qenë burrë mbi burra. Fakti është që edhe bijtë ndoqen besnikërisht rrugën e tij"- ka thënë z. Qemal Mançe, , ish-kryetar i Shoqatës së Invalidëve të LANÇ për rrethin e Durrësit, tashmë i ndjerë.''
@ ''Drenica'' e Durrësit është qendra kryesore e frymëzimeve atdhetare ëtu buzë detit, është Tempull atdhetarie.Më vjen mire që kjo shtëpi lirie dhe tempull i atdhetarisë, pikërisht u pagëzua nga poetët dhe artistët. Ajo e ndërshqiptarizoi këtë vend, nga i cili buroi jetësimi i çështjes sonë madhore, çlirimi kombëtar.''
(Xhevahir Spahiu, poet e akademik)
@''Ushtria Çlirimtare e Kosovës është Lëvizja më e mirë që ka krijuar populli shqiptar.Ajo ngriti tensionin botëror dhe i dha argument Amerikës dhe botës së qytetëruar për ta bërë politikën'' (Spartak Ngjela, avokat) ''Emri i nderuari ''Drenica'' do të kujtohet gjithashtu edhe si kontribut atdhetar e patriotik i djemëve të familjes së respektuar Kapiti. Ajo meriton që të kujtohet një qëndër e edukimit atdhetar dhe patriotik të brezit të ri. (Bujar Muharremi, ish diplomat e ambasador i Shqipërisë në Kosovë, tashmë i ndjerë)
''Ky është një moment historik i cili si i tillë duhet të përjetësohet nga të dy qeveritë tona, në Tiranë e në Prishtinë, dhe kjo të futet në planprogramet e tyre si pjesë e histories kombëtare ku brezat e rinj ta vizitojnë rregullisht.'' (Ilir Malindi,shkrimtar e avokat).
Shfletojmë dokumentat e kohës, të cilat u shkruan në zjarrin e luftës për çlirimin e Kosovës. Kanë kaluar 15 vjet që nga ajo kohë, dhe qërshori i këtij viti, 2014, na jep krenarinë ligjitime.
''Lufta nga 28 shkurt 1998 e deri më 23 mars 1999 u zhvillua mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave jugosllave. Ndërsa nga 24 mars 1999 e deri më 10 qershor 1999, Aleanca Veriatlantike NATO me bombardime të përditshme në caqet ushtarake jugosllave, me përkrahjen tokësore të UÇK-së detyroi forcat serbomalazeze dhe Kasapin e Ballkanit Sllobodan Millosheviçin të nënshkruaj kapitullimin në Kumanovë.''

''Nga Memoriali "DRENICA" atë ditë festive historike, iu dërgua një letër përshëndetëse Xhorxh Bushit, të cilën, para të pranishmëve e lexoi publicisti dhe krijuesi i njohur, z. Bashkim Hoxha.

Nga kjo deklaratë ne shkëputëm këtë fragment ku thuhet:
’’… Nëpërmjet jush ne dëshirojmë t’i shprehim mirënjohjen tonë Kongresit të SHBA dhe institucioneve të tjera ligjvënëse amerikane, të cilat kanë qenë gjithnjë të ndjeshëm në miratimin e një varg rezolutash, ku është denoncuar dhe dënuar shkelja e të drejtave të njeriut në Kosovë, dhuna dhe terrori sistematik i Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës, dënimi i politikave të spastrimit etnik….’’
Qërshori 2014-ës, erdhi edhe më i bukur! Këtë radhë me aromë Lirie!. Atje te Memoriali ’’Luftëtari i Lirisë’’ në Durrës do vendosim tufa lulesh me aromë lirie në këtë 15 vjetor e përgjithmonë në shekuj. Kështu do jesh mot e jetë e qeshur Kosova ime!

Durrës, 11 qërshor 2014.

Memoriali "Luftëtari i Lirisë" te "Drenica" e Durrësit.
foto nga xh. Cirongu, prill 2014.



Tomorr Torra,-drugdhendësi nga Mokra e Pogradecit që s'e njeh plakjen

Të shkruash diçka për njerëz të tillë nuk është edhe aq e lehtë. Ata janë të thjeshtë e të dashur. Që me takimin e parë,kur bisedon rreth punës së tyre, të bëjnë për vete me atë modesti karakteristike, që brenda shpirtit të tyre vlon pjalmi e poleni i artistit popullor.Njerëz të tillë janë të rrallë,saqë është vështirë për t'i identifikuar nga të tjerët. Me dhuntinën që kanë këta njerëz, kjo dhuratë e zotit, bëjnë që duke gëdhendur drurët me daltë e struk, na dhurojnë plot shije sende të bukura që na shërbejnë të gjithëve ne.I tillë është edhe Tomorr Torra nga Mokra e Pogradecit. Para disa kohësh ne takojmë këtë njeri duarartë dhe bisedojmë me atë.Nga biseda që bëmë me Tomorrin, mësuam se ai ka ardhur me banim nga Mokra e Pogradecit qysh në vitin 1990 në qytetin e Kavajës. Në këtë qytet është vendosur familjarisht. Me punimet e drurit, si Tunc,Bute vere, Bucelë uji, apo gëdhendje të tjera zbukurimi në dru, e kishim takuar në tregjet e qyteteve Kavajë, Tiranë, Durrës, apo Rrogizhinë e Peqin. Por ai shkon edhe në qytetin e Lushnjes.Një njeri i kudondodhur,që reklamon e shet punimet e drurit që i prodhon vetë ai.

Tomorr Torra sapo ka mbushur të 70 vjetët. Ka mbi 5 vjet që ka dalë në pension. E megjithatë, profesionit të bukur të drugëdhendësit s'ju është ndarë kurrë.

-Kam një jetë të tërë që me drurin jam ''dashuruar'' e me drurin dua edhe të vdes,-na thotë ai.Me këto duar,(dhe na tregon shuplakat e duarëve plot kallo), kam një jetë të tërë e me punë të ndershme linda e rrita gjashtë fëmijë: 2 Vajza e 4 djem. Të gjithë të martuar e me fëmijë.Kjo punë e drurit më ka lumturuar që nga fëmijëria e deri sot.Me lot në sy na thotë se, me daltën mbi dru duke gëdhendur edhe dua të vdes! Largohesh nga artisti popullor Tomorr Torra, e me vete merr buzëqeshjen e bardhësisë së shpirtit të tij, që moshës së thyer i thotë me punët artistike se ende jam i ri e s'e njoh plakjen.Të gjitha punimet artizanale Tomorri i punon me dru lisi,arrni e ahu. Më vjen keq, kur disa njerës të papërgjegjshëm ''vrasin'' pyjet, na thotë Tomorri. E për këtë bindesh te ky njeri e do marrëzisht punën,por edhe artin e gdhendjes së drurit.

Durrës, 30 maj 2014.

Në foto nga e majta në të djathtë:Tomorr Torra e Qazim Hasbajrami.

Foto Xh.Cirongu maj 2014.

Nga e majta në të djathtë Tomorr Torra e Qazim Hasbajrami

Gazeta ''Muzgu'' një yll polar e fjalës letrare Shqipe

Në larminë e botimeve të gazetave që botohen sot në Shqipëri, si një uragan letrar është bërë pjesë edhe gazeta letrare'' Muzgu''. Kjo gazetë po tërheq çdo ditë e më shumë nga gjithë vendi e diaspora krijuesit tanë. Aty botohen krijimet letrare e gjithë krijuesëve të vjetër dhe të rinj. Kjo gazetë, është e re që del në treg. Sapo ka hyrë në vitin e dytë të jetës së saj me botues Mark Simoni. Aty përfshihen botime letrare të ndryshme, paprjashtim e në gjithë fushat letrare. E veçanta e kësaj gazete është se, aty gjen faqe të veçantë botuese për tematika të llojeve e gjinive letrare, të cilat përfshihen në antologji poetike. Kjo është një risi si për nga lloji,por edhe gjithëpërfshirëse me sa më shumë autorë.Prurjet letrare të autorëve të të gjitha fushave krijuese, dhe botimet e tyre në gazetën letrare''Muzgu'', më e madhja që gjendet sot në vendin tonë. Gazeta ''Muzgu'' po kthehet dalngadalë,si një yll polar në hapsirën mbarëshqiptare të botës krijuese letraro-artistike. E ku ka më bukur të shkruash poezi për ''Nënën'', për

’’Dashurinë’’, për Vendlindjen’’ etj. Ja pra, këtu qëndron edhe fillimi i madhështisë letrare dhe mbështetja për gjithë krijuesit kudondodhur shqipfolës anembanë globit!

Durrës, 07. Maj 2014.

Reportazh

Malet e Skraparit, pëllumbat e paqes të luftës së Dytë Botërore

(Me rastin e 70-vjetorit të çlirimit të qytetit të Çorovodës e të gjithë Skraparit, 5 shtator 1942)

‘’Në Tomorr ku mblidhen retë, u mblodhën trimat me fletë.’’

’’ Ju kish rritur nëna
Për një botë të re,
Lule more trim
Që ratë për Atdhe’’

Me shoferin Azir Sulati atë mëngjes të datës 5 shtator 2012, u nisëm nga qyteti i Durrësit drejt Skraparit.Telefonatat nuk reshtnin atë ditë feste duke uruar për 70 vjetorin e çlirimit të Skraparit.Një re e bardhë atje mbi majën e malit Tomorr , bënte prezantimin e parë mysafirëve të ardhur nga e gjithë Shqipëria. Lamë pas qytetin e Beratit e makina me të cilën udhëtonim , edhe ajo ecte e gëzuar në atë rrugë plot kthesa që të çon në qytetin e Çorovodës, atje në Skrapar.

Veterani i LANÇ z.Qemal Mançe nis bisedën aty në makinë për vitet luftarake të luftës partizane. Kujton ato vite të vështira lufte ku gjithë populli shqiptar u ngrit në këmbë me armë në dorë kundër okupatorit nazifashist. Syt i lotojnë . Kujton shokët e shoqet e rënë në fushën e betejave për çlirimin e Atdheut. Njërën këmbë e ka të plagosur në këto beteja të stuhishme për çlirimin e Shqipërisë. Sot ai është krenar që po feston 70 vjetorin e çlirimit të Skraparit. Ai ka lindur në Vlush të Skraparit,por u rrit në luftën për çlirimin e Shqipërisë e rindërtimin e saj atje nëpër kantjere të ndërtimit. Xha Qemali mban mbi supe 88 vite jete. Vetë jeta e këtij njeriu është histori. Kur furia partizane trokiste në male e në çdo vatër të Skraparit,liria ishte pranë në gjithë Shqipërinë me kurorëzimin final të 29 Nëntorit të vitit 1944. Por nga malet e Skraparit të datës 5 shtator të vitit 1942-it, pëllumbat jepnin mesazhin e paqes në tërë shtetet e botës, se liria është pranë,lufta ogurzezë nazifashiste kundër popujve po merrte fund.Lajmin e parë e dha Radio Londra,pikërisht në këtë datë historike.

Në atë udhëtim drejt qytetit të Çorovodës me ne ishte edhe skraparasi ,Skënder Hito.

-Më s'fundi erdhëm,-u dëgjua zëri i shoferit tonë. Ishte ora nëntë e mëngjesit. Qyteti ishte zgjuar më herët atë ditë. Ngado flamujt e Kuq me shqiponjën në mes, valëviteshin krenarë drejt qiellit të kaltër në atë qytet mes malesh. Buzëqeshte qyteti! Por më shumë njerëzit e ardhur nga i gjithë Skrapari e Shqipëria. Kënga e vallja oshëtinte si lumi i Osumit e lartësohej si mali i Tomorrit. Ndoshta,liria e fituar mbi okupatorin jo vetëm në Shqipëri,por edhe në mbarë botën sikur ka marrë bekimin nga mali i shenjtë i Skraparit dhe i gjithë Shqipërisë me emrin e pagëzuar ''Baba Tomorr''.

Atje në lokalin veror ose siç i thonë vendasit ''Kaprolli'',pritjen e miqëve të ftuar posaçërisht për këtë ngjarje Jubilare festive të çlirimit të Skraparit,e bënin organizatorët Bashkia Çorovodë me drejtues z.Nesim Spahiu,Kryetari i Veteranëve të LANÇ z.Enver Naska . Në krahë të tyre ishin edhe pasardhësit të LANÇ, Asqeri Hasa,Sefedin Met'hoxha,Luman Lame,Vesel Pinderi etj.

Një pritje vllazërore për të ardhurit nga rrethet e qytetet e tjera të Shqipërisë,i bënin edhe z.Alban Dalipi, Resul Bregu,Kujtim Lame,… një qytet i gjitë në pritje të çlirimtarëve.

Qyteti ishte gjallëruar si dikur nga ishluftëtarët e lirisë, po kështu edhe nga pasardhësit të asaj epopeje të lavdishme,,të afërm të familjeve të dëshmorëve,të ftuarit nga rrethet,Berat,Tirana, Durrësi,Lushnja,Fieri,Përmeti,etj,

Takoheshin e përqafoheshin me mall e dhimbje,kujtonin shokët e shoqet e luftës që dhanë jetën për Atdheun. Por, edhe derdhnin lot gëzimi në këtë festë të 70-vjetorit të çlirimit të Skraparit.Më tutje,atje një foto mes shokësh,një dolli për ata që dredhën gjakun për lirnë e Atdheut.Një nënë e moshuar me emrin Kadrie Caka, përqafon me lot në sy ishbashkëluftëtarët të Heroit të Popullit,Estref Caka. Në këtë takim festiv që përkon edhe me 100 vjetorin e Shpalljes së Pavarsisë,merrnin pjesë edhe përfaqsues të politikës e të pushtetit z.Ilir Meta,deputeti i zonës z.Nasip Naço,Kryetari i Komitetit të Veteranëve të Shqipërisë z.Rustem Peçi . Dy datat historike; 28 Nëntorin 1912 e 29 Nëntori i 1944,lideri i kësaj force politike tha se do të mbeten si dy kokat e shqiponjës në flamur.Në orën 10 të paradites u bënë homazhe e vendosën kurora e buqeta me lule në varrezat e dëshmorëve.Po kështu,në Muzeun Historik u bënë vizita nga gjithë pjesëmarrësit,të cilët u njohën më

nga afër me traditat historike , kulturore e atdhetare të Skraparit.Fjalën përshëndetëse të hapjes së mitingut festiv me rastin e 70 vjetorit të çlirimit të Skraparit, e mbajti Kryetari Bashkisë së Qytetit Çorovodë z. Nesim Spahiu. Midis të tjerash ai tha se kjo ditë historike është e shenjtë jo vetëm për Skraparin por për gjithë Shqipërinë.Ndërsa kryetari i Komitetit të Veteranëve të Skraparit z.Enver Naska, foli për heroizmin e popullit të Skraparit , për djemtë e vajzat Skraparase e të gjithë Shqipërisë, që nuk kursyen as edhe jetët e tyre për çlirimin e Atdheut,për lirinë e përparimin shoqëror e demokratik. Nga Skrapari janë 404 dëshmorë të cilët i kujtojmë me respekt në këtë ditë Jubilare të çlirimit të 70 vjetorit e të 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarsisë.Heronjtë e dëshmorët kanë vetëm ditëlindje si:Riza Cerova, Zylyftar Veleshnja, Estref Caka,Ramiz Aranitasi etj. Komiteti i Veteranëve të rrethit Skrapar paraqiti në këtë Jubile të çlirimit edhe librin me portrete të dëshmorëve të rrethit.Ne mundëm të sjellim në këtë shkrim vetëm disa emra prej tyre, sepse ata e meritojnë të gjithë si: R. Cerova,E.Caka,L.Backa,A.Kuçi,A.Jaubelli,M.Sinani, S.Satka,N.Alimadhi,F.Musaj,J.Spahiu,Q.Dosti,A.Elezi,Xh.Ago,S.Myftari,N.Mançe,F.Sula,S. Shimi, M.Shatro, N.Bregu,K.Hoxha,J.Met'hoxha,I.Shameti,B.Aliaj,N.Gjoni,Sh.Zhuri,I.Alushani etj. Për heroizmin e çetës partizane të formuar në Kulmak të Skraparit më 14 Mars të vitit 1942,si çeta e parë në Qarkun e Beratit dhe në Shqipërinë e Jugut, solli episode heroizmi Ohran Frashëri, i cili ka qënë qysh në fillim në formimin e kësaj çete.Kujton komandantin legjendar Mestan Ujaniku,Komisarin Gjin Marku, partizanët,Hajdar Noka,Muharrem Trebla,Syrja Grëmshi,Refat Gjonbabasi,Hajri Shpatanji, Xhevo Osmani,Minella Bulka,Shaqir Kapinava,të cilët ishin të parët që formuan çetën Skraparit,e më von kjo çetë u rrit në numër me emra të tjerë nga krahinat e tjera të vendit. Në këtë 70 vjetor të çlirimit të Skraparit e të 100 vjetorit të Shplljes së Pavarsisë , u ngrit lartë si mali i Tomorrit figura e burrit të shquar të Skraparit e të gjithë Shqipërisë Xhelal Koprëncka, një nga firmëtarët e shpalljes së aktit të Pavarsisë në Vlorën heroike në vitin 1912. Në fund të takimit festiv të Jubilet të çlirimit,Komiteti i Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Skraparit,shpërndau edhe ''Mesazh mirënjohje në 70- vjetorin e çlirimit të rrethit''. Ky evendiment do të mbetet gjatë në memorjen e atyre që u nderuan në këtë vit Jubile të Shpalljes së Pavarsisë. Urimet buronin nga zemra: Gëzuar,gëzuar qofshin kudo shqiptarët që jetojnë e punojnë në Shqipëri e nëpër botë! Atje,mbi Tomorr retë e bardha japin mesazhe lirie e paqe jo vetëm për shqiptarët,por për gjithë njerëzimin!

''Ju kish rritur nëna

Për një botë të re,

Lule more trima

Që ratë për Atdhe''

Lavdi dëshmorëve të Atdheut!

Çorovodë, 9 shtator 2012

Kulturë

Guri e fjala përjetësisht në rrugën e historisë

(Në promovimin e librit më të fundit "Triumfi i Kombit" të autorit Skënder Sadri Kapiti)

Më datë 18 Maj 2013 në sallën kryesore të Pallatit të Kulturës ''Aleksandër Moisiu'' Durrës u promovua libri i autorit Skënder Kapitit. Pjesëmarria në këtë aktivitet ishte e madhe .Nga të pranishmit u ndoqën me inetres ligjiratat që u mbajtën nga foltorja e kësaj salle rreth vlerave historike e atdhetare që përcjell libri për te lexuesi. Organizimi këtij evenimenti kulturor e atdhetar , por edhe artistik ishte i organizuar nga Klubi i Shkrimtarëve e Artistëve të qytetit Durrës.

Pamje nga salla.

Shkrimtari nga Vushtrria – Kosovë, Bedri Tahiri.

Kryetari i klubit z. Nikolla Spathari, krahas fjalës përshëndetëse para qindra pjesëmarrësve bëri edhe një ekspoze të shkurtër rreth vlerave që përcjell libri i autorit Skënder Kapiti për kohën aktuale e të brezave që vijnë. Por një ligjërim më të detajuar e të gjithanshëm vlerësues të librit, para pjesëmarrësve foli z. Vladimir Muça, i cili është edhe nënkryetar i klubit. Në këtë eveniment kulturor e artistik të titulluar''Pranvera e poezisë Durrësake'', që tashmë është kthyerë në një traditë të përvitshme që organizon Klubi i Shkrimtarëve e Artistëve të Durrësit; merrnin pjesë jo vetëm nga Shqipëria por edhe nga Kosova. Nga qytet: Prishtinë, znj. Flora Brovina,Sabit Rrustemi- Gjilan, Bedri Tahiri – Vushtri,Bedri Neziri e Adem Zaplluzha të Klubit ''Kastrioti''. Kurse nga Shqipëria merrnin pjesë nga Saranda, Tirana, Elbasani. Në fjalën e tij shkrimtari Daut Hoxha u ndal për vlerat atdhetare e kombëtare që ka përcjellë në shekuj fisi i Kapitajve, dhe kontributin që kanë dhënë djemtë e Kapitajve siç është midis tyre edhe autori i

librit Skënder Kapiti në atributet liridashëse për lirinë e Kosovës në pranverën e vitit 1999. Ata u bënë ambasadorët e vërtetë në brigjet e Adriatikut në qytetin e Durrësit në pritjen e përgatitjen e qindrave djemëve Kosovarë e shqiptarë që më pas u rreshtuan në frontin e luftës në ushtrinë e UÇK-së. Në këtë tubim relaks promovimi folën edhe të ftuarit nga Kosava si: Flora Brovina, Bedri Tahiri, Bedri Neziri, Sabit Rrustemi, i klubit ''Flaka e Janarit''.Për të drejtat e shqiptarëve që autori e ngreh me forcë edhe në libër, pra jashtë Shqipërisë në trojet e veta si në Kosovë, Çamëri, Maqedoni, Mal të Zi, ku mohohej prona, gjuha, sombolet kombëtare, madje edhe e drejta për të jetuar, janë përdorur metoda e mjete nga më çnjerëzore e barbare që njeh historia.Me çlirimin e shpalljen e Pavarsisë së Kosovës më 17 Shkurt 2008, falë ndërhyrjes së NATO-s me në krye SHBA-në, që përbëjnë dy ngjarje me rëndësi kombëtare për kombin, foli shkrimtari Ilir Malindi.''Edhe libri që promovojmë sot, është një vlerë tjetër që autori Skënder Kapiti ngreh lartë vlerat historike e atdhetare të popullit tonë në shekuj, sepse e shkruara dëshmon të djeshmen, të tashmen e është udhërrëfyese për të nesrmen!''. Në këtë promovim të librit ''Triumfi i Kombit'' të autorit Skënder Sadri Kapiti, për vlerat kombëtare e atdhetare që mbart libri foli edhe ish Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Bamir Topi. Poeti Agim Bajrami recitoi para pjesëmarrësve një poezi të autorit Nikolla Spathari. Në fund të takimit pjesëmarrsit i përshëndeti me fjalë zemre edhe autori i librit z. Skënder Kapiti. Pas kësaj të gjithë të pranishmit bënë vizita në galerinë e arteve e në vendet arkeologjike e historike të qytetit bregdetar të Durrësit.Në galerinë e arteve të qytetit, të pranishmit i përshëndeti z. Edmond Agolli.

Në qendër Edmond Agolli duke i falnderuar pjesëmarrësit

Aktivitetet u ndoq me interes edhe nga gazetarët e mediave të shkruar e televizive që operojnë në këtë qytet. Pranvera e lirisë së Kosovës dhe titulli i librit ''Triumfi i Kombit'' tregon se shqiptarët janë të fortë si gur stralli e me fjalën e tyre që nxjerr flakë lirie nuk e kanë mposhtur kurrë keqadashësit të të gjitha qarqet shoviniste nëpër shekuj. Qëndresa e shqiptarit si gur i pathyeshëm me fjalën e dashurisë për atdheun kanë sakrifikuar edhe me jetën e vetë duke derdhur gjak nëpër rrugën e historisë për liri e pavarësi.Fjala e liria e shqiptarit janë të shtrenjta.

Autori Skënder Kapiti ka një filozofi disi ndryshe nga të tjerët autorë, sepse kur ai merr penën e shkruan ndëthur faktet historike e atdhetare me një rrëfenjë interpretim bindse me bazë shtratin e fakteve, që për gjatë rrugëtimit historik e kulturor nëpër shekuj zbërthen filozofikisht e psikologjikisht ngjarjet jetësore. Prandaj themi që libri ka vlera intelektuale dhe edukuese për gjithë sferën shoqërore e politike.

Durrës, Maj ,2013

Jehona e këngës Skraparase vallëzon me kaltërsinë e valëve adriatikase në qytetin e Durrësit

...Baba Tomorri,-puthë kupën qiellore e takon zotin!

Ngjitemi në të përpjetën e kodrës së Vilës ,atje ku nga ajo kodër me ullinjë shekullorë nga lartësia e sajë shikohet si në pëllëmbë të dorës me sy të lirë qyteti bregdetar i Durrësit. Vështron detin që dallgëzon lehëtas me valët e bardha që puthin tokën e kthehen andej nga kanë ardhur. Eshtë Prill, e rrezet e diellit sapo janë ulur këmbëkryq bregut të detit me ngrohtësin e tyre. Edhe dallëndyshet kanë ardhur më herët e kanë ngrutur foletë e reja strehëve të shtëpive apo të ballkoneve të pallatave. Pulbardhat gugisin me zërin e tyre gëzueshëm nëpër kaltërisnë e detit. Gjelbërimi i pemëve e lulet buzëqeshin në këtë prill me diell pranveror. Ky peizazh pranveror ka lajmëruar para kohe mirëseardhjen për pushuesit e shumtë që frekuentojnë këtë qytetet me plazhin e bukur që ka.. Në qytetin bregdetar ka jetë e gjallëri për gjithë stinët e vitit. A nuk janë si zogjtë shtegtarë emigrantë shqiptarë të të gjithave trojeve tona që hyjnë e dalin në nyjen e portit më të madh të Shqipërisë e të ballkanit që vinë e shkojnë me tragete aty?! Por edhe vizitorët e shumtë i pret e i përcjell ky qytet sa i lashtë e i ri të ditëve tona. E veçanta e qytetit shekullor të Durrësit qëndron në faktin se edhe në ditët e sotme ai ka ditur t'u thotë ''mirëseardhjen '' edhe migrantëve të ardhur nga e gjithë shqipëria: nga Veriu e Jugu ,por edhe nga shqipëria e mesame në këto vite tranzicionit. Të ardhurit në këtë qytet mikëpritës janë integruar me punën , arsimin e kulturën që mbart e përcjell jeta shoqërore qytetare në edukimin shoqëror e atdhetar. Janë të shumtë skraparas që u zhvendosën nga vendlindja e tyre në këto vite të fundit , sot banojnë e punojnë në lagjet e këtij qyteti bregdetar. Sipas statistikave zyrtare numri i Skraparasave që jetojnë punojnë në Durrës kapin shifrën rreth 13 mijë banorë. Ata janë shtrirë pothuajse në çdo lagje të qytetit,por në kodrat mbi Spitalin Rajonal të Durrësit , gjendet komuniteti më i madh me Skraparas; sa vendasit e kanë emëruar " Lagja e Skraparasave''. Shtëpitë i kanë ndërtuar me komoditetin e kohës që të rrëmbejnë për nga arkitetura karakteristike ndërtimore. Një komonutet i gjerë ndodhet edhe në komunën e Rrashbullit, kryesishtë të ardhur aty nga fshatrat e zonës Tomorricë, saqë emërtimin ia kanë thirrur ''Tomorroca e vogël''.

–Ky emërtim i shkon kësaj lagjjeje, sepse kështu e kishte emrin edhe makina shirëse e grurit që u prodhua në UMB-në, Durrës rreth viteve 80 –të, - na thotë një banor i këtij fshati i cili kishte qënë agranom në vitet e komunizmit në zonën e Tomorricës.

–Kur na merr malli për vendlindjen tonë, na thonë Skraparasit, ngjitemi aty në Kodër Vilë e sytë i hedhim andej nga lind dielli, pra në malin e perëndive te baba Tomorri! Dhe kjo është më se e vërtetë, sepse gjithë shqiptarët kudo nëpër botë marrin bekimin tek ky mali i shenjtë, mal i magjishëm me mistere që shkenca po punon për të zbuluar të vërtetat e fshahta që ka mali i Tomorrit në mirësinë e njerëzimit. Aty janë thurur shumë legjenda, pra që nga lashtësia e deri sot. Ishte rruga e gjatë historike e atdhetarëve shqiptarë që nën një emër simbolik me emrin Tomorr organizuan në Bukuresht duke shkrirë tre shoqata ''Dituria'', ''Drita'', e ''Shpresa'' me

emrin simbol ‘’Shoqata Tomorri’’ e cila mori udhën e saj të jetës më 2 Nëtor të vitit 1906 në shtëpinë e Kristo Meksit me 92 firmëtarë. Mali i Tomorrit është simboli i bashkimit dhe i qëndersës në shekuj të shqiptarëve për liri e barazi shoqërore. Jo më kot Naimi i këndoi dhe iu drejtua këtij mali si asnjë tjetër. Por, edhe Kristoforidhi, Çajupi, Azdreni, De Rada. Udha e shoqatës ‘’Tomorri’’ shtriu veprimtarinë e vet edhe në Egjipt,Turqi,ShBA. Ajo mori përmasa ndërkombëtare.Shoqata Tomorri e Bukureshtit në formë klubesh shtrin degët e sajë nëpër Shqipëri si: ‘’Pellazgu’’ në Skrapar me drejtues Abdulla Koprëncka, klubi ‘’Bashkimi’’ në Vërzhezhë e drejtuar nge dervish Iljaz Qafoku, por të tilla klube bashkimi u krijuan edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë.

...Në udhëtimin 10 vjeçar të shoqatës ‘’Tomorri’’(dega Durrës)

Tashmë shoqata ‘’Tomorri’’ shtrihet pothuajse në të gjitha qytetet apo krahinat e Shqipërisë. Madje ato janë krijuar edhe në Kosovë, Maqedoni e gjetkë që zhvillojnë aktivitetin e tyre atdhetar e shoqëror në edukimin e brezave me traditat tona më të mira. Edhe në qytetin e Durrësit kjo shoqatë festoi më 20 Prill 2013, dhjetë vjetorin e krijimit të saj. Në këtë shoqatë marrin pjesë nga gjithë komunitetet e Shqipërisë të cilët jetojnë në qytetin e Durrësit. Larmija e aktiviteteve është e dukshme nga kjo shoqatë aktive në festimet e ndryshme të ngjarjeve historike e kulturore. Kështu, në nëntor 2012 u përkujtua me anën e një dokumentari jeta e veprimtaria atdhetare për Zylyftar Veleshnjen. Me interes në këto aktivitete është ndjekur edhe dokumentari ‘’Tomorri në Kosovë’’, por edhe njohja me ‘’Këngët e Tomorrit’’. Drejtuesi i shoqatës ‘’Tomorri’’ (Dega Durrës)z. Hajri Nuhu ,na thotë me krenari se kjo shoqatë është rritur në shifrat numerike me një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse nga të gjitha krahinat e Shqipërisë.

Ata janë jo vetëm nga Skrapari, por edhe nga Berati,Korça, Gramshi, Përmeti, Durrësi, Tirana, Elbasani, Lushnja, Shkodra, Kukësi,Dibra, Tepelena, etj. Interesante e kësaj shoqate janë edhe aktivitete që zhvillon në njohjen e prapagandimin e librave si thesare të diturisë, kulturës e të historisë. Janë organizuar promovimesh libra si: ''Sfidat e poetit'' të autorit Nuri Dragoi për poetin Xhevahir Spahiu,'' Orakuj të harruar'', Zylyftar Hoxha, '' Edhe kështu mirë'' të Abdulla Bregut, ''Shëndetësia në Skrapar'' të autorit Novruz Gërxhani, ''Pleqtë e lagjes sime'' me autor Gëzim Aliaj etj. Ajo që të bën përshtypje e që të afron me vendlindjen janë edhe pikturat universale të piktorit skraparas Nuri Jaupi. Nga ky piktor janë hapur disa ekspozita me pikturat që flasin me ngjyrat e ndezura plot kolor nga gjithë trevat e shqipërisë, Kosovës, etj. Herë pas here janë organizuar edhe koncerte me këngë e valle të grupit ''Riza Cerova'' e ''Demir Zyko''.Koncerte me Dule Malindin,Irini Qiriako, Nertla Vreto etj.

Kush janë sfidat e shoqatës "Tomorri" për të ardhmen e afrtë?

Sipas organizimi të ri që po bën kjo shoqatë, ka nisur regjistrimi dhe aderimi i antarëve pjesëmarrës. Çdo anëtar do të ketë kartën diçitale. Nga kjo kartë regjistruese indetifikuese çdo anëtar i saj do të përfitojë bonos falas pranë spitalit IKEDA në Durrës. Po kështu ka nisur abonimi për gazetën ''Dielli i Tomorrit'' që është organ i shoqatës ''Tomorri''. Një lajm i mirëpritur nga pjesëmarrësit në festimin e 10 vjetorit të degës Durrës, ishte ajo e nisjes së shpejti nga puna transmetimi i emisioneve ''Radio Tomorri''. Aktiviteti i organizuar nga shoqata pati një pjesëmarrje të gjerë rreth 350-400 pjesëmarrës . Një pjesëmarrje më të dukshme në këtë aktivitet mbreslënës ishin nga zonat Vëndreshë, Tomorricë e Qëndër. I ftuar në këtë eveniment atdhetar e kulturor ishte edhe këngëtari Dule Malindi.Kënga e vallja Skraparase u bashkua me valet e detit adriatikase në qytetin e Durrësit. Të gjithë këndonin e vallëzonin me bekomin e Baba Tomorrit , sepse e sotmja dhe e nesërmja kanë e do kenë kaltërsinë tomorriane e atë adriatikase të bashkuar për një jetë sa më dinjitoze.

Një dolli sipas zakonit, Gëzuar!

TOMORRIT
NISMA
TOMORRIT
NISMA

Fotot nga Xhevahir Cirongu : Pamje nga 10 vjetori i shoqatës ‘’Tomarri’’Prill 2013,Durrës.

DETROIT
INDUSTRY
SPOT

…Në Tomorr ku mblidhen retë, të bashkuar motë e jetë!

Durrës, Prill 2013

Burrat e kombit flakërojnë nëpër histori

Nga e majta në të djathtë: Skënder Kapiti, Bedri Tahiri e Xhevahir Cirongu, Durrës prill 2014.

Ishte data 9 prill 2014 kur unë takoj shkrimtarin kosovar Bedri Tahiri. Ai shoqërohej nga Skënder Kapiti, një burrë fisnik,atdhetar e shkrimtar. Me origjinë Skënderi është nga kosova. Nga Vushtrrria për në Durrës, shkrimtari Bedri Tahiri vjen shpesh për vizitë. Piktakimin e parë,sapo shkel në qytetin bregdetar,shkon te ''Drenica e durrësit'', te kjo vatër atdhetarie e kombit tonë. Çdo vizitor i huaj apovendas, do përulet në shenjë respekti para ''Drenicës'', sepse aty u projektua liria dhe pavarësia e Kosovës.
Këtë vit Kosova feston 15 vjetorin e çlirimit nga okupatori serb. Ndonse është muaji prill, me sa duket, edhe dielli ngroh e buzëqesh më shumë. Po afron qërshori i 2014! Sa bukur kanë çlur lulet e prillit! Ato vrapojnë për te dita e Lirisë së Kosovës! Edhe ''Drenica'' në Durrës këto ditë prilli, pret e përcjell me dhjetra e qindra vizitorë të grupmoshave të ndryshme. Kosova jonë është një zambak i bardhë që çel e rritet mbi shkëmb! Bijët e saj flakërojnë nëpër udhët e historisë. Atë mbrëmje të datës 9 prill,Klubi i Shkrimtarëve e Artistëve të qytetit durrës, kishte

ditën letrare të poezisë. Aty, në atë mbrëmje letrare, morën pjesë edhe kolegët nga kosova. Diskutimet letrare rreth poezive të reja të Nikolla Spatharit, iu shtuan edhe mendimet e miqëve të ardhur enkas në këtë eviniment letrar të klubit. Mendimet dhe vlerësimet, deri te kritikat gjallëruan orën letrare të asaj mbrëmje prilli.Ky takim i befasoi miqtë nga kosova. Të nesërmen, shkrimtari Bedri Tahiri anëtarësohet në Klubin e Shkrimtarëve e Artistëve të Durrësit. Por edhe Skënder Kapiti e…

Atje, në një kafene te rruga ''Egnatja'' së bashku me mua, Skënder Kapitin e mikun nga Vushtrria e Kosovës, pimë një kafe miqësore. Dhurata më e bukur për mua ishte dhurimi i një libri, që Bedriu ia kushtonte përfaqësuesit të Drenicës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Ramadan Zymer Bajraktari. Ashtu, shpejt e shpejt i hodha një sy duke lexuar librin. Shfletova një e nga një fletët e tij, e vetja m'u dukë sikur shfletoja vitet e dekadave të historisë sonë. Ndjeva emocione, sepse shkrimtari i palodhur ish ushtar i UÇK-së,(sot mban statusin e veteranit të UÇK-së), lartëson figurat e atdhetare burra apo gra qofshin ata duke shkruar libra, me qëllim që historia e popullit tonë të ngelet e shkruar që t'ju tregojmë brezave nesër, se liria e pavarsia i ka rrënjët te sakrifica e gjaku i derdhur nëpër shekuj. Në faqen 13, autori shkruan: ''…Sidoqoftë, Drenica në historinë tonë kombëtare,mbetet territor i qëndresës shqiptare,që secilit pushtues i rezistoi me armë në dorë.Që nga beteja e Kosovës(1389) e deri më sot, nga kjo trevë dolën njerëz që me pushkë e me penë luftuan për çlirim, pavarësi e bashkim kombëtar…… Millosh Nikollë Kopiliqi(nga Kopiliqi i Skënderajt) do të plagosë për vdekje sulltan Muratin e I.'' Bedriu është një njeri që heshtë kur takohesh me atë, qoftë edhe kur pi një kafe. Por, ai të ''flet'' me penën që shkruan historinë e burrave e grave shqiptare në gjithë hapsirën shqipfolëse, dhe u ngre përmendoren e pavdeksisë në librat e shkruar prej tij.

Nga çanta nxjerr librin e shkruar prej tij e ma dhuron me dedikim mua! Por, edhe unë e ''kap'' në befasi duke i dhuruar librin me titull ''Mançllarët''. E merr librin në dorë, dhe në shenjë respekti e mirënjohje, por e me dhimbje, ledhaton foton e atdhetarit e ish veteranin e LANÇ Qemal Mançe. Heshtim që të tre:Skënderi,Bedriu e unë! …Në ato dy libra ishin shkruar copëza historie të popullit tonë. Dhe sërisht rilexoj fletët e librit. Kryebiseda jonë u përqëndrua te Ushtria Çlirimtare e Kosovës me në krye Komandantin legjendar, ADEM JASHARI,te dita e bardhë e Lirisë dhe Pavarësisë së Kosovës.

Atje, te ai lokal në rrugën ''Egnantja'' të qytetit bregdetar të Durrësit bëmë edhe një fotokujtim për të fiksuar kohën tonë.Por,këtë radhë një foto me aromë Lirie! 12 qërshori i 2014 po afron. Kosova, 15 vjet në Liri! Kështu do të jesh mot e jetë e lirë, Kosova ime!

Burrat e kombit flakërojnë nëpër padeksinë e historisë!

Durrës.10 Prill 2014

Udhëtim nëpër vargun gryeneç të poetit Adem Zaplluzha

Magjia e të shkruari është pakëz si e çuditshme. Ajo nuk është një rastësi, por dhuratë nga vetë Zoti, e dërguar për te njerëzit e veçantë në shoqërinë njerëzore. Të tillë njerëz, ushtrojnë gjithë qënien e tyre shpirtërore,frymore, mendore dhe fizike duke shkruar mbi fletët e bardha të bllokut të shënimeve. Misioni i tyre, pra i të gjithëve krijuesve të të gjithave fushave të shkencës, është shprehja e mendimit duke e hedhur atë nëpër mjetë fjalës së shkruarë. Jo vetëm kaq, por fjalën krijuesit e gëdhendin bukur dhe japin frymarrje e ngrohtësi për te lexuesi që e transmentojnë te të gjithë kategoritë e tjera të shtresave shoqërore njerëzore. Kjo krijesë e çuditshme me petale e polen lule, gjendet edhe te poetët. Vargjet e shkruara prej tyre në poezi, ngjajnë si gjethet e vjeshtës me kolorin shumëngjyrëshe, dhe brenda tyre thithin polenin e që mbushim liqenin shpirtëror të lexuesit tonë.

Ne takuam personalisht poetin A. Zaplluzha në qytetin e Prishtinës. Ky pot, tashmë është bërë i njohur jo vetëm në Kosovë, por në gjithë trevat shqiptare dhe më gjerë. Poeti Zaplluzha, ka një prodhimtari të bollshme e cilësore në këtë fillimshekulli të ri. E gjithë lënda shkrimore krjuese në botimet e tija, ka rrëfenja të çuditshme përgjat vargut që përcjell për te lexuesi ynë. Ne intervistuam për këtë qëllim edhe poetin A. Zaplluzha.

-Cili është qyteti juaj i lindjes?

-Kam lindur në qytetin e Prizrenit më 01.02.1943. Aty kam kaluar një pjesë të mirë të jetës sime. Historia e lashtë e këtij qyteti ka ndikuar edhe në formimin tim me ndjenjën e patriotizmit e të atdhedashurisë.

- Çfarë kujtimesh ruan nga qyteti i Prizrenit?

-E, si të them! Ato janë të shumta, saqë kanë zënë rrënjë thellë në memorien time. Edhe sot në këtë mosh të thyerë, kujtimet nga qyteti im i lindjes shpalosen të gjalla para meje. Ato më shfaqen si një ekran televiziv ngado që shkoj e hedh hapin tim. Shkurt, më rinojnë!

- A mund të na thoni më konkretisht?!

-E pse jo! Vendin e parë e zënë lojrat që bënim me bashkëmoshatarët nëpër rrugicat e qytetit, si dhe kur ngjiteshim në bedenat e kalasë. Te gurët e kalasë, sa herë që prekja me duar ata, më shpalosësh historia e popullit tonë që ka luftuar në shekuj për lirinë e mbrojtjen e vatrave tona stërgjyshore nga pushtuesit. Atdheu ynë, Shqipëria është pëllëmbë e histori.

- Me sa dimë juve edhe jeni arsimuar. Ku e keni kryerë arsimin?

- Në kushtet e një terrori psikologjik që përdorte sllavi, munda të mbaroj filloren e më pas gjimnazin në Prizren. Më von me këmbënguljen time, mbarove edhe Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Kjo ishte edhe ëndrra ime e fëmijërisë: që unë të arsimohesha e të bëhesha dikushi në jetë.

- A e keni ushtruar profesionin e mësuesit?

- Këtu më zure ngusht, sepse pak e kam ushtruar profesionin e zemrës time. Kushtet e rrethanat e kohës nuk ta lejonin këtë mundësi. Në fillim kam punuar mësues në fshatrat Sdudençan të Therandës. Më pas në Hoça të qytetit afër Prizrenit.

- …Po më pas ku u punësuat?!

- Ashtu siç u thashë edhe më lartë, largohem nga arsimi dhe punësohem si përkthyes në Korporatën Energjitike të Kosovës.

- z. Adem, Ju jeni tashmë një poet i njohur në fushën e letrave shqipe, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Rumani etj. Kur e keni filluar rrugën tuaj letrare për herë të parë?

- Unë jam frymëzuar nga shumë poetë, por më shumë nga poeti ynë kombëtar Naim Frashëri. Poezinë e parë e kam shkruar në moshën e fëmijërisë. Rrugëtimin letrar e nisa me vjershën për fëmijë e cila u botua në revistën ‘’Pionieri’’në vitin 1957.

-Ç’lidhje ke patur me grupin letrar që mban emërtimin’’Lulëkuqet e Kosovës’’ ?

- Kjo do mbete një ditë simboli për mua deri në vdekje. Dita më krenare, sepse bashkë me shokët e punës atje në Korporatën Energjitke, themeluam grupin letrar. Aty u botua edhe përmbledhjea ‘’Ngjyra e Kohës’’ ku u përfshinë poezi të ndryshme, por edhe të mijat. Kam botuar edhe në gazeta e revista letrare në Prishtinë, Shkup dhe Zagreb.

- Më thatë që keni punuar si përkthyes. Po nga veprat tuaja që janë të shumta me poezi, a janë përkthyer në gjuhë të tjera?

- Po, janë përkthyer në gjuhën Rumune nga i mirënjohuri Baki Ymeri. Eshtë përkthyer libri me

titull ‘’Pema e bekuar’’ në vitin 2010 dhe u mirëprit nga lexuesi Rumun. Gjithashtu, po këtë vit në Boras të Suedisë në antologjnë ‘’Jehona e shekujve’’ të autorit Sokol Demaku janë përfshirë edhe disa poezi të mijat.

- Po prezantime të tjera a keni?

- Kam, por nuk dua të vetëlavdërohem.

- A mund të na thoni disa prej tyre!?

- Meqënse po më ngacmon kaq shumë me këto pyetje, po u them shkurtimisht: Jam prezantuar në leksikonin e shkrimtarëve shqiptarë 1501-1990, nga Hasan Hasani, si dhe për fëmijë 1872-1995 nga Odhise K. Grillo. Po kështu në librin me portrete shkrimtarësh nga Demir Behluli në Prishtinë, 2002.

- Ju jeni një poet cilësor dhe sasior. A mund të na thoni sa vëllime keni botuar deri tani që po u bëjmë këtë intervistë?

- Ato janë shumë e shkojnë deri në 96 vëllime të botuara me poezi e skica letrare. Kam në proces punimi për botim edhe katër vëllime me poezi.

- Kush ju financon për botimet letrare?

-Një pjesë të konsidorueshme kam financuar vetë nga kursimet e mija. Kurse tjetrën nga donator e indivitë të ndryshëm që e duan artin dhe letërsinë. Dua të falnderoj me këtë rastë të gjithë ata që më kanë ndihmuar për botimin e librave të mija. Ja, këto katër vëllimet e reja më ka sponsorizuar z. Xhevdet Krasniqi që punon avokat në qytetin e Prishtinës. Por edhe Departamentin për Kulturë, Rini dhe Sport i Komunës së Prishtinës. Por nuk mund të lë pa përmendur edhe ‘’Market plus’’ dhe drejtorin Tefik Haxhiu, si dashamirës e mik i librit, që më ka mundësuar botimin e mjaft librave me poezi.
…Dhe ne lexuam titujt e librave që ka finacuar z. Xhevdet Krasniqi, ky njeri human e dashamir i letërsisë shqipe. Vëllimet: ‘’Mëkati i hijes’’,’’Rinjohja’’, ‘’Një zog prej uji’’, ‘’Diku në fund të një fillimi’’.

- Përveç faqeve letrare ku ju botoni nëpër gazeta e revista, u kemi lexuar edhe në portalet elektronike. Si e ndjeni veten aty kur ju botoni krijimet tuaja?

-Të them të vërtetën, më japin jetë e frymëzim për të shkruar edhe më shumë. Teknologjia e sotme maderne na ka bërë edhe më të njohur në rrethet letrare nëpër botë. Komentet janë të shumta nga kolegët, si shkrimtarë e poetë nga gjithë kontinentet. Interneti na ka afruar dhe miqësuar me njëri- tjetrin si mjet komunikimi dhe shkëmbim vlerash midis njerëzve, e sidomos mes krijuesëve të vjetër apo të rinj qofshin ata të të gjithave fushave të shkencës. Ne si poet e ndjejmë më shumë, pasi jemi qënia më e ndjeshme e shoqërisë!

- Në cilat portuale elektronike botoni krijimet tuaja?

-Kudo! Nuk kam dallim mes tyre. Në ‘’Zemra shqiptare’’, Fjalalirë’’, ‘’Kosovarmedia’’, ‘’Gazeta kritika’’, ‘’Dituria.se’’ etj. Zëri i shqiptarëve boton çdo ditë nga një poezi. Kjo më lumturon si krijues.

- Përveç se poet, ju jeni edhe një prind shëmbëllor. Kur je njohur për herë të parë me bashkëshorten, edhe kjo mësuese, Sulltanën?

-Ju më kërkuat intervistë për poezinë!? Por, ju gazetarët, të gjurmoni drei në skutat e fsheta edhe në intimitet,deri në marrdhëniet familjare. Nuk po zgjatem: Shkurt jam njohur në vitin 1968 në Prizren, në 500 vjetorin e lindjes të heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti. Sulltana ka punuar 46 vite në arsim. Eshtë vajzë Pejane dhe ka punuar në Krushë të Madhe e në Hoq, në shkollën ‘’Asim Vokshi’’ mbi 30 vite. Sot që të dy burrë e grua jemi pensionista.

- Nga martesa sa fëmijë keni?

-Jemi të lumtur unë si baba, por edhe Sulltana si nënë që lindëm, rritëm dhe edukuam dy fëmijë, pra dy djem. Të dy djemtë janë të arsimuar dhe me profesion. Djali i madh e ka emrin Armand,dhe ka një fëmijë me emrin Ardias. Jetojn në Londër.
Ndërsa djali i dytë, e quajnë Arbri dhe bashkëshorten Sofije. Edhe këta kanë fëmijë: Gentin e Ada, vajza. Jetojnë e punojnë në Otavë të Kanadasë. Aty djali është menaxher kryesor për emigracionin.

- Z. Adem! Qysh në fillim të kësaj interviste, u shprehët se frymëzimet e para për të shkruar ka ndikuar historia e qyteti të lindjes Prizreni. Dua të di unë e lexuesi, se ku janë rrënjët e vargut të poezive tuaja, pra tharmi e tingulli lajmotiv që përcjell poezia jote!?

-Si të them! E gjithë lënda shkrimore krujuese e imja, jo për mburrje, ka si rrënjë e taban dheun e tokës sonë, Shqipëri. Oksigjeni i vargut është historia e popullit tonë, kurse rrënja e shkronjave thithë gjakun e dëshmorëve që përcjell heroizmin dhe sakrificën e popullit tonë në shekuj për te brezat e sotëm e të nesërm. Frymëzuesja e krijimeve të mija me frymë patriotike, qysh në fëmijëri, ka qënë dhe mbetet dallëndyshja Shtëpia e Rilindjes sonë Kombëtare që ndodhet në qëndër të qytetit tim të lindjes. Aty kam marrë vesën e kristaltë të vargut tim poetik.

- Edhe një pyetje tjetër, e të fundit për këtë intervistë: A keni marrë vlersime letrare për gjithë këtë oaz botimesh që keni botuar, sepse nuk është e lehtë të krijosh e të botosh afro 100 vëllime! Pra, juve keni më shumë botime se sa moshë jete!? Ç’mund të na thuash për këtë?

-Oh, këtu më zure prapë ngusht! Të thash që në fillim që s’dua të vetmburrem. Le ta thonë të tjerët si të mirën ashtu edhe të keqen. Jam i hapur për të gjithë. Meqënse ma kërkon një gjë të tillë po ua them juve. Me rastin e 70 vjetorit të lindjes më bëri një ftesë televizori i Prizrenit. Aty dhash një intervistë. Kjo është e para inervistë që kam pranuar para medies televizive. Kurse

vlerisme të tjera kam marrë nga klube të ndryshme letrare si: Mirënjohje me rastin e 100 vjetorit të Pavarsisë, nga revista ''Albanezi-Shqipëri''- Bukuresht. Vlerësime letrare të cilat janë disa në numër, nga Klubi i Shkrimtarëve ''Fahri Fazliu'' të Kastriotit- Kosovë. Çmimi i Karrjerës, nga Klubi i Shkrimtarëve e Artistëve Durrës, e të tjera.

Poeti Adem zaplluzha na fletë edhe për shokët krijues si: Rexhep Kllokogi, që është edhe antar nderi i klubit të Kastrotit. Por nuk lë pa përmendur dhe Fetali Berisha, mësuesin e matematkës që jep mësim te shkolla ''Pandeli Sotiri''. Ismail Simnica, si dhe kryetarin e Klubit të Shkrimtarëve ''Fahri Fazliu'' të Kastriotit, Bedri Neziri. Vetë Ademi është edhe nënkryetar i Klubit të Shkrimtarëve në Kastriot, por edhe Anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Në qëndër të Prishtinës bëmë edhe nga një foto me poetin e përmasave kombëtare të letrave shqipe z. A Zaplluzha. Një vajzë me emrin Velmine Q. Krasniqi, që u njohëm rastësisht e që vazhdonte arsimin e lartë, na bëri shkrepjet e blicit me aparatin fotografik te shtatorja Zahir Pajaziti (Hero i Popullit). Poezia e poetit të Zaplluzhës ka vlagun e tokës shqiptare. Të falnderoj për kohën që ia kushtuat kësaj intervise. Ju uroj shëndet e suksese në krijimtarinë tuaj, që edhe në të ardhmen të na sillni vepra të tjera cilësore letrare.

Intervistoi: Xhevahir Cirongu,Prishtinë 06 dhjetor 2013.

Me poetin Adem Zaplluzha,Prishtinë 05 dhjetor 2013

Histori -Përkujtimore

Njeriu legjend: Mestan Ujaniku ndriçon nëpër histori…..

(Përkujtimore me rastin e 67 vjetorit të ndarjes nga jeta në mënyrë misterioze në burgun komunist, korrik 1948)

Për njeriun legjend, për atë burrë me kockë të fortë si bardhësia e malit Tomorr, është shkruar e do të shkruhet edhe në të ardhmen. Jeta e këti njeriu, atdhetar e patriot, ka në vetvete të shkruar me fije ari nga lindja deri në vdekjen misterioze historinë e jetës së tij, duke ia falur atdheut e lirisë për t'i qëndruar kurorë si lule mali tomorri Shqipërisë për të cilën edhe luftoi.
Jeta dhe veprimtaria e këtij patrioti e luftëtari guximtar, figurë legjendare e Tomorricës e të gjithë Skraparit, me veprimtarinë shumëplanshe që ka zhvilluar për çlirimin e atdheut dhe veprimtaria e shkurtër pas çlirimit, ai plotësoi personalitetin e tij me kontribute e vlera kombëtare në dobi të kombit tonë.

Mestan Ujaniku ka lindur më 7 janar 1902 në fshatin Ujanik , dhe largohet nga jeta në mënyrë misterioze më 11 korrik të vitit 1948, në moshën 46 vjeçar në burgun e Tiranës.
Aktiviteti luftarak është mjaft i gjerë sipas etapave e rrjedhave historike në gjysmën e parë të shekullit të XX- të.
Më 14 mars të vitit 1942 në Kulmak të fshatit Ujanik, rrëzë malit Tomorr, u krijua Çeta Plakë e Skraparit, një nga formacionet e para partizane jo vetëm në Skrapar, por në gjithë Shqipërinë, e dyta pas asaj të Pezës. Kjo shënoj ngjarjen më të rëndësishme të LANÇ. Komandant i çetës u zgjodh Mestan Ujaniku me komisar Gjin Marku, një djalë trim e i zgjuar nga Mirdita.
Shoqata Atdhetare e Kulturore Tomorri (dega Durrës) më 31 mars 2015 organizoi një aktivitet përkujtimor në nderim të kësaj figure me rëndësi e si udhëheqës i Luftës Nacionalçlirimtare. Odaoni i sallës ''N. Xhoja'' të Pallatit Kulturës '' A. Moisiu'', ishte mbushur plotë me njerëz të grupmoshave të ndryshme jo vetëm nga Skrapari, por edhe nga rrethet e ndryshme të Shqipërisë. Pjesëmarrësit e këtij takimi i përshëndeti kryetari i Shoqatës z. Hajri Nuhu. Me këtë rast u përurua libri me titull ''Mestan Ujaniku, legjenda e maleve të Skraparit ''Monografi'' të autorit Dule Kalemi. Nga aktori Ilir Porodani u recituan poezi, të cilat ishin krijuar nga autorë të ndryshëm për Komandant Mestan Ujaniku Meqënse, Mestan Ujaniku nuk ka një varr për t'i çuar një tufë lule, ai u ''ringjall'' pikërisht më 31 mars 2015 , me bustin që u zbulua në sallë para qindra pjesmarrsëve të aktivitetit duke duartrokitur edhe në shenjë respekti u çuan në këmbë për t'i thënë ''mirseardhjen'' yllit të pashuar që ndriçon nëpër historinë e popullit shqiptar.. Në atmosferën e këtij entuziazmi e mori fjalën edhe skluptori Elbasanas z. Vladimir Caridha. Midis të tjerave ai tha se '' sot kapedanin e maleve të skraparit dhe i gjithë Shqipërisë, Mestan Ujaniku pas 67 vitesh të lënë në harresë nga regjimi komunist, e kemi këtu para syve tanë në këtë sallë e bashkëbisedojmë ne me atë, dhe ai me ne!''. Me këtë rast përkujtimore u shfaq edhe filmi dokumentar kushtuar figurës dhe veprimtarisë jetësore atdhetare Mestan Musabelli (Ujaniku) me regjizor Zylyftar Hoxha e operator Agim Blloshmi.
Nga foltorja e aktiviteti përkujtimor, e mori fjalën edhe Nuri Musabelli, djali i Mestanit, i cili falnderioj Shoqatën Tomorri në Durrës dhe gjithë ata pjesëmarrës që sollën kujimet e tyre si në libër, por edhe në përgatitjen e filmit dokumentar, të cilët ngrjnë lart emrin dhe veprën e Mestan Ujaniku.
Kur e pyetëm për emrin Kujtim Musabelli, i biri I Xhemalit dhe nip i Mestanit, ai na u përgjegj duke na thënë se emrin unë e trashëgoj nga Mestani. Dhe vazhdon të na tregojë:'' Ishte viti 1947 kur atëherë linda unë. Mestani qe arrestuar dhe ishte në burgun e Tiranës. Kur shkuan për ta parë në burg Mestanin , i thanë se na lindi djalë dhe emrin ja thirrëm Kudret. Mestani u mendua pak, uroj me jetë të gjatë për djalin e lindur dhe u tha: '' Meqënse jam në burg, e jeta ime nuk dihet, dua që djalit të sapolindur t'ja vini emrin Kujtim!''. Ashtu u bë, - emri im ngeli Kujtim, na thotë Kujtim Musabelli, i biri i Xhemalit.
Me të vërtet pas 67 vitesh Kujtimi investon për të përkujtuar legjendarin e maleve të Skraparit, njeriun që ndriçon si yll i mëngjesit me veprën e tj nëpër dallgët e historisë sonë. Pikërisht, ishte Çeta heroike me komandant Mestanin që me flamurin e kuq hyn triumfalisht në Çorovodën e çliruar e gjithë Skraparin më 5 shtator 1942.
Gazeta ''Zëri i popullit'' nr. 3-4/ 1942. Fq. 16, shkruante*: ''Shpartallimi i milicisë në Mëlovë dhe çlirimi i qytetit të Çorovadës e krejt Skraparit më 5 shtator 1942, janë kurorëzimi i një epopeje të shkruara me gjak prej kësaj çete heroike. Çlirimi i Skraparit, krahinë prej 100 fshatrash në*

zemër të Jugut të vendit, i paraprin frymës bashkuese të Konferencës

Në vitet e komunizmit për jetën e veprimtarinën e Mestan Ujanikut, është folur pak dhe kjo figurë e rëndësishme e LANÇ është lënë qëllimisht në hijen e harresës historike, sepse ai kundërshtoi reformat që po ndërrmerrte qeveria e asaj kohe. Në vitet e para pas çlirimit nderohet me disa tituj si : Letër Lavdërimi e merr nga Kongresi i Madh i IV – të i Bektashinjëve më 5 Maj 1945.
Ndërsa Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar z. Major Mestan Ujaniku Dekorohet me urdhrin e Yllit Partizan grada e I- rë. 23 nëntor 1945. Dhe po këtë vit përsëri Dekorohet me urdhërin e Yllit Partzan Grada e II- të me këtë motivacion që vijon: ‘*’ I pajisur me cilësi të veçanta ushtarake e Politike, është shquar për udhëheqje të guximëshme dhe plot sukses të repatreve që komandonte, në luftë kundra okupatorit dhe tradhëtarëve për çlirimit të Atdheut dhe të Popullit* Shqiptar’’.

Sekrtetari: Kryetari i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar
(Koço Tashko) (Dr. Omer Nishani)

Gjithashtu Dekorohet edhe me ‘’Medaljen e Kujtimit 1942- 43’’.

Me ardhjen e demokracisë mbas viteve të ’90 –ës në Shqipëri, bëhen rivlersime të figurave historike që kanë kontribuar për lirinë e atdheun. I tillë ishte edhe vlerësimi i figurës të Mestan Musabelli (Ujaniku) nga Skrapari dhe i gjithë Shqipërisë. Ish Presidenti i Republikës, Sali Berisha i jep Medaljen ‘’Martiri i Demokracisë’’ më 10.11 1995.
Ndërsa ish Presidenti i Repuplikës Rexhep Meidani e Dekoron me Urdhrin ‘’Shqiponja e Artë’’, në 60 – vjetorin e krijimit të saj me motivacionin:
‘*’Çetë luftarake e orëve të para, me komandant Mestan Ujanikun, që shkroi me gjak faqe herizmi në luftë kundër fashizmit dhe më 5 shtator 1942 çliroi Skraparin, krahina e parë e lirë në Shqipëri dhe Evropë’’ Tiranë, 10 shkurt 2002.*
Po në këtë vit me vendim nr. 27 datë 19. 06. 2002 Këshilli i Qarkut Berat i jep titullin: Qytetar Nderi’’ z Mestan Ujaniku (Mas vdekjes) me këtë motivacion :

''Organizator dhe komandant i të parës çetë partizane në Skrapar. Për kontribut të shquar në Luftën Antifashiste Nacionaçlirimtare''.

Mestan Musabelli (Ujaniku) bir i Tomorricës dhe Skraparit , ishte dhe mbetet një figurë që do ndiçojë si një yll në historinë e popullit shqiptar.

Durrës, 21 mars 2015.

E djeshmja sot na bën edhe më krenarë

Të flasësh për fisin Kullsi nga fshati Mëlovë të rrethit Skrapar, është pak disi sa e çuditshme, por edhe ndjenjë krenarie. Po të kërkosh pak histori prej tyre, do gjesh nëpër labirinthet e ngjarjeve historike në dekada plot drithërima e akte trimërie atdhetare e njerëzore.

Zylyftar Zak Kullsi

Fisi Kullsi e ka prejardhjen nga Sevasteri i Vlorës, dhe pikërisht nga Kullsgrehoti. Në shekuj ata kanë kultivuar atdhetarizëm.Këtë ata e kanë shprehur jo vetëm për mbrojtjen e atdheut, por edhe me forma të tjera duke i shprehur ato edhe me këngë e vallen shqiptare. Atdheu e kënga për ata ka qënë gjëja më e shtrenjtë. Kjo e kultivuar gjer në rrënjë e damarë gjaku, të shkrirë me dashurinë njerëzore. Sipas gajdhënave të të gjithave kohëve, të cilat jamë ruajtur në breza, thuhet se për shkaqe e arsye familjare,ky fis largohet nga Kullsgrehoti i Sevasterit dhe vendoset me banim në fshatin Mëlovë të luginës tomorricë-Skrapar. (Duhet të themi se një pjesë e këtij fisi ngelet po në Sevaster).

Mendohet se përafërsisht rreth vitit 1880, vendosen përfundimisht me banim në fshatin Mëlovë. Pra, jemi në kohën e sundimit të Ali Pashë Tepelenës. Rreth viteve 1840-1860 nga Sevasteri për në malin Tomorr, atje shtegëtonin tufat e bagëtve për verim. E zgjodhën këtë vend, pra fshatin Mëlovë, sepse aty gjetën mundësi jetese,pra në mirërritjen e shtimin e

blegtorisë. Këtë profesion e kishin të trashëguar në shekuj edhe në fshatin e origjinës së tyre, Sevaster. Ata janë marrë kryesisht me mirërritjen e të imtave, të dhisë e të deleve. Fshati Mëlovë i plotësonte këto kushte për jetesë në shtimin e blegtorisë, sepse kishte ujë e kullotë të mjaftushme me malin e Mëlovës e më tutje kullotat në malin e Tomorrit. Prandaj gjendet në fund të fshatit Mëlovë lagjia e fisit Kullsi, e cila është vendosur në krahun e majtë mbi lumin e tomorricës. Si kurorë i rrinë mbi krye mali i Mëlovës, mali Gostënckës e në mes Qafa e Dëvrisë.

Babai im quhej Zak Rushan Kullsi,- na thotë i biri Zylyftari.Dhe vazhdon të na tregojë më tej copza historie nga familja e tij. Babai im ka lindur në Mëlovë më 10 korrik të vitit 1890. Ndahet nga jeta në vitin 1972. Eshtë martuar me Bylyre Kullsi(Qyrani), e cila ishte bijë nga fshati Varvarë e oparit të Korçës. Nga martesa lindën 4 fëmijë: 3 djam e një vajzë. Djemtë: Zylyftar Kullsi, Halim Kullsi, Faik Kullsi. Vajza: Sheqere Xhaferri (Kullsi). Nga të dhënat gajore dhe ato shkresore, (që janë të pakta) emri i gjyshit tim quhej Rushan Kullsi. Ndërsa stërgjyshi e kishte emrin Halim Kullsi. Kurse vëllai i stërgjyshit tim e kishte emrin Zyferr Kullsi.Në gjak kanë patur e kemi atdhedashuri për të shtrenjtin atdheun tonë Shqipëri. Kjo është e shpejgueshme edhe me fakte konkrete, sepse fisi Kullsi ka luftuar trimërisht me armë në dorë kundër çdo lloji pushtuesi ndaj atdheut tonë. Ata kanë luftuar kundër turqëve, grekëve, sllavëve, italianëve e gjermanëve. Këtë e dëshmon edhe fakti i një kënge që është kënduar e këndohet edhe sot nëpër dasma për fisin Kullsi. Në luftën ndaj andrakëve grekë e italianë në vitet 1913-1914 e në vitin 1935-1940, kanë luftuar trimërisht ndaj tyre. Në librin mongrafikohistorik ‘’Tomorrica zemra jonë’’ me bashkautorë Xhevahir Cirongu publicist, poet, shkrimtar nga fshati Leskovë, e Mit’hat Fejzo nga Trebla, gjendet e shkruar edhe kënga që u kushtohet burrave të fisit Kullsi. Dhe ja, si thotë ajo këngë e monçme që ngre lartë si vetë mali i Tomorrit heroizmin dhe trimërinë të shprehur në vargje kënge.

Zakë Rushan Kullsi

Kush e çeli derën e parë
Memo Mene me Zyferr aganë,
Dilni shokë, arriti berihaja
Të dalim sipër te Metepi
Se aty krisi dyfeku.
Komandant Zyferri
Thirri me zë të lartë:
Dilni të nderojmë vatanë
Veten tonë e gjithë Skraparë.

Zakë Rushan Kullsi(10 korrik 1890-1972)

Fisi Kullsi i ka luftuar padrejtësit e të gjithave koharave nëpër shekuj. Ata iu janë përgjegjur me ashpërsi edhe bazhibozukëve e hajdutëve, por edhe tradhëtarëve të vendit, të cilët janë bërë vegël e bashkëpuntorë me pushtuesit në dëm të interesave të atdheut. Zakë Kullsi ka marrë në mbrojtje familjen e Tofe Zhurit nga fshati Postenë. Familjes Zhuri ballistët i dogji shtëpinë dhe u grabiti pasurinë. Familja ime ka qënë e lidhur ngusht me LANÇ për çlirimin e Shqipërisë nga nazifashizmi. Muharrem Kullsi ka marrë pjesë në LANÇ, së bashku me Orhan Frashërin. Edhe Shefit Zhuri nga Postena, i cili është gjaku jonë është dëshmor i atdheut. Edhe dajua im, Sabri Qylani është dëshmor i atdheut. Ai ka marrë pjesë në luftën nacionalçlirimtare. Shtëpia jonë në Mëlovë ka qënë bazë e luftës partizane. Edhe unë kam ndihmuar luftën partizane, pavarsisht se isha i vogël (10 vjeç) dhe familjen Zhuri në ruajtjen e pasurisë të Tofe Zhurit. Sot, Zylyftar Zak Kullsi aderon në organizatën e veteranëve të LANÇ. Ai është zgjedhur kryetar i organizatës së veteranëve të lagjes nr. 2 në qytetin Durrës. Këtë detyrë, ka vite që e kryen me devotshmëri si pasardhës i LANÇ. Sot në këtë 70 vjetor të çlirimit të atdheut tonë nga okupatorët nazifashist e ndjej vetem edhe më krenar, na thotë Zylyftar Kullsi.

Qërshor, 2014

Reportazh

Nëpër udhëkryqet e historisë mbetën gurë diamantësh

(Vështrim rreth librit ''Kapitët e Durrësit-shembull trimërie e shqiptarizmi'')

Të shkruash një fjalë, një varg, të bisedosh me ata burra fisnikë e bujarë, të hysh në labirinthet e botës së tyre shpirtërore, madje edhe t'u kërkosh diçka nga vetja për të mësuar rreth qëndrimit patriotik e atdhetar Kapitëve të Durrësit, është pakëz e vështirë. Kisha dëgjuar e lexuar, por edhe treguar nga të tjerët, se fisi i Kapitajve të ardhur nga Kosova, e të vendosur me banim në Shqipëri, në damarët e gjakut kishin shkruarë emrin më të dashur Atdhe! Kohët tinxare, në qiellin e tyre me re të zeza, ndikuan edhe te fisi i Kapitajve në rrugëtimin e jetës së tyre . Rrebeshet e kohëve dhe intrigat e armiqëve ndaj trojeve shqiptare, bënë që edhe te Kapitët të ndikonin për keq, deri aty sa përdorën çdo llojë dhune e masakrimi për t'i nënshtruar këta atdhetarë, të cilët mbronin vatrat stërgjyshore. Por, erdhi një ditë, ashtu rastësisht, të takoj në një kafene njërin djalë të atdhetarit Sadri Kapitit, të cilit emrin ia kisha dëgjuar e lexuar diku, por personalisht nuk e njihja. Ja , pra, kjo rastësi e pas një kafe miqësore, unë takoj Skënder Kapitin, njeriun fjalëpak, por në bisedë e sipër mëson se ke të bësh me një njeri bujar e atdhetar. Te ky njeri, dalngadalë gjatë bisedës zbulon shumë ngjarje që kanë të bëjnë me atdheun e kombin, por që i mban brenda kullës së shpirtit. Megjithatë, vjen një ditë, ashtu pa e kuptuar edhe ai vetë, gjithashtu edhe të vëllezërve të tij, që dikush t'i zbrazi nga kulla e shpirtit të tyre, ngjarjet historike e atdhetare nëpër kohët e ndryshme, e që të ''ftojnë'' për t'i mësuar në sofrën e madhe të atdhedashurisë e atë patriotike. Nëpër udhëkryqet e historisë, Kapitët nuk u mposhtën kurrë përballë vështirësive, por qëndruan të fortë si gurë diamantësh, sepse ata ishin të vetëdijshëm në qëllimin e aspiratave e të luftës së tyre. Atdheu e Liria ishin gjëja më e çmuar, saqë edhe janë flijuar me jetën e tyre.

Në librin të titulluar **''Kapitët e Durrësit,- shembull trimërie e shqiptarizmi''** të autorit Bedri Tahiri, nëpërmjet fakteve historike të djeshme e të sotme, na sjell heroizmin, trimërinë, zgjursinë, atdhedashurinë që kanë ata për trojet shqiptare, që ato të jenë të lira,ku flamuri ynë kombëtar të valëvitet krenar në qiellin e kaltër të Shqipërisë sonë. Më konkretisht shkrimtari Bedri Tahiri shkruan se:

''Sadri Kapiti u lind më 1915 në Zallq të Istogut. Rridhte nga një familje patriotike e ardhur andej nga rrethina e Medvegjës. Babai i tij, Ibrahimi, një kaçak i kohës së Azem Galicës, dhe nga fisi i tij kanë dhënë jetën dy veta në luftën për mbrojtjen e Shkodrës kundër serbo- malazezve. Edhe Sadriu kurrë nuk u pajtua me serbin e pabesë, i cili edhe i kishte dëbuar dhunshëm nga trojet e veta stërgjyshore në vitet 1878-1880, duke i lënë pa plangë e pa shtëpi…''.

Meqënse ishte akoma i vogël, Sadriu me intuitën e tij natyrale, kuptonte shumë e vëzhgonte me kujdes ngjarjet e kohës, të cilat rridhnin njëra pas tjetrës duke dëmtuar interesat kombëtare.

Ai nuk i duronte dot kurthet politike e sundimin të serbomalazesëve, të cilët i kishin dëbuar dhunshëm nga trojet e veta, dhe del hapur kundra kësaj politike skllavëruese të trojeve shqiptare. Si rrjedhim i këtij qëndrimi patriotik e atdhetar, nga regjimi sllavomalazes ndiqësh hap pas hapi si një njeri i pa dëshirueshëm i regjimit. Në këto rrethana, ai u detyraua të hyjë nëpërmjet Alpeve Shqiptare drejt Shqipërisë. Por, edhe këtu regjimi Komunist e degdisi në internim në fshatin Ahmetbejas të rrethit Fier. Ai kurrë nuk u gjugjëzua, por vazhdoi duke mos iu trembur syri rrugën e nisur për lirinë e Kosovës e të trojeve shqiptare. Mbas dy vitesh kthehet sërisht në Kosovë, por pa shpresë se zjarri qe ndezur edhe më shumë. Kudo mbi shqiptarët zotronte varfëria,tortura, dëbime, deri në emelinimin fizik të tyre. Gjaku i shqiptarit s'mund të bëhej ujë, sepse nga gjaku i derdhur po mbinin lulet e lirisë së Kosovës! Duke shletuar librin, informohesh për gjithë ngjarjet që kanë pasuar njëra-tjetrën te fisi Kapitajve, deku u vendosur me banim të vitit 1939 në fshatin Fllak të rrethit Durrës.

''-Në jetën private,- shkruan autor i librit, Sadriut i kishte ecur mirë e mbarë. Fatin e kishte lidhur me një malësore nga Gremniku i Klinës, me Dinore Mehë Gashin Këtyre dy bashkëshortëve u lindën tetë fëmijë: Sylejmani, Fatmiri, Skënderi, Naimi, Ganiu, Lirija, Nadirja dhe Shefkija. Të gjendur midis kudhrës dhe çekanit, ata u bënë tok dhe ia vunë gjoksin së keqes, duke qëndruan të pathyeshëm, mu si lisat e Kosovës martire''.

Shkrimtari Bedri Tahiri , përshkruan me kujdes figurën e nacionalistit Sadri Kapitit. Ngjarjet jepen konkrete në libër,duke na dhënë të vërtetat në rrafshin historik, pa dorashka që përciellin te historiani,filozofi, intelektuali, shkrimtari, e deri te lexuesi i thjeshtë qëndrimin burrëror, patriotik e atdhetar të Kapitajve në breza. Ky qëndrim atdhetar është një shembull tipik, ku kanë ç'të mësojnë brezi i sotëm dhe brezat që do vijnë. Ja si shkruan Bedriu:

"- Sadriu si një nacionalist i përbetuar gjatë shërbimit ushtarak në Tiranë rrahu një oficër dhe dy ushtarë italianë, sepse kishin ngacmuar dhe fyer disa femra shqiptare në qytet. Që nga aty e braktisi fare ushtrinë dhe në vitin 1940, u kthye në Istog, me shpresë se Trojet Etnike Shqiptare u çliruan dhe u bashkuan''…

…Dhe vazhdon më tej:

''-. Mori pjesë në luftërat dhe betejat për mbrojtjen e myslimanëve dhe shqiptarëve të Sanxhakut e të Kolashinit. Atje iu vra edhe i nipi, Sadiku, trupin e të cilit nuk e la, por e barti në shpinë deri në vendlindje. Më vonë u inkuadrua në Brigadën e tribunit Shaban Palluzha.''

Në këtë vëllim të ri të autorit Bedri Tahiri, përveç të tjerash gjen edhe dorëshkrime të autorëve të ndryshëm të cilët kanë shkruar me përkushtim për Kapitët e Durrësit. Ata kanë nxjerrë në pah qëndrimin patriotik e atdhetar të bijëve të nacionalistit Sadri Kapiti.

Duhet thënë me forcën e arsyes e të logjikës së ftohtë, se qëndrimi atdhetar e patriotik, përkushtimi i vëllezërve Kapiti në mbështretje të UÇK-së,është një gur themeli në vetë historinë e Re të shtetit Kosovar. Po të vështrosh me kujdes oazin e veprimtarive në gjithë hapsirën historike atdhetare e patriotike të fisit Kapitajve, e sidomos të vëllezërve të Kapitajve të Durrësit, do njihesh me gjerdanin e historik të kohës ku rrezatojnë si gurë diamanti gjithë veprimtaria e tyre,për lirinë e Kosovës e të bashkimit Kombëtar të trojeve shqiptare në një trung të vetëm me emrin Shqipëri!

Sadri Kapiti ka qënë partzan dhe ka marrë pjesë në brigadën e 3-të Sulmuese, dhe ishte invalid i LANÇ. Me kalimin e kohës dhe sipas kushteve të trasformimeve politike e shoqërore që ndodhën edhe në Shqipëri, lë katundin Fllak e Qerret dhe vendoset me banim në lagjen 14 Shozet të qytetit Durrës. Më 7 janar të vitit 1997, Sadriu ndërron jetë dhe prehet në varrezat e fshatit Rrashbull. I mbylli sytë me plagën në zemër se nuk arriti ta shoh Kosovën e lirë e të bashkuar me Shqipërinë mëmë. Në çdo kuvend burrash Sadriu shprehej: *"Kryet më ka lindur në Kosovë, trupi m'u burrërua në Shqipërinë nanë…*Dhe e vazhdonte duke thënënë:*'' Lum kush ta shikojë e ta gëzojë, more lum miku!"*.

… "*Sadri Kapiti ka qenë burrë mbi burra. Fakti është që edhe bijtë ndoqen besnikërisht rrugën e tij"- ka thënë z.* ***Qemal Mançe,*** *ish kryetar i Shoqatës së Invalidëve të LANÇ për rrethin e Durrësit.*

Në një përleshje me serboçetnikë Sadriu plagoset rëndë në shpatullën e majtë dhe në këmbën e djathtë. Kështu, Sadriu kishte edhe statusin e invalidit të LANÇ.

@ Kuvendi Komunal në Vushtrri, më 10.07. 2013, vendosi që rruga nr. 171 të emërohet "SADRI KAPITI". Ky është një vlerësim midis të tjerash që i bëhet pas vdekjes patriotit e atdhetarit që kishte sakrifikuar aq shumë për lirinë e pavarsinë e Kosovës.
Sadriu u mëkoi edhe fëmijëve atdhedashurinë, lidhjet me vendlindjen e tij, Drenicën.Historia e lavdisë së ''Drenicës'' lidhet me heroin legjendar **Adem Jashari,** me të cilin kanë pasur njohje personale edhe djemtë e Sadriut. Lokali me emrin ''Drenica'' e Durrësit u bë streha e parë e mobilizimit të ushtarëve të UÇK-së.

Ata vinin nga të gjitha anët e botës e nga të gjitha viset shqiptare, nga Çameria, Labëria, Përmeti, Berati, Kavaja, Durrësi etj. Grupet e para erdhën nga Gjermania. Ka pasur edhe të huaj: francezë, suedezë, gjermanë, skocezë, anglezë, italianë, finlandezë. Nuk mund të harrohet j kurrë luftëtari italian me pseudonimin "KOBRA", i cili, pas shumë betejash e luftimesh në Kosovë, ra dëshmor i UÇK-së. Ai u bë krenaria dhe nderi ynë, të cilën edhe të hujët e admironin.

Nga 24 marsi deri më 10, përkatësisht 12 qershor të vitit 1999, fillon historia e re e Kosovës. NATO vihet në luftë duke bombarduar caqet ushtarake serbe deri në çlirimin e Kosovës. Por, gjatë kësaj kohe, popullata shqiptare përjetoi një prej etapave më të vështira, duke u përballur me një dhunë brutale të forcave serbe. Më 5 mars të vitit 1998, forcat serbe sulmojnë fshatin Prekaz i Ulët, ku vrasin Adem Jasharin, figurën që për shqiptarët nënkupton komandantin legjendar të UÇK-së.

Lufta e Kosovës filloi me 28 shkurt të vitit 1998, pas sulmit jugosllav në fshatërat Likoshan dhe Qirez në Drenicë të Kosovës. Lufta nga 28 shkurt 1998 e deri më 23 mars 1999 u zhvillua mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave jugosllave. Ndërsa nga 24 mars 1999 e deri më 10 qershor 1999, Aleanca Veriatlantike NATO me bombardime të përditshme në caqet ushtarake jugosllave, me përkrahjen tokësore të UÇK-së detyroi forcat serbomalazeze dhe Kasapin e Ballkanit Sllobodan Millosheviçin të nënshkruaj kapitullimin në Kumanovë. Në këtë luftë u dëbuan 800,000 mijë shqiptarë, u vranë 15,000 persona, nga të cilët 2,400 luftëtar të UÇK-së e të tjerët civilë.

Peshën kryesore të dëbuarëve nga Kosova e mbajti Shqipëria, ku gjetën strehë në vatrat shqiptare vëllezrit e një gjaku mbi 500 mijë kosovarë. Kjo mikëpritje e pazakontë nga shqiptarët e shqipërisë çuditi gjithë popujt e mbarë globit. Ata i bënin pyetje vetes: ''Si ka mundësi që një popull kaq i vogël në numër dhe gjeografikisht të mbajë në

gjirin e vet kaq refugjatë lufte?!'' Mikëpritja, dhe dashuria për vëllezrit tanë kosovarë, tregoi mbarë kombeve e popujve të botës se Shqipëria është një dhe vetëm një. Atdheu, liria e gjuha janë gjëja më e shtrenjtë për shqiptarin!

Sa më shumë vite të kalojnë, aq më shumë i rriten vlerat historike atij lokali të vogël buzë detit Adriatik në Durrës.Materialet e shkruara historike, që një pjesë e tyre gjenden në këtë libër ''Kapitët e Durrësit,-shembull trimërie e shqiptarizmi''janë vlera e dëshmi të asaj pjese historie të lavdishme të popullit shqiptar.

Ishte dita e 17 shkurtit të vitit 2008, ku lindi shteti më i ri i botës, Republika e Kosovës.Edhe ish kryeqëndra e dipllomacisë politike e ushtarake, siç ishte në atë kohë ''Drenica'' e Durrësit, ajo priti në sofrën e saj bujare për të festuar, nxënës e studentë, intelektual e krijues, ushtarakë e politikanë, mjekë e avokatë, punëtorë e specialistë... Vëllezrit Kapiti, këta ambasadorë të vërtetë, si dje në organizimin e mobilizimin e ushtarëve të UÇK-së, edhe në këtë ditë të shenjtë të pavarsisë, i gjen pavetmburrje në krye të organizimit për këtë ditë të shumëpritur nga gjithë shqiptarët që festonin deri në Australi. Sot e themi me plot krenari, sepse ajo çerdhe e vogël dallëndyshe buzë detit adriatik, ''Drenica'' e Durrësit, është tempulli i qëndresës që dëshmon historinë tonë, por edhe edukimin patriotik e atdhetar të brezave sot e nesër. ''Drenica'' e djeshme ishte ura lidhëse e të gjithave trojeve shqiptare që grumbulloi rreth vetes shqiptarët kudo nëpër botë.Jo vetëm kaq, por edhe sot , aty vizitorët janë të shumtë, të të gjithave kombësive që vinë në qytetin e Durrësit e përulen me respekt te kështjella e bashkimit të shqiptarëve.

Nga Memoriali **"DRENICA"** atë ditë festive historike, iu dërgua një letër përshëndetëse **Xhorxh Bushit**, të cilën, para të pranishmëve e lexoi publicisti dhe krijuesi i njohur, z. **Bashkim Hoxha**. Nga kjo deklaratë ne shkëputëm këtë fragment ku thuhet:

''... Nëpërmjet jush ne dëshirojmë t'i shprehim mirënjohjen tonë Kongresit të SHBA dhe institucioneve të tjera ligjvënëse amerikane, të cilat kanë qenë gjithnjë të ndjeshëm në miratimin e një varg rezolutash, ku është denoncuar dhe dënuar shkelja e të drejtave të njeriut në Kosovë, dhuna dhe terrori sistematik i Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës, dënimi i politikave të spastrimit etnik....''

Pikërisht, ishte ''Drenica'' e Durrësit ajo që priti e përcolli 11 mijë luftëtarë të UÇK-së. Me të drejtë gazetari Thanas Mustaqi në një reportazh të botuar në gazetën ''Zëri i popullit'' më 9 prill të vitit 2000, shkruan se, *" Populli e ka shpallur me zemër "Drenicën" një **"Mekë"** të atdhedashurise."*

…Dhe duke vazhduar, më tej shkrimtari Bedri Tahiri nënvizon për kontributet që kanë dhënë edhe medjet e shkruara e televizive të qytetit të Durrësit në përkrahje të çështjes sonë kombëtare, në luftën për çlirimin e Kosovës.

''Bashkim Hoxha publicist, gazetar, dramaturg dhe shkrimtar i njohur durrsak gjatë krizës kosovare dhe luftës çlirimtare të UÇK-së, si pronar dhe drejtor i TV Teuta e vuri televizionin dhe numrin e telefonit të tij në dispozicion të mobilizimit të luftëtarëve, të bashkimit të familjeve dhe të akomodimit të të dëbuarëve nga Kosova në kampet e strehimet dhe në familjet durrsake. Krah tij ishte edhe bashkëpunëtori i palodhur, kamaeramani dhe fotografi Gëzim Domi, i cili ka sot fotostudjon dhe ekkspozitën fotografike ndër më të mirat në Shqipëri''.

@ Një vend të veçantë autori i librit Bedri Tahiri, i kushton edhe mirënjohjen ndaj gazetës **''Bulevard''** dhe gazetarit **Artur Llana**, ku edhe shumica e këtyre shkrimeve janë publikuar më parë në gazetën e tij.

@ Ndërsa gazetari Aleks Kalemasi për ''Drenicën'' e Durrësit shkruan: *''Restorant "DRENICA" tashmë është shndërruar në një kult të patriotizmit shqiptar...'' dhe vazhdon: '' Skënder Kapiti, figura kreysore e pritjes dhe përcjelljes së kosovarëve që vinin nga Amerika, Australia, Gjermania, Zvicra, Turqia, Kanadaja dhe vendet e tjera për të veshur uniformën e UÇK-së, thotë: ''Kemi derdhur shumë gjak dhe kemi merituar të festojmë pavarësinë''.* **Gazeta Telegraf, e diel,17 shkurt 2008.**

@ Ndërsa Kadri Tarelli midis të tjerash shkruan:

*''Pas dhjetë vitesh, ish luftëtarë të batalionit "**Atlantiku",** në këto ditë parnvere, rikthehen në Durrës, tek hotel drenica, për të bërë homazhe tek përmendorja Luftëtari i panjohur, në nderim për të gjithë ata luftëtarë të lirisë, të cilët nga këtu u nisën drjt Kosovës, drejt udhës së luftës, për çlirimin e saj nga sundimi serb''.*

Gazeta ''Bulevard'' e shtunë, 25 prill 2009.

@ Oerd Ulqini në gazetën ''Panorama'' e mërkurë, 22 prill 2009 shkruan se:

'' Dhjetë vjet pas formimit të batalionit "ATLANTIKU", ish ushtarët e UÇK-së janë rikthyer në lokal "DRENICA", në plazhin e Durrësit, pikërisht në atë vend ku bënë betimin''...dhe vazhdon....

''Atlantiku është një batalion shqiptarësh të Amerikës, por e veçanta është se aty u mblodhën njerëz me origjinë nga Plava dhe Gucia, Ulqini, Shkupi, Tetova, Prizreni etj.''

@ Hazir Mehmeti nga Vjena midis të tjerash në gazetën ''Ndryshe'' e mërkurë 2009, shkruan:

'' Në jetën tonë më të re të mobilizimit të madh kombëtar nuk do harrohet kontakti i parë me atdheun në Durrësin bregdetar . Në kohën e UÇK-së. djemtë më të devotshëm nga e gjithë bota, me mallin mbi supe e hidhërimin në zemër për armikun morren rrugën e nderit e të lavdisë. Vaporit Bari-Durrës i dridhej barku nga pesha. Në Durrësin shekullor u priten nga vëllezërit durrsakë ashtu siç di vëllai ta pres vëllain në ditë për jetë a vdekje. Në ballë të tyre u gjenden vëllezërit Kapiti: Sylejmani, Fatmiri, Skenderi, Naimi dhe Ganiu. Ata i pritnin djemtë hijerëndë ke porta e kullës së tyre ''DRENICA". Ajo ishte fortesë e kohës''.

@ Edhe Xhevahir Cirongu, ka bërë këtë vlerësim për Skënder Sadri Kapitin, në pronovimin e librit '' Triumfi i Kombit'', si potriot, atdhetar e shkrimtar.Sepse Skënderi është edhe njeri i letrave të shkruara, ku ka botuar disa libra me karakter filozofik, shoqëror e atdhetar.

Më konkretisht:

''Autori Skënder Kapiti ka një filozofi disi ndryshe nga të tjerët autorë, sepse kur ai merr penën e shkruan ndëthur faktet historike e atdhetare me një rrëfenjë interpretim bindse me bazë shtratin e fakteve, që për gjatë rrugëtimit historik e kulturor nëpër shekuj zbërthen filozofikisht e psikologjikisht ngjarjet jetësore''. Durrës,maj 2013.

@ Vladimir Muça zbërthen natyrshëm mbi vështrimin shoqëror për nga vlerat që përcjell te lexues e intelektuali, në gjithë shtresat shoqërore libri "Triumfi i Kombit'' të autorit Skënder Kapiti.

Midis të tjerash thotë se: ''Shumë tema interesante shpalosen në këtë libër në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare e të kujtesës historike''.

Takimet e shkrimtarit Kosovar Bedri Tahiri me njerëz të thjeshtë dhe personalitete janë të shumta, nga të gjitha trojet shqiptare: me poetin dhe akademikun Xhevahir Spahiu, me shkrimtarin, kritikun dhe kolnelin Shpend Topollaj, me avokatin dhe njohës i mirë i çështjes kosovare Ilir Malindi, me komandantin Novruz Zejnati, me poeten çame, Fatime Kulli etj.

Një vend të rëndësishëm në këtë libër me titull: ''Kapitët e Durrësit- shembull trimërie e shqiptarizmit'' zënë intervistat që ka bërë autori me **poetin akademikun Xhevahir Spahiu**, si dhe me avokatin e nacionalistin e përbetuar, z. **Spartak Ngjela**.

''-Por unë kam një porosi: U bë Kosova, të bëhen kosovarët! Pse e them këtë? Sepse lufta u bë, liria erdhi dhe tashti duhet emancipimi kulturor, shkollimi, dija, shkenca, përparimi. Qeveria e sotme është zgjidhje e përshtatshme. Nëqoftëse UÇK-ja e shpëtoi Kosovën në luftë, duhet të di ta ruaj edhe në paqe'',- thotë avokat Spartak Ngjela.

…Midis të tjerave, gjatë intervistës dhënë autorit të librit, poeti Xhevahir Spahiu shprehet konkretisht për ''Drenicën'' e Durrësit:

'' - Shpirtërisht kam qenë jetë e mot me Drenicën heroike....

Po, "DRENICA" e Durrësit është qendra kryesore e frymëzimeve atdhetare këtu buzë detit, është Tempull atdhetarie!''.

Në libër autori Bedri Tahiri, sjell edhe lajtmotive nga shoqata e organizma të tjera shoqërore e atdhetare, të cilat kanë përcjellë për te organizmat shtetërore, që **''Drenica '' e Durrësit** të shpallet **Shtëpi Muze**, si qëndër e atdhetarizmit dhe e bashkimit kombëtar të të gjitha trojeve shqiptare. Dhe me të drejtë ato u kanë kërkuar organeve kopetente, si të pushtetit lokal dhe atij qëndror, në Shqipëri e Kosovë, që ''Drenica'' të jetë simbol i edukimit e i bashkimit tonë kombëtar. Një gjë të tillë, e ka kërkuar edhe Shoqata Kulturore e Atdhetare ''Tomorri'' dega Durrës.Në mbyllje të librit jepen fptopamje në kohë të ndryshme, që pasqyrojnë aktivitetin patriotik e atdhetar që shprehin fuqishëm patriotizmi atdhedashurinë, heroizmin të popullit tonë të të gjithave trojeve të fundshekullit të XX-të e fillimet e shekullit të XXI- të, të gërshetuara edhe me faktorin e dipllomacinë ndërkombëtare.

''Dernica'' e Durrësit ishte dhe mbetet ambsada e parë e ribashkimit të të gjithave trojeve shqiptare, sepse aty lindi ideja''Një komb, një gjuhë, një flamur!''. Tashmë populli e ka shpallur me kohë ''Drenicën'' Shtëpi Muze, ku qëndron e gjallë historia jonë, e djeshmja, e sotmja, ku do u flas nesër brezave që do vijnë, sepse aty është gjaku i 2400 dëshmorëve të UÇK-së, të tre dëshmorëve të kombit, Indrit Cara,- Kavajas, Astrit Suli,- shqiponja e Tomorrit nga Lumasi - Berat, Skerdilajd Llagami nga Tirana, i mijrave njerëzve civilë të masakruar e të gjymtuar, të invalidëve të UÇK- së, sakrifica e popullit tonë, të cilët apelojnë me forcën e krenarisë së ligjshme që ''Drenica'' e Durrësit të shpallet Shtëpi Muze.

''Drenica'' e Durrësit është djepi i historisë dhe i atdhedashurisë , por edhe e kulturës së kombit tonë. Një thesar që duhet vlerësuar nga të gjithë, sepse ajo është e të gjithëve.

Xhevahir Cirongu
Publicis, poet , shkrimtar

Durrës, tetor 2013

Reportazh

Atje mes piktorëve të vegjël Durrësakë

(Me rastin e festive të fundvitit: Krishtlindjet e Viti i Ri 2014!)

Ishte një takim i bukur e mbreslënës atë mbasdite mbrëmje të datës 25 dhjetorit 2013 në galerinë e piktorit Nuri Jaupllari.Piktorët e vegjël të lagjes '' 13- Plazh'',të cilët janë nxënës të shkollës 9 vjeçare(1-2) 'Bajram Curri''; ekspozuan punimet e tyre të cilat i kishin punuar me një fines të hollë e plotë kolor ngjyrash.Tematika e piktorëve e paraqitura ishin të shumëllojshme dhe e larmishme në teknikat e punimeve. Kjo ekspozitë e piktorëve të vegjël, për nga lloji e tematika që mbartin pikturat në vetvete,ishin një dëshmi e vlerave dhe e pasionit që kanë grupmoshat e ndryshme të fëmijëve. Ata pasqyrojnë botën e tyre të brendshme dhe talentin nëpër mjetë pikturës, që rrëmbejnë me shikim të parë vizitorin. -Kjo është ekspozita e dytë për nga lloji i vetë,por edhe sipas shijeve që kanë piktorët e vegjël ku shprehin intuitën e talentin në gamën e pikturave që paraqesin sot këta piktorë në ekspozitë,-na thotë piktor Nuriu.Edhe vizitorët aty ishin të shumtë atë mbrëmje. Piktorët e vegjël krahës festës së Krishtlindjes e vitit të Ri, u gëzoheshin edhe punimeve të pikturave që i kishin punuar ata vetë. Piktorët e vegjël, që e duanë artin e pikturës, të flasin me një pasion e dëshirë të madhe që nesër të bëhen dikush në jetë.Ja ç'na thotë piktorja Artieda Haliti:- E dua pikturën një lloj si nënën,sepse pasioni im dhe ëndrra e të ardhmes sime është piktura. Sot jam në klasën e 9-të, në shkollën (1) ''Bajram Curri'' këtu në Plazh. Kam disa vite që jam aktivizuar në rrethet e pikturës, prandaj unë vazhdoj edhe kursin e pikturës që nesër të konkuroj për të vazhduar arkitekturën, pra të bëhem arkitekte që ti shërbej vetes dhe atdheut tim! Edhe piktorët e tjerë shprehin të njëjtën gjë kur i pyetë ata. Piktorje e re, Artieda Haliti ka lindur në Durrës, pra në lagjen 13 Plazh. Familja e saj është me origjinë nga Kosova.Në qytetin e Durrësi kanë ardhur në vitin 1998, atëherë kur filloi edhe lufta për çlirimin e Kosovës. -E ndjej veten krenare me punimet e vajzës sime e të shokëve në këtë ekspozitë, sepse përkon me 5 vjetorin Pavarsisë së Kosovës,-na thotë nëna e Artiedës që ishte e pranishme në këtë ekspozitë mbreslënse të këtij fundviti 2013.
E veçanta e asaj dite festive ekspozuese në galerinë e piktorit N. Jaupllari, ishte edhe pjesmarrja e prindërve të piktorëve të vegjël. Ata u gëzoheshin kur shikonin punimet e pikturave të paraqitura në stenda nga fëmijët e tyre. Për këta fëmijë që duan artin, pjesëmarrja e prindërve dhe qytetarët e tjerë

vizitorë, ishte një mbështetje që të vazhdonin rrugën e bukur të artit edhe në të ardhmen kur të rriten. Ne mundëm të shkëpusim disa emra të piktorëve të vegjël që ishin pjesëmarrës në këtë ditë festive të Krishtlindjeve e të vitit të Ri 2014, që me pikturat e tyre përcillnin paqe e dashuri sa njerëzore dhe peizazhin e natyrës ku pa të cilën nuk jetojmë dot, sepse jemi pjesë e saj. Më shumë se kush,edhe piktorët e vegjël këtë mesazh përcillnin për te vizitori e shoqëria nëpër mjetë ekspozitës. Ata ishin: Migela Naska,Jori Tabaku, Klara Bejko,Lorena Bala, Ergys Demaj, Fabion Myftari, Irini Myftari, Aleksandër Prendi, Lejdo Merollari, Ija Çela, Teo e Besi Sot janë të vegjël në moshë e si talent, por nesër do bëhen mbase të famshëm që ti shërbejnë me artin e tyre shoqërisë e atdheut.Edhe ne ju urojmë suksese në rrugën e nisur të artit. Gëzuar 2014!

Foto Xhevahir Cirongu. Piktorët e ardhshëm!

Gëzuar Krishtlindjet e vitin e Ri 2014! **Durrës, 25 dhjetor 2013.**

Monografia ‘’Lulëkuqet e Kastriotit’’ udhërrëfyese e fjalës të shkruar me pika gjaku

(Vështrim rreth librit me të njëjtin titull të autorit Bedri Neziri. Aktualisht kryetar i Shoqatës të Shkrimtarëve ‘’Fahri Fazliu’’ Kastriot-Kosovë.)

Ishte takimi plotfrutdhënës e i ngrohtë të poetekës ‘’Pranvera poetike Durrsake’’ që grumbulloi shumë poetë në qytetin bregdetar; jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga trevat e ndryshme të Kosovës. Ky takim i përvitshëm letrar, krahas prurjeve poetike cilësore ka mundësuar që poetët e shkrimtarët të takohen edhe fizikisht midis tyre. Të tilla manifeste të fjalës poetike janë bërë shkas që midis vetë poetëve, të fjalës së shkruar poetike të marrin e japin eksperienca të vlefshme, që vargu poetik të vezullojë dritë kristali, e të ndezë llavën e dashurisë brenda shpirtit të lexuesit.

Edhe për mua,pata fatin që të më binte në dorë një libër monografik të autorit kosovar Bedri Neziri. Pasi e lixova , nxora konkluzion se autori kishte bërë një punë me të vërtet kolosale, sepse aty ‘’Pema’’ e historisë letrare dhe atdhetare përshkruhej me degët e saj të veshur me

gurë xhevahiri dhe brenda tyre kishin të lyerë shkronjat e fjalët me gjak shqiptari. Të bësh letërsi dhe historinë ta derdhësh në vargun letrar, është pakëz e vështirë, por në gjithë rrugëtimin e vetë 50 vjeçar të Shoqatës së Shkrimtarëve ''Fahri Fazliu'' të komunës Kastriot, me kontributin e tyre letrar e atdhetar, djemtë e vajzat me një guxim prej shqiponje mali, ditën të thoshin fjalën e tyre të shpirtit edhe me të shkruar; në një kohë makabre të errësirës, ku vihesh në pikëpyetje vetë egzistenca e shqiptarëve të Kosovës.

(Në sfontë ballina e librit monografik të autorit Bedri Neziri)

Ata me një guxim të paparë e zgjuarësi në kushtet e një terrori psikologjik e ushtarak shtetëror, ia dolën mbanë këtij oqeani me ujëra të turbullta që vinin nga shekujt, dhe shkruanë fjalën e bukur shqipe. Pra, fjalën e nënës një nga gjuhët më të vjetra të të gjithave gjuhëve të botës: Fjalën yjneshë qiellore shqipe e dhuruar nga vetë Zoti!

Monografia e autorit Bedri Neziri, që tashmë lexuesi ynë e ka në dorë, përshkruan historinë letrare e atdhetare të Shoqatës së Shkrimtarëve ''Fahri Fazliu'' me një gjuhë të rrjedhshme, shkallë pas shkalle të qelqta, e na jepen fakte konkrete ku dëshmon për historinë nëpër dekada të popullit shqiptar të të gjithave trojeve tona. Duke filluar nga Shqipëria, Kosava, Çamëria,

Dibra e Madhe (Maqedoni), Ulqin (Mal i Zi), Preshevë. Monografia ''Lulëkuqet e Kastriotit'' është e ndarë në shtatë kapituj. Për çdo nëndarje të kapitujve në libër janë pasqyruar aktivitetet letraroartistike e atdhetare të shumë autorëve të trevës së Kastriotit të cilët kontribuanë me pushkë e penë për larinë e Kosovës. Por aty flitet edhe për aktivitetet letrare e atdhetare edhe të trevave të tjera si motra nëpër Kosovë që kanë dhënë e japin me anën e fjalës së shkruar të rrisin në një shkallë më të lartë vetëdijen e ndërgjegjes kombëtare në fuksion të lirisë e pavarsisë, për një zhvillim të mbarë shoqërisë sonë. Pikërishtë, është kjo ndjenjë kombëtare që ka shtyrë autorin e kësaj monografie Bedri Neziri që tëshkruajë këtë monografi, që është i dyti i botimeve të tij. Edhe titulli i kësaj monografie ka një gjetje të bukur e domethënie të madhe, sa letrare e historike ''Lulëkuqet e Kastriotit''; sepse çdo gërmë e fjalë pikon gjak dëshmori të derdhur për liri e pavarësi të Kosovës martire. Prandaj mban edhe emrin e dëshmorit të Kombit ''Fahri Fazliu'' Shoqata e Shkrimtarëve të komunës së Kastriotit në Kosovë.

''Veprimtaritë e organizuara letrare ,siç thotë autori në këtë libër monografik, datojnë që nga vitet '60-të të shkullit të kaluar, ku krijuesit e saj kohe ishin të organizuar në grupe letrare në kuadrin e Shoqërisë Kulturoro- artistike ''Aca Maroviq'' ,vepronte edhe grupi i muzikës, recituesve, i dramës, e të tjerë''. Eshtë për t'u theksuar se fillesa bërthamës letrare të komunës së Kastriotit, merr udhën e vetë me daljen e gazetes së punëtorëve me titull ''Kombinati Kosova'' e cila kishte filluar botimet e saj në mars të vitit 1964 në dy gjuhë: Shqipe dhe serbokroatisht. Aty janë botuar skica e reportazhe , ditarë minatorësh nga autorë të ndryshëm si : Mirko Gashi, Adem Zaplluzha, Halil Kajtazi,Selman Kanjusha, Ramiz Rashiti, Qerim Pllana, Hamdi Tasholli, Avdi Shala, Iljaz Prokshi, Emin Kabashi, e të tjerë.Përshkrimi i ngjarjeve të historisë letrare, siç shkruam më lartë, Shoqata e Shkrimtarëve ''Fahri Fazliu'' ka bërë një veprimtari me intesitet të dendur atdhetar e letrar përkujtimor, duke filluar nga 526 vjetroi i vdekjes së heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti (Skënderbeu), të Rilindësave, Shpalljes së Pavarsisë (Kjo monografi botohet me rastin e 100 vjetorit të Shtetit Kombëtar Shqiptar dhe të 32 vjetorit të Demonstratave gjithëpopullore 1981 në Kosovë), dëshmorëve të Kosovës etj. Manifestet përkujtimore letrare jepen si një dëshmi e gjallë në monografi të cilat janë bërë simbole e kranari në ndërgjegjen tonë. Përkujtimore janë zhvilluar edhe në nderim të dëshmorëve Bardhosh e Isuf Gërvalla, Kadri Zeka. Por edhe orë letrare kushtuar Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe epopesë së UÇK-së .Në monografi flitet edhe për Adem Demaçin, njeriun simbol të rezistencës kombëtare, i cili sot është edhe kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Në monografi na jepen si një skanër me detaje autoportetet e poetëve e shkrimtarëve të Shoqatës ''Fahri Fazliu'' të cilët paraqiten kronologjikisht me biografinë e tyre që nga themelimi i shoqatës deri më sot. Autori ngulmon të përshkruajë sa më qartë për se cilin prej tyre për jetën krijuese letrare. Kështu, në gjithëpërshkrimet e librit, autori Bedri Neziri krijon sentencë orgjinale të marra së bashku me oksigjenin krijues letrar e patriotik. Ai bën vlerësim konkret e përgjithësues edukativ, estetik, dhe në qëndër vendos fjalën e gjakun e

dëshmorëve; aty ku liria ka rrënjët e saja dhe çelin çdo ditë lulëkuqet në Kastriot të Kosovës, në mbarë Shqipërinë. Aty rreshton emrat e Halil Kajtazi, Mehmet Zhinipatoku, Mirko Gashi, Avdi Shala, Adem Zaplluzha, Nezhmi Dibrani, Qerim Pllana, Milazim Berisha, Isuf Grajçevci, Selman Korjaku,Iliaz Prokshi, Hamdi Tasholli, Ismail Simnica, Isak Hovolli, Ahmet Pllana, Ismet Tahiraj, Bedri (Avdullah)Neziri, Fatime Beka,(Pllana), Shahbaze Vishaj, Fazli Nuhiu, Sanije Ahmetaj,(Dubova),Begzad Baliu, Mustafë Krasniqi, Shqipe Hasani, Betim Brogvina, Shqipe Naim Mjekiqi, Edita Malazogu. Letërsia dhe arti në përgjithësi janë pasqyra e një kombi, sepse aty flet historia e kultura e një populli. Prandaj themi me bindje se libri monografik që na paraqet Bedri Neziri; është gur themeli për historinë letrare e atdhetare në Kastriot e të kombit tonë të trashëguar në shekuj, që përcjell të djeshmen e të sotmen, të nesrmen në breza të karakterit të shqiptarit, fisnikërinë të etur për liri, por edhe vetmohimin në emër të saj. Pra, të gëdhendur flatra shqiponje në thellësi të shpirtit të tij dashurinë për trojet e të parëve tanë me një emër madhor : Shqipëri! Shoqata e Shkrimtarëve ‘’Fahri Fazliu’’, ka marrë shumë vlerësime për kontributet atdhetare e letrare , liridashëse për çeshtjen kombëtare.Një nga këto është edhe ajo që i jep Drejtoria e Kulturës e Rinisë dhe Sportit të Kuvendit Komunal i Obeliqit, ndan: ‘’Mirënjohje për Shoqatën e Shkrimtarëve ‘’Fahri Fazliu’’ për kontributin e dhënë në fushën e kulturës’’viti 2011. Autori Bedri (Avdullau) Neziri ka lindur më 27 prill 1962 në fshatin Bunjak të Skënderajt. Arsimin fillor e të mesëm e kryen në Kastriot. Diplomahet në universitetin e Prishtinës dega Gjuhë – letërsi shqipe. Në fushën krijuese letrare ka marrë edhe çmime të parë e të tretë në poezi e prozë.Ka botuar monografi”Kohë e ndaluar’’ (2001),’’Shtegtimet e Arbërit’’poezi(2008) ‘’Lulëkuqet e Kastriotit’’,monografi(2012), ‘’Dritat e shkëlqimit poetik’’, kritikë letrare(2012). Ky autor ka edhe shumë dorëshkrime të zhanerve letre për t’i botuar në të ardhmen. Ai përveç kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve ‘’Fahri Fazliu’’ në Kastriot është edhe antar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

Durrës më 30 Maj 2013.

Reportazh

Kuvendim me diellin e vendlindjes Shqipëri..!

Fotopamje nga plazhi i qytetit të Durrësit(Xh.Cirongu) Korrik 2013.

Janë të shumtë e bashkëatdhetarët tanë që vinë në vendlindje e tyre në këto ditë të pikut të nxehtë korriku për të kaluar pushimet në atdheun që i lindi e u dha fjalën e ëmbël shqipe. Ata janë larguar për shkaqe nga më të ndryshme drejt vendeve të tjera për të gjetur ndoshta një punë e për të bërë një jetë disi edhe më të mirë. Kudo që ndodhen bashkëatdhetarët tanë nëpër botë, janë integruar plotësisht me ligjet e shoqërinë aty ku ata jetojnë e punojnë. Të integrohesh diku në vendet e tjera sipas ligjeve , zakoneve gjer te gjuha, është disi e vështirë, e jo më të punosh e të japësh kontribute për vete dhe mbarë shoqërinë në tërësinë e sajë. Shqiptarët kanë ditur t'u japin zgjidhje problemeve integruese kudo që kanë shkuar në vendet e ndryshme të botës, e si rrjedhim të iniciativës e intelektit të tyre, janë rreshtuar si njerëz me intelekt e janë bërë shembull vlerësues me kontributet e tyre që kanë dhënë e japin në dobi të mbarë shoqërisë. Por, ata s'harrojnë edhe vendlindjen e tyre Shqipëri!
Këtë ftesë shpirtërore ua trensmetojnë edhe fëmijëve pavarsisht se kanë lindur nëpër shtetet e tjera të kontinenteve. Gjuhën shqipe kanë mjaltin e fjalës, pastaj janë integruar me gjuhët e tjera, gjer te zakonet e popujve ku ata jetojnë e punojnë. E kjo është e dukshme dhe e prakshme kur i dëgjon fëmijët e tyre të moshave të ndryshme që flasin rrjedhshëm gjuhën e bukur shqipe. Kjo na bën më krenarë e më të civilizuar, sepse gjuha e nënës ka forcë për t'i bërë ballë rrebesheve të jetës. Këto bizeda të ngrohta me rrënjë fjale shqipe na ngacmun edhe ne si gazetar që të shkruanim këtë reportazh nga brigjet e bukura të bregdetit Adriatik. Janë të shumtë shqiptarët që kanë ardhur nga gjithë shtetet e kontinenteve për të kaluar pushimet

verore pranë atdheut tonë Shqipëri. Rrezet e diellit mesdhetar që flakërojnë mbi brigjet e detit Adriatik e Jon të shqipes sonë, janë ulur këmbëkryq këto ditë s'bashku me qindra e mijra pushues vendas e të huaj në rërën e nxehtë e flladin plotë jod pranë brigjeve që të japin freski me ujërat e pastra e të kaltra. Ndodhemi pranë bregut të detit adriatik në gjirin gjysëm hënë pranë qytetit sa të lashtë e me kulturë të Durrësit. Kudo në këto ditë korriku, brigjet tona gumzhijnë nga njerëz të grupmoshave të ndryshme, e aty gjen freski e gjallëri që të ripërtërin forcat, e së bashku me diellin të bashkangjitet ngrohtësia shpirtërore, sepse flitet e këndohet gjuha jonë shqipe, kjo gjuhë sa e lashtë e zbritur nga vetë zoti! Ndoshta kjo na jep forcën që shqiptarët të integrohen kudo nëpër botë edhe me gjuhët e zakonet e kombeve të tjera. Trinomi: gjuhë,atdhe,komb, është sinonimi më i kërkuar i bisedave që dëgjon ngado midis atyre që jetojnë në Shqipëri apo shqiptarëve që jetojnë e punojnë në shtetet e tjera prej vitesh të largëta apo të afërta. Eshtë dashuria e dlirë që buron nga shpirti nga se cili shqiptar për atdheun tonë që ai të bëhet sa më i bukur edhe i zhvilluar ekonomikisht, politikisht e me shoqëri të përparuar demikratikisht.

Udhëtojmë drejtë bregut të plazhit të Durrësit.Takimin e parë sigurisht e bëjmë me një plazhiztë, banor të lagjes 14 Shkozet. Ishte një rastësi ky takim me Asllan Ibron, një këngëtar i vjetër të këngës popullore.Aty buzë detit shëtitë me nipin katër vjeçar. Kur e pyet se si e quajnë nipin e vetë të përgjigjet plot krenari:Arbër, - e ka emrin, na thotë e zemra i gufon nga gëzimi. Aty në valët e detit i bëjmë edhe një foto së bashku me të ftuarit e ''Dasmës'' diellore në ujët e kripur të detit adriatik. Asllani është me origjinë nga Vëndersha e Skraparit,por banon prej vitesh në Durrës.

…Një vogëiush duke ndërtuar kala me rërën e lagur…!

Plazhistët e ardhur në këto ditë korriku, që çdo ditë shtohen edhe më shumë''puthin'' bregun e rërës të pastër e vallëzojnë me valët e ujrave detare. Naim Kolgecaj ka ardhur nga Zvicra me gjithë familjen në Shqipëri për të kaluar pushimet verore pranë plazhit të Durrësit.Një familje intelektuale me origjinë nga Suhareka(fshati Vraniç). Ai ka plot 24 vite që jeton e punon në Zvicër. -Kam ardhur këtu, na thotë ai, me gjithë gruan Fatime, djalin Rinor e vajzën Eliza. Dielli i vendlindjes sonë Shqipëri të kuron edhe shpirtin, shprehet Fatimje e puthë fëmijët që flasin shqipe të rrjedhshme, pavarsisht se kanë lindur në Zvicër. …Më tutje, ku nën çadrën diellore dëgjon zëra fëmijësh të sapo dalë nga freskia e detit, takojmë një tjetër familje të ardhur nga qyteti i Pejës. Afërdita Gashi ndihet e entuziazmuar për rrugën e Kombit që ka afruar edhe më shumë Kosovën me Shqipërinë, me brigjet e mbrkulluashme të bregdetit tonë. Ky është i katërti vit që pushoj në Durrës, - na thotë Afërdita. Unë kam ardhur me vajzën që e ka emrin Tuana. Ato atje janë mbesat Enxhelina, Verona.Kurse këta që sapo dolën nga deti janë nipat Edoni, Egzoni,Adriatiku, Deoli.Këto që u thashë me emra janë të motrave të mija: Të Mimozës, Netja,Qëndresa. Më tutje na përshëndeti edhe Nazmiu, dhëndri i kësaj familje sa të madhe aq edhe fisnike.-Ndihemi të kënaqur, na thotë Nazmiu për mikpritjen e qytetarëve Durrësakë, por dhe të bizneseve që operojnë në plazhin e Durrësit.Nga Klina e Kosovës të rrafshit të Dukagjinit për pushime verore është edhe familja e Haxh Krasniqit, që ka ardhur me gruan e dy fëmijët: Blendin e Loresta përkatsisht 5-6 vjetë.

Pamje buzë bregut plot rërë të pastër në plazhin e Durrësit.

...atë e bir të kapur dorë për dore, dy zemra në një zemër Shqipëri!

Rrugëtim jonë për gjatë vijës bregdetare nëpër rërën e nxehtë, e flladi i lehtë që vjen i fresktë nga deti,na shoqëron deri në hotel ‘’Iliria’’,ku aty gjen një tjetër komoditet për gjithë pushuesit e ardhur në këto ditë vere korriku. Liridon Zeqiri ka ardhur me gjthë familjen e vajzën dy vjeçare me emrin Bulza. - Eshtë e njëmbëdhjeta herë që vimë për pushime në bregdetin Durrësak, -na thotë ai. Me brigjet e detit tonë, me diellin e rërën si ndërroj me asnjë në botë!

… **Nga Çikago drejt Durrësit e Ohrit**

‘’Nuk të pengon largësia gjeografike, afër apo lerg qofsh, kur në zemër ke atdheun nga ku ke lindur, ku fjala ka rrënjët e fjalës të nënës, kur dheu e gurët, ujët e burimeve, dielli i atdhut tënd të ngroh trupin e shpirtin’’. Janë këti fjalë zemra të dala nga goja e shqiptaroamerikanit nga qyteti i Ohrit, që i cili ka ardhur për pushime në brigjet e detit Adriatik së bashku me gruan Mukades. Takimi me familjen Sulejmani me origjinë nga Ohri,një familje intelektuale, ka plot 27 vite që jeton e punon në Çikago SHBA.

Bisedon me ta sikur je njohur prej vitesh. Të ftojnë për një kafe aty nën çadrën diellore. Të çiltër në shpirtë,saqë kjo dukej në bisedë ku malli për të folur shqipen dukej sikur nuk do mbaronte kurrë. Sa më shumë bisedonim me ta, aq më shumë zbuloje gjatë rrëfimit udhëtimin e jetës së tyre bashkëfamiljare për mbarëvajtjen e sukseset e gjithëpërfshirjes të kësaj familje me plot tallaze jete.Një udhëtim i gjatë gjeografikisht, por vendlindja ta lehtëson lodhjen, të ripërtëritë forcat,- na thotë Avni Sulejmani. Ky është viti i katërtë që pushimet verore i bëjmë në Durrës. Ndryeshe nga vitet e tjera për mua është një verë e veçantë, sepse do shkoj në Ohr, e paskësaj në Strugë. Aty kam dasëm,martoj nipin Burim Oda e ka emrin.

-Të trashëgohet, i them unë, duke vazhduar bizedën për të mësuar rreth fëmijëve të tyre. Pse më pyet kaq shumë,- një mëhallë me fëmijë kam: Katër vajza e një djalë!

-Të kenë jetë së bashku me ju,-i them unë. Më falnderuan burrë e grua. Pastaj i pyeta për emrat e fëmijëve.Vajzat i quanin Atixhe,Shqipe,Qamile, Gonxhe, Lirodona. Kurse djali Besim. Emra që secili ka një symbol të tijën. Sa bukur , thashë me vete! Që të gjithë të rritur e me arsim, të integruar në shoqërinë më demokratike në botë atje në SHBA. Atixheja ka mbaruar universitetin ‘’Depaul’’ biznes- marketing; po kështu Shqipja universitetin ‘’Ankoneli’’, Qamilja

gjuhën Spanjishte, në unversitetin Çikago jep mësim Spanjisht ….e kështu me radhë na rrëfen copza jete frutdhënse nga përtej oqeanit Atlantik.

..Një foto familjare në Çikago. Hare dasme!

- Sa fëmijë ke martuar, e pyes unë pas familjarizimit gjatë bisedës Avniun e Mukadesin?

-Na zure ngusht,po të dëftejmë: Shqipen e kam martuar me një djalë nga Tropoja. E quajnë Ardian.Qamilen martuar me Hamzain, djalë me orgjinë nga Gostivari. Që të dy jetojnë në Amerikë.- Meqënse kini shumë vite në Amerikë, atje në familjen tuaj më shumë flitet anglisht apo shqip!?

- Jo, bre burrë, në familje e komunitetin tonë shqiptaroamerikan flasim e këndijmë shqip, sa edhe dasmat i bëjmë sipas zakoneve e traditës sonë shqiptare.Kurse në ambjentet zyrtare sigurisht që flasim anglisht.Shqipen e mbajmë të gjallë , pa atë kudo që të jeshë, s'ke jetë e gëzim në shpirt,- na thotë Avni e Mukades Sulejmani me orgjinë nga Ohri. Avniu shkruan edhe poezi që ia dedikon vendlindjes. Rrëfimet e Avni Sulejmanit startojnë te Ymer Elezi, babai i Mukadesë që takohet me të vëllanë Irfanin pas 53 vitesh që punonte në Ankara si emigrant.

- Ngado që të shkosh or bir,si dielli i vendlindjes s’mund të gjesh! Edhe ëndrrat i shikojmë në Shqipërinë tonë, pavarësisht se atdheu i dytë për ne është Amerika.

Foto nga Xhevahir Cirongu. Durrës, korrik 2013

Avni e Mukades Sulejmani vështronin flamurin kuq e zi që falvitej diku aty afër në një pikë dominuese e lotonin se të nesrmen do shkonin në qytetin e lindje në Ohrin kaltërosh mes maleve. Aty përballë kemi Pogradecin, sigurisht do bisedijmë edhe me vargun e poetit Lasgush.

Largohemi nga ky bashkëbisedim i ngrohtë midis bashkëatdhetarëve duke marrë me vete thëniet e tyre :’’Do të jemi përsëri në brigjet e vendlindjes sonë, Shqipëri!’’.

Fund, Durrës, 18 Korrik 2013.

esse

Nga qielli pikonin diamantë lotdhimbje

(Kujtim me rastin e 23 vjetorit të dëshmorit të Atdheut Banush Cirongu, 10 gusht 1990- 10 gusht 2013)



Vitet treten bashkë me kohën e tyre. Pas ato lënë gjurmë, e në këtë rrugëtim të gjatë mbajnë thesare kujtimesh. Ato largohen diku në qiejtë e hapur e takohen me yjet e kujtesës. Krenaria e dhimbja bashkëbisedojnë me njëra-tjetrën. Ato trupëzohe midis tyre e sjellin kujtime që të japin forcën e shkëmbit të zjarrtë e të jepin mesazhe jete. Edhe në këtë përvjetor të vitit 23-të,të dëshmorit të Atdheut Banush Cirongu, na bën që të meditojmë e të sjellim me anën e memories sonë kujtime jetsore. Ato janë të shumta e s’mund të përshkruhen të gjitha në këtë ese historijete. Kujtoj vendlindjen time, ku ëndrrat flenë krojeve të fshatit e bashkë me bulza uji flladisen me erën e luleve të lëndinave. Një tufë lule të freskta, ashtu me hapin e heshtur e lë si kujtim te varrezat e fshatit. Vështroj fshatin e lindjes sime që është i mbuluar ngado me ‘’Jorganin’’ e gjelbër të pemëve, e sidomos me arrat e shumta shekullore. Shtëpitë karakteristike të ndërtuara me gurë të gëdhendur, janë vendosur sup më sup e që duken sikur mbajnë njëra-tjetrën në atë shpatë mali. Kodrat rrethuese e brezaret me gjithë farë pemësh frutore e vreshtari ia shtojnë edhe më shumë bukurinë fshatit tonë Leskovë. Njerëz me vyrtyte bujarie , mikpritës, të punës, të dijes e kulturës; por edhe me ndjenja të forta atdhedashurie.

Një fakt kokëfortë është se nga fshati Leskovë morën pjesë në LANÇ(1941-1944) në luftën e Dytë Botërore, 27 djemë për çlirimin e Shqipërisë nga okupatori nazifashistë . Veprimtaria patriotike e

atdhetare e Leskovasorëve nëpër shekuj është e madhe, saqë ata nuk kanë kursyer edhe gjakun e vetë për trojet shqiptare, por edhe për zhvillim e përparim shoqëror.Ishte patrioti e atdhetari Razim Shabani që mbeti i vrarë në mbrojtjen e kufijëve shtetrorë kundër shovinistëve grekë më 1914-1915. Fshati Leskovë i fali atdheut tre djem, tre yje tomorriane që do ndriçojnë në shekuj: Mediun,Pelivanin e Banushin. Por, ditari historik i kujtimeve këtë radhë starton pikërisht te kujtimet për dëshmorin e atdheut Banush Cirongu. Veprimtaria e këtij intelektuali e dëshmori është e gjerë. Ai ishte njeri fjalëpak, i komunikueshëm me njerëzit, i donte me gjithë shpirtë, sepse edhe ata e donin atë. Mendimi e fjala që dilte nga goja e Banushit, ishte se dinte ta thoshte të mirën e të keqen në kohën e vendin e duhur me buzëqeshje të ëmbël e të ngacmonte mendimin. Në vitin 1976 mbaron arsimin e mesëm pedagogjik në Fier. Psakëtej, vazhdon arsimin e lartë (Gjuhë-letërsi) në Universitetin ''Aleksandër Xhuvani'' Elbasan. Kështu , me mbarimin e universitetit në vitin 1980, emërohet mësues në shkollën 8- vjeçare në fshatin Grevë. Aty punoi disa vite. Më von deri në vitin 1990 dha mësim në shkollën e mesme ''Pelivan Dorrozhani'' në fshatin Zhepë. …Por,…!

Një ditë më merr në telefon nga Drejtoria e Shkollës e më thotë:

- Hë, more xhevo, do e ngrejmë grupin teatral të fshatit?! Në këtë kohë punoja në posttelegraf, por bashkëpunoja edhe si punonjës i jashtëm me Shtëpinë e Kulturës.

-Të mendohem, more Bano!,- i them unë nga ana tjetër e telefonit.

-S'kemi pse të mendohemi! Të fillojmë sa më parë nga puna përgatitore. Eja, të pres në Drejtorinë e Shkollës, më tha ai e mbylli receptorin e telefonit. Pas pune shkova atje e biseduam gjatë. Te Banushi gjeta kurajon e giximin e një intelektuali të formuar profesionalisht, por edhe kurajos për të bërë diçka të dobishme për njerëzit e kulturën. Ai drejtonte edhe rrethet letrare të talenteve të reja me nxënsit e shkollës. Më së fundi i thashë:

-Edhe unë e mbështes këtë inisiativë.

Në fshatin Leskovë ishin shumë djam e vajza që kishin mbaruar arsimin e mesëm, por edhe të lartën sipas prifesioneve të të gjithave llojeve.Të tjerët vazhdonin studimet. Kështu në muajt e verës kur ishin pushimet, grupi i punës me në krye Banush Cirongu, nisën punën përgatitore për teatrin. Shumë shpejt u dha shfaqja teatrale para publikut artdashës në fshatin Leskovë e në Zhepë. Kjo shfaqe teatrale u mirëprit me duartrokitje të zjarrta nga publiku. Falnderimet nuk rreshtinin nga të gjithë grupmoshat, puntorë,nxënës,intelektualë, pensionistë etj.

Në rolin kryesor ishte vetë Banushi që luante në skenë.

Më kujtohen organizatorët e interpretuesit e skenës me aq fines si: Astrit Shatro, Xhevat Cirongu,Shega Dorrazhani,Gjylestane Seferasi, Sherina Cirongu, Hetem Shabani,Hajdar Cirongu,Pëllumb Gjata,Luan Shatro,Xhevahir Cirongu, Dareko Shabani,Sajmir Shatro,(*këta emra po shkruaj,kërkoj ndjesë për ata persona që s'më kujtohen*). Në një mbasdite,Shqipja mbaron mësimdhënien me nxënsit e fshatit e më takon në shtëpinë e kulturës. Mendova se mos donte ndonjë punim për kabinetin e shkollës apo për klasat e veta ku jepte mësim. Isha në valën e punës sime, prandaj më kërkoj falaje për shqetësimin.

-S'ka gjë , të lutem,- i ktheva përgjigje. Me se t'u ndihmoj?

-Jo,jo,por…të kërkon Banushi. Po munde, kur të kthehesh nga puna, dil nga shtëpia jonë e bisedo me atë personalisht.Sakaq u largua e unë vazhdova të punoja . Kështu, pas pune në mbrëmje takova mësuesit Banush e Shqipe Cirongu .

Shpesh bisedonim për letërsinë dhe artin,por atë mbrëmje të datës 21 Prill të vitit 1984 ai më uroj për tekstin e këngës që unë kisha bërë për fëmijë, ku ajo këngë të kompozuar nga Hajri Xhamëni kishte marrë çmim të parë në Festivalin Kombëtar për Fëmijë të organizuar në qytetin e Shkodrës.Ai këtë lajm e kishte dëgjuar në radio. Nesër do e shikojmë në televizor, eja prap në mbrëmje. Unë ndjeva gëzim në këto çaste, por më shumë e ndjente mësues Banushi, sikur ta kishte shkruar ai e jo unë!

-Na shtro darkën, sepse kemi festë, se kjo këngë i kushtohet fëmijëve,- dhe shikimin e treti te vajza Eneida që buzëqeshte ëmbël. E puthi,pastaj i tha:''Emrin ta regjiistroi xhaxhi xhevo në gjendje civile! !''. Me gotën e rakisë në dorë, uruam njër-tjetrin për sukseset në fushën e letërsisë e të kulturës.

Të udhëtosh nëpër shtigjet e jetës nuk është edhe aq e lehtë. Ajo ka në vetëvete të fshetat e saj që s'ti tregon të gjitha në këtë rrugëtim me udhëkryqe ku gjenden semaforë me drita që ndizen e shuhen. Ishte pikërisht data 9 gusht e vitit 1990 kur në Shqipëri po ndodhnin transformime të mëdha politke,ekonomike e shoqërore. Këto trensformime i mirëpriti edhe Banushi. Në mënyrë tragjike në një repart ushtarak, nga një dorë ogurzezë midis të tjerëve i merr jetën padrejtsisht dy civilëve e një ushtarku.. Një plumb i mallkuar e plagos atë rendë në krahëror . Me gjithë ndihmën e dhënë në maksimum,pas tridhjetë minutash ai humb jetën. Fjalët e fundit ishin''Më jepni ndihmë! A po vjen helikopteri!Po shokët ku janë? E në vdeksha,gjakun ia kam falur Atdheut!''.

Ky lajm i kobshëm, i rrallë për atë kohë në Shqipëri u dha telegrafisht.

-Eja të shikojmë të plagosurit në qëndrën shëndetsore,- më thotë me gjysëm zëri Bilbil Saliasi. Shkuam aty,por gjithë ajo turmë e madhe njerëzish që ishin jashtë qëndrës shëndetsore qëndronin në heshtje. Dy infermieret Hajrie Saliasi e Hajrie Dorrozhani qëndronin para partës kryesore e nuk lejonin njerëzit të hynin brenda objektit spitalor.Tronditja ishte e madhe, sa gjithë sa ishin aty dukeshin si të ngrirë. Dy infermieret na vështruan me dhimbje.Hapën rrugën e që të dy me Bilbilin hymë në dhomën e shtrimit. …Por,…gjithçka kishte marrë fund!

Këtë ngjarje e transementuan shtypi e Radotelevizori Shqiptar,ATSH,e gjithë stacionet e tjera të lajmeve nëpër botë.

Atë mbasdite të datës 9 gusht të vitit 1990-ës, vargu i lumit të njerëzve me trupin e mësues Banushit u nis drejtë fshatit Leskovë.

-Ç'janë gjithë këta njerëz që po afrohen drejtë shtëpisë sime,- pyeti Shqipja dhe shtangu për një çastë në mes të oborrit të shtëpisë.

-Pse heshtni!Më tregoni se çfarë ka ndodhur!? Asnjë nuk fliste. Në këtë kohë hyn brenda në shtëpi, merr dy vajzat e dy djemtë e del në ballkon.

-Pse heshtni o njerëz! ..Por,ndonjëherë edhe heshtja flet më shumë se sa fjala.

Ajo përgjigjen e fatkeqsisë e mori nga heshtja e madhe që mbanin në ato çaste lumi i madh i njerëzve që sa vinte e shtohesh edhe më shumë. Pastaj shtërngon fortë pas krahorit fëmijët e derdh lotin e dhimbjes mbi faqe. Një re e zezë del nga mali Tomorr e vesh qiellin e Tomorricës e të Skraparit. Jo vetëm njerëzit,por edhe natyra vajtoi atë ditë gushti të vitit 1990 duke derdhur lotdhimbje diamanti.

Shqipja qëndroi e fortë si shqiponjë mali me obligimin për të rritur ,arsimuar e edukuar fëmijët,ata pëllumba që do e ndjenin më von mungesën e babait të tyre.

Njeriu që lë gjurmë mirësie pas, s'ka vdekje, por lindje e kujtime që do kujtohet gjithmonë në breza. Prandaj,edhe ne e kujtojmë me krenari në këtë përvjetor Dëshmorin e Atdheut Banush Cirongu.

Gusht,2013.

Kush vdes për atdheun, s'ka vdekje kurrë!

Major Bexhet Shatro (1928-1959)

(Me rastin e 54 vjetorit të rënjes në krye të detyrës,Major Bexhet Shatro(Leskova), shtator 1959- shtator 2013)

Ndoshta jam disi i vonuar për të shkruar këtë shkrim për një tjetër djalë aq të përkushtuar ndaj atdheut e shoqërisë,njeriu që sakrifikoi edhe me jetën e tij siç ishte dhe mbetet i pavdekshëm si gurët e vendlindjes; ish Major Bexhet Shatro. Ai lindi në vitin 1928,fshati Leskovë të rrethit Skrapar(Zona Tomorricë).Familja e tij shquhet në breza për patriotizëm e atdhedashuri. Ky ushqim shpirtëror me dashurinë për vendlindjen e atdheun Shqipëri,kur dëgjonte nga të moshuarit që bisedonin për fatet e atdheut, që trupi i tij ishte bërë copa-copa nga shtetet shoviniste ballkanase,me kureshtje e në heshtje fliste me vehten shpesh se një ditë do të bëhej edhe ai një ushtarak i zoti që t'i dilte zot atdheut të tij.

Këto biseda ai i dëgjonte rreth vatrës ku ndizej zjarri e merrte udhën e saj fjala aq e ngrohtë që flitej për atdheun, për lirinë, që padrejtësisht të huajt nëpër shekuj na i kishin cënuar shumë rëndë,saqë edhe na kanë djegur shtëpitë tona,plaçkitur, masakruar e deri aty sa edhe na kanë vrarë në tokën tonë. Midis fshatit Leskovë e Zhepë ka qënë vija e frontit të luftimeve të luftës italogreke 1939-1941.Masakrat që bënë në atë kohë ushtria greke e italiane ndaj popullatës shqiptare dihen nga të gjithë. Ngjarjet janë të freskta edhe sot e kësaj dite, dhe historia ka shkruar për këto masakra makabre ndaj shqiptarëve, deri aty sa edhe grave shtatzëna u është çarë barku me bajonetë e u kanë nxjerrë fëmijën nga barku për së gjalli. Këto biseda me ngjarje të dhimbshme nëpër vite të treguar nga të moshuarit, por dhe ato aktuale që Bexheti i kishte jetuar vetë, ia shtonin më shumë dashurinë për atdheun, por edhe urrejtjen ndaj pushtuesit.

Kur zhvilloheshin këto luftime të ashpra në jug të Shqipërisë,Bexheti sapo kishte mbushur 12 vjet. Ai ishte ende i mitur,por pjekurinë mendore e kishte të madhe,saqë një ditë i ati i thotë si me shaka:'' Dëgjo,biri im! Je i vogël në moshë, por mos e vrit shumë mendjen për punëra të mëdha! Nesër kur të rritesh do të kesh kohë të mendohesh e punosh për vete , shoqërinë e atdheun!''

Ai e dëgjoi me vëmendje të atin, i buzëqeshi ëmbël dhe pa bërë fjalë iu hodh në krahë dhe e përqafoi fortë atë. Bexheti fliste me heshtjen, dhe mendonte për të nesrmen. Pastaj ,duke u larguar për te pragu i portës, që aty ishte ulur e ëma, që e cila po ndiqte këtë bisedë intime midis tyre, i tha të atit se koha nuk pretë, unë e ndiej veten në radhët e burrave! Kur u afrua për te sofati,shikimin e treti atje te ajo shqiponjë e cila ishte skalitur në gurin e qemerit të portës që ishte vendosur sipër saj. Shqiponjën e skalitur në gur e gjen në çdo portë shtëpie,kjo karakteristike për familjet Leskovasore. Bexheti takonte e bisedonte shpesh me Myslim Cirongu e Myle Shatron për ngjarjen madhore të atdheut tonë : Shpalljen e Pavarsisë dhe qeverinë e Vlorës me në krye Ismail Qemali të vitit 1912. Myslimi e Mylja ishin pjesëmarrës okularë dhe mbrojtës të qeverisë,sepse Ismail Qemali përfaqsonte

popullin e Tomorricës.Në aktin madhor për shpalljen e pavarsisë Ismail Qemali firmosi si delegat e përfaqsues i popullit tomorricar.
-‘’Mirë, t’u bëftë nëna, eja e të puthë në ballë.Të më qëndrosh kryelart si mali i fshatit! Ajo nënë fisnike hodhi sytë drejt malit Leskovë,Qafës së Gurit të Prerë, Qafës së Gjarprit, aty ku janë zhvilluar me dhjetra luftime kundër pushtuesve, atje ku kanë kaluar me dhjetra e qindra djem e vajza drejt emigrimit!…’’

Syt i lotuanë atë ditë asaj nëne, por brenda shpirtit kishte krenarinë se djali ishte bërë burrë për t’i dalë zot vatanit.Përtej në perndim, mali i Tomorrit kish hedhur krahët gjithë zonës së Tomorricës duke mbajtur nën sqetulla fshatrat e njerëzit me bekimin e tij për te ZOTI!

-Sa këngë janë kënduar për trimërinë e mërgimin në këto vise!? Ato janë shumë e këndohen edhe sot e kësaj dite.Që nga lashtësia e deri sot, me zërin e tij aq të ëmbël na i sjell të freskta këngëtari i këngës folklorike intelektuali e mësuesi i fshatit Leskovë Pëllumb Gjata.Artisti i Popullit , Demir Zyko me këngën perlë të flokut shqiptar’’Mbeç’ mor shokë mbeç’/Përtej urës të Qabesë/…’’etj.
Ato tingëllojnë bukur edhe sot në ditët tona.

Vitet kalonin e Bexheti hidhte shtatin e tij edhe më shumë.Lufta për çlirimin e Shqipërisë nga okupatori nazifashist qe ndezur ngado. Kudo luftohej dhëmb për dhëmb me pushtuesin. Kështu, me armë në dorë Bexheti del partizan duke u rreshtuar në Brigadën e 16 Sulmuese që u krijua në Therepel të Skraparit në muajin gusht të vitit 1944. Skrapari qe çliruar nga okupatori qysh më 5 shtator i vitit 1942.Në periudhën maj- qërshor 1944-ës, në fshatrat e Skraparit filloi një luftë tjetër edhe më e ashpër kundër analfabetizmit.
Në kushte shumë të vështira u ngritën kurse shkollash në fshatrat Zaloshnje, Koprënckë,Staraveckë,Grevë,Leskovë, Gurrazes, Therepel, Vëndreshë etj.

Edhe Bexheti mori pjesë intesivisht në këto kurse për të mësuar shkrim e këndim.
Në këtë kohë sapo kishte mbushur 16 vjet, dhe tashmë ai përveç armës kur doli partizan pë çlirimin e vendit, u armatos edhe me armën e dijes. Kjo e lumturoi edhe më shumë djaloshin nga Leskova. Kurajon e guximin ia shtonin edhe më shumë luftëtarët e tjerë që ishin të shumtë nga fshati Leskovë, e sidomos bashkëluftëtarët Veiz Shatro, Zane Shatro, Dalip Shatro (xhaxhai i Bexhetit) për të qëndruar deri në fund me LANÇ në çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Pas çlirimit Bexheti vazhdoi shkollën e Bashkuar të Oficerëve (dy vjeçare) degën e Artilerisë në Tiranë. Mbas mbarimit të shkollës si arilier, ku u shqua për një përgatitje profesionale me rezultate të larta,emërohet me punë në Shkodër e Milot deri në vitin 1956. Në këtë kohë edhe u martua me një vajzë nga fshati Mëlovë të Tomorricës, që quhej Gurie Kullsi. Kështu me gjithë familje ai shërbeu për disa vite si artilier në këto dy qytete veriore të Shqipërisë.Në vitin 1956, në Milot lindin fëmijën e parë, vajzën Lumturi. Kjo i gëzoi pa masë bashkëshortët

Bexhet e Gurie Shatro. Mirëpo, më pas trasferohet për në qytetin e Kavajës, ngaqë repartet e artilerisë ishin në lëvizje. Aty emërohet Komandant i Kompanisë së Artilerisë dhe merr gradën Major.Për një kohë të shkurtër e trasferojë në Përmet dhe aty lindin fëmijën e dytë, djalin Astrit.Ishte viti 1958, dhe përsëri rikthehet në qytetin e Kavajës.

Ishte muaji shtator i vitit 1959. Në Seman të Fierit zhvillohej një stërvitje-lojë ushtarak. Aty merr pjesë edhe Major Bexheti.Stërvitja ushtarake zhvillohej natën në një terren të vështirë.Ai komandonte forcat e artilerisë. Në terrin e natës, aksidentalisht një tanks luftarak i merr jetën në moshën 31 vjeçare oficerit Major Bexhetit. Kjo ngjarje e pazakontë qe një humbje e madhe jo vetëm për ushtrinë,por edhe për Gurien, sepse ai la dy fëmijët e mitur jetim. E gjithë barra për rritjen, arsimimin edhe edukimin e fëmijëve do ta përballonte vetë Guria. Në këto kushte të krijuara, plot dhimbje në shpirt, ajo me dy fëmijët kthehet në fshatin e lindjes së bashkëshortit, ndonse ishte e re në moshë.Me sakrifica të shumta, me guximin e një nëne luaneshë, ajo rriti, arsimoi e edukoi dy fëmijët, Lumturinë e Astritin.

Mbas mbarimit të gjimnazit ‘’Ramiz Aranitasi’’ në Çorovodë, viti 1978;Astriti vazhdon Fakultetin e Shkencave të Natyrës(dega fizikë) në Universitetin e Tiranës. Kështu, me mbarimin e universitetit ai punon në arsim, por edhe si drejtues në disa dikastere shtetrore. Sot punon petagog në Tiranë.

Për këto arritje, Guria krenohet që fëmijët përmbushën një nga amanetet e të atit: arsimimin e edukimin për t’i shërbyerë shoqërisë e atdheut.

Një bashkëkohës i ngjarjes tragjike të familjes Shatro, Zylyftar Kullsi që i cili banon prej 45 vitesh në Durrës, tregon: ‘’- Unë e kam njohur personalisht oficer Major Bexhetin në vitin 1958 në qytetin e Kavajës.Aty kryeja kursin e nënoficerit.Bexheti ishte një njeri shëmbullor,guximtar por edhe i dashur me kolegët e ushtarët.Atë ditë fatkeqësie jo vetë kolegët, por të gjithë njerëzit në Kavajë, gurët e qielli derdhën lotdhimbje për djalin nga fshati Leskovë,31 vjeçarin oficerin major Bexhet Shatro!’’. Shtator 1959,-shtator 2013!

Kanë kaluar plotë 54 vite kur dha jetën në krye të detyrës ushtaraku me gradën Major oficeri trim Bexhet Shatro, njeriu që me përkushtim e dashuri i shërbeu deri në fund të jetës së tij atdheut. Ka ardhur koha që organet përkatëse shtetërore të Prefekturës së Qarkut Berat, të nënprefekturës Skrapar, por edhe pushtet qëndror, të bëjnë vlerësime edhe ndaj këtij ushtaraku që ka dhënë kontribute si në LANÇ dhe në forcimin ushtrisë shqiptare në mbrojtje të atdheut.

Durrës, 31 gusht 2013.

Gurë stralli shqipëria, mbirë në buzë te ty liria!

(Shënime nga ditari ,sipas kujtimeve të vëllait të dëshmorit, Shasho Dorozhani (sot edhe ky nuk jeton) , intervista është bërë më 5 maj 1986 në Leskovë, dita e dëshmorëve të Atdheut)

...Këto janë vargjet e këngës me të cilën e pritën atë ditë tetori të vitit 1951 bashkëfshatarët, djalin e tyre 25 vjeçar Pelivan Dorrazhani. Ai ra në krye të detyrës për të mos vdekur kurrë! E donte aq shumë atdheun, lirinë, derisa e ujiti me gjakun e tij. U rrit mes halleve e skamjes familjare, por nuk e ligështuan asnjë herë ato. Përkundrazi e burrëruan dhe fisnikëruan më shumë,aq sa i dhanë flatrat e shqiponjës.

Nënë Zelikua, megjithëse kishte punët e shtëpisë , ajo vuante edhe nga një sëmundje e rëndë që se linte të ngrihnte kokën lartë. Megjithëse lëngonte në shtrat, herë pas here s'rrinte pa i dhënë ndonjë këshillë të të birit. -E shikon atë nagant që është varur në mur?! Atë e rrëmbeu yt atë në luftën kundër shovinistëve grekë më 1914-ën! Pelivani e shikoi me kureshtje nagantin, por ai ende ishte i vogël dhe diçka bluante me veten. ..Pastaj, ashtu siç dinë të përkëdhelin nënat, i mbështet kokën në gjoksin e saj. Pelivani ishte ende i parritur , kështu s'mund ta kuptonte dot fjalën e nënës, por në këto çaste

dialogu e përkedheli me ato duar të ashpra të nënës, por të ngrohta, diçka ai ndjente brenda shpirtit të tij. Lindi më 7 prill të vitit 1925 në fshatin Leskovë.Shtypja e regjimeve antipopullore, ashtu si gjithë popullin tonë, skamja e varfëronte edhe më shumë jetën e Leskovasorëve.Qysh në moshën fëminore, Pelivani iu kushtua punëve familjare dhe u angazhua me hallet e gjithë familjes, që e detyruan të merrte kërrabën e të ruante bagëtitë. Vitet iknin njëri pas tjetrit. Çdo ditë e këtyre ditëve mbanin mbi vete veç errësirën… Sa herë që dilte me tufën e bagëtive në majën e shkëmbit Popolak apo te bregu i Ogradës në fund të fshatit,melodia e fyellit bashkohesh me oshëtimën e ujrave të përroit Raven e Selgjin që zbresin nga mali i fshatit, e derdhen atje në lumin e tomorricës.Një ditë, kur Pelivani u kthye me gjithë bagëtitë në mbrëmje te shtëpia, i ati, Refati i jep si dhuratë një kërabë. Ajo ishte e gëdhendur me një mjeshtëri të rrallë. Sa u gëzua Pelivani!?... -Baba,- i u drejtua mes gëzimit që dukësh në sy,- tani u bëra burrë, po…Refati e kuptoi të birin se ç'farë do të thoshte. Ndaj nuk zgjati më bisedën. Në kërrabë ishte gëdhendur një flamur e një shqiponjë për të cilën Refati i fliste shpesh të birit. Një ditë ndodhej në Leskovë një batalion i brigadës parë sulmuese. Kishte dëgjuar për partizanët që luftonin me aq guxim e trimëri. Ndaj i u rrit edhe më shumë gëzimi kur takoi vetë ata që ishin ndarë nëpër baza. ''Edhe unë s'mund të rri në shtëpi. Dua të shkoj me ta në mal partizan,- i thoshte vetes''. Të nesërmen, pa u gëdhirë mirë, batalioni u nis për rrugë. Pas i ndoqi edhe Pelivani. E pa një partizan e i tha me të qeshur:
More, çapaçul, po ti ku shkon kështu,apo je ftuar në ndonjë dasëm?
Edhe unë do të bëhem partizan si ju, - i tha disi i turpëruar Pelivani.
Mirë xhanëm,mirë ke menduar, dhe ngriti zërin për të dëgjuar partizanët e tjerë.
Pa armë s'vihet në luftë dhe ende je i vogël!...
Mos ma qaj hallin për të vogël, se edhe armën kam se ku e gjej, - ja ktheu përgjigjen partizanit. Me një copë letër të shkruar që ja dha komosari u kthye në fshat. Kjo dëshirë e madhe e tij , i u plotësua më 20 shtator të vitit 1943.; ku në Leskovë kaloi batalioni i rinisë ''Margarita Tutulani'', dhe në tetor 1944 inkuadrohet në brigadën e 10-të sulmuese. Nënë Zelikua nuk e pa të birin me armë të hedhur supit apo me yllin e kuq në ballë, sepse ajo s'jetonte më, por diti të edukonte djalin e saj me ndjenjën e patriotit e luftëtarit deri sa u bë një partizan e oficer i zoti për ti shërbyer atdheut. Agimi i 29 nëntorit të vitit 1944-së erdhi më i bardhë se ditët e tjera.Shqipëria u çlirua. Ishte fillimi i vitit 1945, Pelivani kaloi me forcat e mbrojtjes së popullit. U ra kryq e tërthor Korçës, Leskovikut, Devoll e Mokër, Kolonjë e Gorë- Oparit Lushnje, Maqellarë, Përmet në mbrojtje të pushtetit popullor.Në vjeshtën e po atij viti u diktua një bandë e rrëzikshme që qarkullonte në zonën Gramsh- Elbasan. Një kompani që komandohej nga oficer Pelivani çante errësirën e natës në thellësi të pyllit. Aty ndodhej banda e H. Matjanit ku forcat e ndjekjes u vunë ballë për ballë.
-Kujdes shokë, mos lëvizni nga pozicionet, u dëgjua zëri i Pelivanit. Pozicioni ku ishte oficer Pelivani ndodhej në një vend nga ku mund të shikoje mirë strofkën e diversantëve nëpër mjet flakëve të automatikëve, sepse ishte shumë afër.Deri në mesnatë vazhduan luftimet. Me çdo kusht ata kërkonin largimin. Tek-tuk dëgjohej ndonjë e shtënë. Drejt strofkës së armikut Pelivani hedh dy granata dhe flakët llapsin gjithandej. Merr në shenjë drejt tyre,por… Bën më tej.Shkelësit kanë lënë fortifikatën e tyre. Pa pritur në qiell lëshohet një fishekzjarr i kuq.Kërkojnë ndihmë nga jashtë, thoshte me vete Pelivani. Megjithatë, shkelësit mund të gjenin shteg në errësirën e natës dhe u larguan. Oficer Pelivani njërin krah e kishte të mpihtë. Kur ju afruan shokët, panë se ishte plagosur.
Tetor, 1951. Në Shpal të Mirditës me një skuadër, Pelivani përsëri në përleshje me difersantët të cilët do të kalonin maleve të verilindjes. Fytyrën e kishte të nxirë vënde-vënde nga tymi i barutit. Pa pritur poshtë në përrua, në të majtë të krahut u dëgjuan disa të shtëna breshëri automatiku. Me sa dukej shkelsit e kishin kuptuar se ishin të rrethuar, ndaj po qëllonin ndaj nesh. Nën breshërinë e predhave zumë pozicione. Që andej dukeshin pozicionet e shkelsëve. Skuadra e Pelivanit u nda më dysh. Njëra skuadër mori urdhër të mos lëviste nga pozicionet, dhe të mbulonte skuadrën tjetër me zjarr që po afrohej drejt shkelsave. ''Kujdes s'e predhat që përplasen në shkëmbenj, mund të bëjnë rikoshet,- i u thoshte shokëve që kishte në krah oficer Pelivani!''. Pasi hodhi dy granata drejt diversantëve,zbriti

poshtë në përrua dhe u morri krahët atyre. Zuri pozicion pas një lisi. Njëri nga shkelësit e diktoi dhe po e gjuante me breshëri plimbash, sepse qe afruar shumë pozicioneve ku ndodheshin ata. Edhe Pelivani u a kthente ashtu siç e kishte zakon. Në këtë kohë diversantët zunë të lëviznin drejt një reme mulliri. Banditët hodhën një bombë drejt pozicionit të Pelivanit duke e shoqëruar edhe me breshëri automatiku. Një plumb i mallkuar e kishte marrë te krahu. U mbështet pas trungut të një lisi.-E dija që dote vinit, e do të më merrnit.Më kujtuat të vdekur, por si mund të vdes pa e zbrazur edhe një here,- u tha shokëve që i erdhën pranë. Fliste me mundim, por nga zëri i tij gurgullonte dashuria e dlirë për shokët, për jetën.Kishte marrë nëntë plagë nga ciflat e bombës.
Lisi shekullor që kishte pare sa e sa luftëra , rrënjët e tij këtë radhë po thithnin gjakun e djaloshit 25 vjeçar nga fshati Leskovë të skraparit. Sot eshtrat e Pelivanit prehen në varrezat e dëshmorëve të skraparit në qytetin e Çorovodës. Emrin e dëshmorit Pelivan Dorrozhani e mban edhe shkolla e fshatit Zhepë në tomorricë. E kujtojnë brezat. Ai është i gjallë edhe në këngët e popullit që u këndon trimave të tij. Ja si thotë kënga:

''Në mes të fshatit tonë
Janë katër selvi,
Pelivan djalosh i ri
Lule-lule o dëshmorë…
I mallkuar plumbi të mori
Mes për mes te krahori,
Gurë stralli shqipëria
Mbirë në buzë te ty liria.

Nëntor,2013

Reportazh

Atje ku jeta po çel si lule shkëmbi mes malesh Skraparase

Shtator 2014! Në qiellin vjeshtak retë e bardha kanë grisur aty –këtu kaltërsinë e tij. Ato duken si shtëllunga të bardha leshi që tirren lart në kupën e qiellit. Dielli flakëron në fshehtësi e të djag sikur të jetë pragvere.E megjithatë,vjeshta ka trokitur gjithandej. Njerëzit janë kudo në lëvizje . Ata i gjen në krye të punëve të stinës së vjeshtës. Me autobusin e linjës Durrës- Berat udhëtojmë drejt qytetit muzeal. Në orën 10 mbrijmë në terminalin e autobusëve në Berat. Me të vërtet atje ishte bërë një punë e mbrekullueshme. Të bije në sy rregulli e pastërtia,por edhe korrektësia në shërbimin urban. Te ura e Kuçit në autobus hipën një banor nga fshati Kuç. Ishte me gjithë bashkëshorten. Me mua në sedile u ul edhe ai fshatar që jetën e kishte lidhur pranë tokës. Bisedojmë me atë njeri puntor e aposionant që i cili kishte qënë për disa vite emigrant në greqi e itali. –E lash emigrimin na thotë ai,sepse më thëriste vendlindja ime Shqipëria. Në fshatin tim, Kuç, ndërtova shtëpinë e re,por mbolla edhe ullinj,hardhi,kam edhe një serë të vogël me perime. Të ardhurat që fitova në kurbet investova në tokën time.Për ullishten më ndihmoj edhe qeveria duke subvesticionuar.,- mbyll bisedën fshatari nga fshati Kuç i Beratit.

Poliçani- qyteti nën Tomorr

Lëm pas qytetin e Beratit e nisemi drejt Skraparit. Ora po shkonte 12. e drekës e autobisi ndaloi në qytetin e Poliçanit. Në stacion së bashku me udhëtarët e tjerë zbrita edhe unë për në Poliçan. Kisha rreth gjatë vite pa shkelur në ato anë. Gjatë udhëtimit, vështroja tokat e kodrat për gjatë luginës së Osumit. Dora e njerëzve bujarë e punëdashës ja kishin ringjallur fytyrën me një pamje krejt të re natyrës. Pas asaj ‘’furtune shkatërrimi’’ të tranzicionit, sot më 2014 ke një pamje krejt tjetër e natyra të buzëqesh me gjithë njerëzit që jetojnë në ato anë. Një re e bardhë atje mbi malin e tomorrit dukej sikur ju thoshte njerzëve mirseardhjen në qytetin e vogël të Poliçanit. Jeta në këtë qytet malor ka filluar të gjallërohet. Vizitori apo udhëtari e prek sapo shkel në qëndër të qytetit. Qëndra e qytetit është zbukuruar e të josh me bukurinë e tij. Qytetarët shprehen të kënaqur nga puna e bashkisë së këtij qyteti. Lulishtet me ambjentet shplodhëse, ndriçimi e shatërvani, lokalet e zbukuruara me gurët e tomorrit, sheshi i transformuar tërësisht me fondet e kësaj bashkie, të ftojnë për ta vizituar qytetin që ngrihet nën malin e Tomorrit. Edhe objektet socialkulturore janë transformuar krejt e kanë marrë fytyrë të re. Punonjësja e bibliotekës së qytetit Sanie Avdiasi shprehet e entuziazmuar se po rritet interesi i njerëzve i të gjithë grupmoshave që lexojnë librin. Janë 275 kartela të hapura, ku pjesa më e madhe janë të rinjë e të reja. Bashkia e Qytetit të Poliçanit me drejtues z. Adriatik Zotka, po bëjnë ç’mos që të akumulojnë një font nga kjo bashki për zgjerimin e bibliotekës së qytetit të Poliçanit. Z. Adriatik Zotka është një djalë energjik e puntor, i cili nuk i zhgënjen zgjedhësit e vet- na thotë në bisedë e sipër një vajzë e re Klementia Zeqo, banore e këtij qyteti. Të rinjtë e këtij qyteti e duan me shpirt profesionin e punën. Këtë vit u hap edhe shkolla profesionale në këtë qytet.

Në lokalin ‘’Zaloshnja’’ pimë një kafe. Na tërhoqi ky emërtim i lokalit. Prezantohemi me ‘’pronarin’’ Rrapo Çela që punonte së bashku me të shoqen në atë lokal që e kanë marrë me qera. Ata kanë prej vitesh që banojnë në këtë qytet, pra që nga krijimi i tij. – Kam ardhur fare i ri, na thotë Rrapua. Këtu edhe u martova. Por, aty në lokal takoj edhe bashkëfshatarin e Rrapos, Ylli Shimi, elektriçistin nga fshati Zaloshnje që i cili është në pension.Ai ka punuar 44 vite në këtë profesion. Biseda jonë rrjedh si burimet e vendlindjes. Kujtojmë me nostalgji të djeshmen e flasim për të sotme. Rrapua na flet edhe për historinë e LANÇ. Shtëpia muze që ka lënë në fshatin Zaloshnje , dëshmon për historinë tonë, e si e tillë pas asaj ogurzezës që e dogji dhe e shkatërroj mbas viteve ’90 duhet të ringrihet në këtë 70 vjetor të

çlirimit të atdheut nga nazifashistët,- na thotë Rrapua. Thinjat e bardha mbi kokë dukeshin si retë atje mbi malin e tomorrit. Fëmijët vraponin të gëzuar në këtë shtator 2014 drejt tempullit të dijes .Kurese zemrat mbillnin bardhësi si gurët e bardhë të tomorrit së bashku me mikpritjen miqësore e njerëzore..

...Drejt qytetit Çorovodë,"gushpëllumbit"mes dy degëve të lumit Osum.

Eshtë dita e dytë, 19 shtator. Largohemi nga Poliçani e marrim udhën drejt qytetit Çorovodë. Rruga është asfaltuar e gjarpëron anës lumit Osum. Nga të dyja anët e lumit shtrihen fshatrat që duken si foleza dallandyshe mes tokave e brezareve të mbjella me pemë frutore. Të bije në sy ullishtet e vreshtaria që është ringrituar mbi kataurën e viteve që lam pas të trazirave. Njerëzit skraparas janë puntorë e bujarë. Ata dinë të ndërtojnë jetën e tyre edhe në maj shkëmbi. Të larguarit drejt qyteteve të mëdha, apo edhe në emigracion si në Greqi e Itali,po rekthehen drejt vendlindje duke investuar .Ata kanë ngritur e ngrejnë shtëpi të reja, investojnë në tokat e tyre, në blegtori, pemtore e agroturizëm etj.

Kadri Xhaxho është nga fshati Slatinjë e Skraparit. Prej vitesh jeton e punon në qytetin e Memaliaj. Ai ka mall për Slatinjën, ndaj shkon shpesh atje te vendlindja. I është rikthyer punës edhe në atë fshat që ndodhet afër Tëndës së Qypit. Që andej Çorovada duket si një oaz mes dy degëve të lumit Osum. Kadriu me fëmijët që tani janë të rritur po rikthejnë syt edhe nga fshat i lindjes. Me vëllain e Kadriut që e quajnë Shefqet Xhaxho, jam njohur prej vitesh aty nga viti 1979, që i cili punonte në atë kohë si zooveterineri në ish kooperativën e Zhepës në tomorrocë, sqarove Kadriun gjatë bisedës . Një djalë që e donte profesionin e punonte me përkushtim. Udhëtojmë në vite e sjellim kijtime në bisedën tonë aty në autobus me Kadriun. Aty u njohëm me atë burrë fisnik. Kjo qe për ne një rastësi. Nuk thonë kot se rastësia sjell të papritura në jetë. Në vitin 2000 Shefqeti shkon në Itali, - na thotë Kadriu. Biseda s'ka të ndaluar, ku malli për vendlindjen tonë Skrapar flitet me dashuri të madhe. Dhe pa u ndjerë autobisi ndalon në stacionin e qytetit Çorovodë.

Banorët e vjetër e të rinj të qytetit Çorovodë iu janë kthyer punës. Ndërtimet e reja, lulishtet në qëndër, restorantet e zbukuruara nga guri i malit Tomorr, restaurimi i shkallëve të gurta, varrezat e dëshmorëve , lapidarët e dëshmorëve, rruga e asfaltuar anës kanioneve që të çon në Hambull etj, janë dëshmi e vlerësimit të së djeshmes, por edhe për një jetë më të mirë për të nesrmen. Njerëzit Skraparas dinë të presin e përcjellin me zemër të hapur edhe miq ngado qofshin ata. Para disa kohësh në qytetin e vogël mes malesh, në kanionet e lumit Osum, ishte si vizitor edhe ambasadori amerikan Arvizu. Rruga që do lidhi Skraparin me Përmetin është një tjetër mundësi zhvillimi e përparimi për atë krahinë e gjithë Skraparin.

Pamje nga qyteti Poliçan,shtator 2014

...Drejt qytetit Çorovodë,"gushpëllumbit"mes dy degëve të lumit Osum.

Eshtë dita e dytë, 19 shtator. Largohemi nga Poliçani e marrim udhën drejt qytetit Çorovodë. Rruga është asfaltuar e gjarpëron anës lumit Osum. Nga të dyja anët e lumit shtrihen fshatrat që duken si foleza dallandyshe mes tokave e brezareve të mbjella me pemë frutore. Të bije në sy ullishtet e vreshtaria që është ringrituar mbi kataurën e viteve që lam pas të trazirave. Njerëzit skraparas janë puntorë e bujarë. Ata dinë të ndërtojnë jetën e tyre edhe në maj shkëmbi. Të larguarit drejt qyteteve të mëdha, apo edhe në emigracion si në Greqi e Itali,po rekthehen drejt vendlindje duke investuar .Ata kanë ngritur e ngrejnë shtëpi të reja, investojnë në tokat e tyre, në blegtori, pemtore e agroturizëm etj.

Kadri Xhaxho është nga fshati Slatinjë e Skraparit. Prej vitesh jeton e punon në qytetin e Memaliaj. Ai ka mall për Slatinjën, ndaj shkon shpesh atje te vendlindja. I është rikthyer punës edhe në atë fshat që ndodhet afër Tëndës së Qypit. Që andej Çorovada duket si një oaz mes dy degëve të lumit Osum. Kadriu me fëmijët që tani janë të rritur po rikthejnë syt edhe nga fshat i lindjes. Me vëllain e Kadriut që e quajnë Shefqet Xhaxho, jam njohur prej vitesh aty nga viti 1979, që i cili punonte në atë kohë si zooveterineri në ish kooperativën e Zhepës në tomorrocë, sqarove Kadriun gjatë bisedës . Një djalë që e donte profesionin e punonte me përkushtim. Udhëtojmë në vite e sjellim kijtime në bisedën tonë aty në autobus me Kadriun. Aty u njohëm me atë burrë fisnik. Kjo qe për ne një rastësi. Nuk thonë kot se rastësia sjell të papritura në jetë. Në vitin 2000 Shefqeti shkon në Itali, - na thotë Kadriu. Biseda s'ka të ndaluar, ku malli për vendlindjen tonë Skrapar flitet me dashuri të madhe. Dhe pa u ndjerë autobisi ndalon në stacionin e qytetit Çorovodë.

Pamje e pjesshme nga qyteti Çorovodë

Banorët e vjetër e të rinj të qytetit Çorovodë iu janë kthyer punës. Ndërtimet e reja, lulishtet në qëndër, restorantet e zbukuruara nga guri i malit Tomorr, restaurimi i shkallëve të gurta, varrezat e

dëshmorëve , lapidarët e dëshmorëve, rruga e asfaltuar anës kanioneve që të çon në Hambull etj, janë dëshmi e vlerësimit të së djeshmes, por edhe për një jetë më të mirë për të nesrmen. Njerëzit Skraparas dinë të presin e përcjellin me zemër të hapur edhe miq ngado qofshin ata. Para disa kohësh në qytetin e vogël mes malesh, në kanionet e lumit Osum, ishte si vizitor edhe ambasadori amerikan Arvizu. Rruga që do lidhi Skraparin me Përmetin është një tjetër mundësi zhvillimi e përparimi për atë krahinë e gjithë Skraparin.

Leskova, fshati verilindor i tomorricës

Me fuouristradën e Valit një djalë energjik dhe një shofer i zoti në timon, morëm rrugën për në zonën e Tomorricës.Ora ishte 14. Makina mori rrugën drejt Qafës së Dëvrisë. Rruga vende-vende ishte e prishur. – Mos u mërzitni na thotë Vali se pas pak dalim në Dëvri. Mermeri i bardhë të vriste sytë nga shkëlqimi.Gurët e gëdhendur shtriheshin në një fushë alpine në atë grykë të çarë mes dy maleve.Po mendoja se pse kjo neglizhencë e qeverisë dhe firma që punon e shfrytëzon malin, pasurin e të gjthëve që fitimi është marramendës, dhe rruga që lidh Bashkinë e Çorovodës me zonën e Tomorricës është katandisur si mos më keq! Kush e fsjin për këtë!?

Foto:Xh.Cirongu

(***Pamje e pjesshme e Fushës së Leskovës)***

Qafa e Dëvrisë është porta e vetme që lidh me rrugë automobilistike atë zonë me 40 fshatra.Kjo rrugë e të tjera shërbime sociale i ka larguar nga fshati,shumë banorë të zonës sonë , na thotë me një keqardhje malli Dilaver Gjata banor i fshatit Rromas. Ndërsa makina lë pas Qafën e Dëvririt, para syve na shfaqet tomorrica me fshatrat e saj të boshatisura. Ata pak banorë që jetojnë aty mundohen t'i japin jetë e frymarrje si dikur.Pas një orë e gjysëm rrugë, mbrijmë në fshatin Gjerbës.Në një lokal u ulëm për të pirë një kafe e të shplodheshim nga ajo rrugë e vështirë udhëtimi. Nxjerr aparatin e bëj një foto kujtimi nga Tomorrica me ata njerëz bujarë e puntorë, por edhe dashamirës ndaj miqëve që dinë ta respektojnë kur vijnë në vatrat e

tyre.Aurel Merko flet për blegtorinë ku së bashku me vëllezrit atje në Gurrazes ka mbi 200 kokë bagëti të imta. Vështron nga mali Koshnicë, dhe thotë se në Çorovaodë mora gjylpëra për të luftuar sëmundjen ''Gjuha blu'' të deleve.

..Një kafe në Gjerbës...

Një sëmundje që po bën kërdinë te të imtat,- e pason bisedën Nias Shabani nga Leskova. Në bisedën që zhvillohet rreth tavolinës në atë lokal, flasin të gjithë me radhë,Dilaver Gjata,Sajmir Spahiu,Valter Binjaku,Klajdi Ahmeti e Skënder Ahmeti.Disa djem e vajza nga tomorrica vazhdojnë gjimnazin ''Ramiz Aranitasi'' në qytetin Çorovodë. Dikur në Tomoricë ishin 4 shkolla të mesme. Sot as që bëhet fjalë, se edhe shkollat 9 vjeçare janë drejt mbylljes. Thanasi është nga Leskova dhe me disa vajza e djem të tjerë vazhdojnë arsimin e mesëm gjer në Çorovodë, mbi 50 km rrugë që përshkrohet duke kaluar lumin e tomorricës e Qafën e Dëvrisë rrëzë malit shkëmbor të Zaloshnjes për të zbritur gjer në qytet. Rrugë malore që të vështirëson rrugëtimin në diell e aq më shumë në muajtë e dimrit. Që nga Gjerbësi fshat Leskovë duket si në pëllëmbë të dorës atje përtej lumit në anën tjetër të tomorricës. Fshati është i mbuluar nga pemët e shumta e duket si një pyll.Aty –këtu dallon shtëpit e rindërtuara nga banorët që jetojnë atje, apo ka nga ata që janë kthyer nga qytetet ku kanë shkuar para disa vitesh e kanë rindërtuar apo mermertuar shtëpitë e tyre. Lëmë Gjerbësin e zbresim në lumin e Tomorricës.Aty na gëzon fakti se diçka po bëhet duke ndërtuar urën mbi atë lum. Nga urë këmbësore ajo është ndërtuar e përfunduar për kalimin e makinave.Komuna Gjerbës, e ka riparuar rrugën gjer te ajo urë e makina jonë ecte për mbrekulli. Ky fakt më gëzoi shumë, sepse rruga do kalonte drejt Qafës së Mejdanit që del në fund të fshatit Leskovë, dhe ura tjetër që do ndërtohej mbi përroin e këtij fshati do lidhej me rrugën ekzistuese që del në fshatin Çerricë e Zhepë. Më pas drejt Leskovës e Gurrazes.

Në orën 17 mbrijmë në Qafën e Obruzit. Që aty tomorrica duket si në pëllëmbë të dorës. Por shikimi tretet gjer në Sulovë e Dumre. Dielli po kërkonte të fshihej mbrapa malit Tomorr. Dalngadalë po afrohej mbrëmja e po binte muzgu mbi fshat. Në fshat qëndruam disa ditë për të shuar mallin tonë. Takuam bashkëfsahatarët e të afrimit atje.Kujtime e lot malli.Me Abdyl Shabanin shkuam edhe fushës së fshatit që ishte mbjellë cep më cep., por u ngjitëm edhe deri në mal te stanet e bagëtive. Takojmë blegtorin Remzi Koçiun nga Zereci i Korçës së bashku me të atin Bardhylin që kishin 160 kokë dele në mal.Por edhe bariun e tufës së deleve Albert Cirongu nga Leskova, një djalë i ri, që do punën e arsimin, i cili vazhdonte gjimnazin. Aty në mal bëmë edhe foto me këta njerëz sa puntorë e bujarë.Por një kafe pimë te xha Serveti (hëngrëm edhe drekën), Shefqet Cirongu, Estref e Hajrie Dorrozhani, që të dy pensionist intelektualë që ringritën shtëpinë e rrënuar e frekuentojnë për disa muaj fshatin. Ata jetojnë e banojnë në Tiranë, por ja si ndahen edhe fshatit që afron qetësi, klimë e ujë si kristali. Atje në arat e mbjella me plot bereqet, takojmë Arshinin, Çelniken,Stefanin e Bitijen që kishte ardhur nga Durrësi enkas për disa ditë në fshatin e lindjes Leskovë. Por edhe Sulltana Shatro e Dalipin që s'u ndahen punëve të shumta të fshatit. Edhe Luftëtari me vëllezrit që kanë vite që punojnë e jetojnë në Itali, e kanë riparuar shtëpinë atje në Leskovë. Aty ka investuar edhe Dragoj që jeton me gjithë familje në qytetin e Vlorës.Nga afro 200 familje sot atje janë rreth 20 të tilla.Nga Tirana, Çorovada, Korça, Durrësi Lushnja, etj po rikthehen te vendlindja atje te fshati verilindor në Leskovën e Tomorricës së Skraparit, po ringrejnë shtëpitë, foletë ku kanë lindur e jetuar të parët tanë, ku kemi lindur e rritur të gjthë ne, që koha na degnisi gjithandej. Edhe në kohë të vështira Leskovarët kanë ditur të punojnë e të arsimohen. Në këto kohë të vështira trenzicioni krahës punës edhe janë arsimuar. Janë me dhjetra djem e vajza që kanë mbaruar arsimin e lartë në gjithë fushat e shkencës. Punën e arsimin e kanë në gjak. Fshati Leskovë ka nxjerrë mjaft kuadro të aftë që kanë shërbyer e shërbejnë në shumë fusha të shkencë e të jetës.Kryeplaku Hajdar Cirongu na flet me entuziazmë për tradita e shkëlqyera që kanë patur e kanë për punën, arsim e kulturë në breza Leskovasorët. Por…edhe takime me të tjerë bashkëfshatarë që shova sado pak atë mall për vendlindjen, për njerëzit, gurët e burimet e fshatit.

Pas disa ditësh kthehemi nga Leskova drejt Durrësit me makinën fuoristradë të Rizait që bën rrugën nga Zhepa – Gramsh. Në makinën e Rizait ishte edhe Selam Shatro e Qetsor Cirongu. Mbi katër orë rrugëtim duke kaluar nëpër fshatrat: Leskovë, Zhepë, Gurrazes, Corrotat, Burranj, Siman Vidhan, Ermenj, Skënderbegas, Nartë, Shëmrizë, e së fundmi në qytetin buzë devollit në Gramsh. Që andej drejt Durrësi udhëtuam me makinën e Lefter Veçani që banon në qytetin bregdetar të Durrësit.

Shofer Rizai po na rrëfente disa lajme të gëzueshme, sepse rruga Gramsh- Tomorricë që do kalojë nga Qafa e Sqaponjës e do zbresi në lumin e Tomorricës, po projektohet nga qeveria e ''Rilindjes'' që më së fundi edhe timorricarët të bëhen me rrugë nacionale.Edhe mali i Tomorrit kur të shohë tomorricarët që do të udhëtojnë lirshëm drejt qyteteve Çorovodë, Gramsh, Berat e Elbasan, do lartsohet më shumë ai mal,duke u dhënë bekimin e zotit atyre që mendojnë për njrëzit puntorë, bujarë e atdhetarë skraparas e tomorricarë.

Xha Fetau e Minekua na përcjell deri te pragu shtëpisë duke na thënë se i mirëpresim të gjithë nipa e mbesa kudo qofshin ata në Leskovën e mikpritjes bujare.Ndërsa dielli na buzëqeshte atje në qiellin tomorrian.

Foto pejsazh nga vendlindja Skrapar…..

..Atje pranë burimeve me ujë të kulluar!

Mikpritje bujare Skraparase. Në shtëpinë e xha Feta Shabani-Leskovë.

Në foto me Remzi Koçiasi nga Zereci i Korrçës në malin e Leskovës, shtator 2014.

Në foto Abdyl Shabani@Albert Cirongu,shtator 2014.

Skrapar, Leskovë 22 shtator 2014.

Shqiponja e Bargullasit nënë Azbije Xhamallati mbeti në histori

Të shkruash pak rreshta për Azbije Xhamallati duhet të mendohesh mirë, sepse ajo edhe pse ka vite që është larguar nga jeta, ka se çfar të na thotë edhe sot e kësaj dite. Ditari i sajë i jetës është i mbushur plot me ngjarje e sakrifica që na rrëfen jo vetëm të djeshmen heroike, por edhe me sublimet e kalvarit jetësor , që ajo nënë na i ka lënë të shkruara në zemrat tona kur ne e kujtojmë pas kaq vitesh .

Vështroj rreth viteve që kanë shkuar të cilat rrinë si kurorë tufa manushaqe në kaltërsinë tomorriane atje mbi fshatin e lindjes të asaj nëne fisnike, në Bargullasin e bilbilave të këngës, e më duket sikur bisedoj akoma me nënë Azbije.Le të treten vitet si bora e malit Tomorr. Ajo nënë shqiponjë ''fluturon'' drejt qiellit e s' ndalet ,sepse gjurmët e mirësive që ka lënë ajo udhëtojnë e s'ndalen sot e në brezat që do vijnë.

Megjithatë, ne kthehemi mbrapsht në vite.

Nënë Azbije Rakip Xhamallati ka lindur në vitin 1908 në fshatin e gurëve të bardhë Bargullas të rrethit Skrapar. Ajo jetoi deri në vitin 1991. Historia e asaj nëne ishte plot heroizma e sakrifica. Kurrë nuk ju tremb vështirësive të jetës. Me guxim e trimëri përballoi rrugëtimin e kohës së vetë që ishte me shtigje të panjohura. Guximin e kishte prej luaneshë mali, sepse guximin ia jepte mali i bekuar Tomorri. Kush e ka njohur nga afër atë nënë e si tha këto fjalë që të frymëzonin e të jepnin kurajo të ecje drejtë rrugëve të panjohura të jetës. Nënë Azbija rrjedh nga një familje patriotike e atdhetare. Kontributi që ka dhënë familja e të afrmit gjatë LANÇ është e madhe , saqë vëllai i saj Avni Kondi ra heroikisht në çlirimin e Tiranës më 11 nëntor të vitit 1944. Gjaku i Avni Kondi u bë lule maji së bashku me 28 mijë dëshmorët e tjerë që mbetën të përjetshëm në altarin e lirisë së atdheut. Edhe Azbija mori pjesë aktive për çlirimin e atdheut nga nazifashistët. Ajo u aktivizua qysh në tetor të vitit 1942 në luftën nacionalçlirimtare. Ishte anëtare e parë e Këshillit Antifashist të Gruas, e cila luftoi me trimëri deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Kështu, duke qënë një luftëtare e zonja, gjatë luftës zgjidhet Anëtare e Këshillit Anfifashist të Gruas për Nahien e Beratit, duke kryerë detyrën e informatores në një mosh të re. Azbija ishte antare e partiës komuniste shqiptare. Në detyrat e saj ishte korrekte, por edhe dashamirëse ndaj njerëzve ku ajo punonte e vepronte si veprimtare e shquar në shoqëri. Ishte një vajzë me vizione të qarta përparimtare për të cilën edhe luftoi krahë për krah djemëve e vajzave shqiptare , jo vetëm gjatë luftës, por edhe mbas çlirimit të vendit.

Ajo merr pjesë në Kongresin e Parë të LANÇ të Gruas, e cila përfaqësonte krahinën e Nahijes si delegate në këtë kongres. Fjala e saj në atë kongres, ngriti peshë zemrat e vajzave e grave që kishin ardhur në Berat nga gjithë qytetet e fshatrat e shqipërisë. Mbas çlirimit nënë Azbija iu përvesh punës për ndërtimin e vendit që u dogj e u shkatërrua nga lufta. Në fshatin Bargullas zgjidhet kryetare e organizatës së gruas . Ajo dinte të organizonte, por edhe me fjalën e ngrohtë i bënte për vete të tjerët në luftën kundër analfabetizmit duke organizuar kurse në shtëpinë e saj. Për aktivitetin e punën e palodhur që bënte Azbija, zgjidhet edhe si Anëtare e Kryesisë së Gruas të rrethit Berat, por edhe anëtare e Komitetit Ekzekutiv të po këtij rrethi. Duke parë në kohë të ndryshme, si gjatë aktivitetit në luftën për çlirimin e vendit dhe mbas në ndërtimin e tij, nënë Azbije Xhamallati është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me medalje të luftës e të punës. Po kështu edhe si militante e denjë e aktiviste e palodhur, si veterane që mbrojti deri në vdekje vlerat e LANÇ. Si e tillë ajo do mbetet një shembull frymëzimi për të gjithë brezat, e sidomos për bashkëfshatarët që i deshi dhe e respektonin aq shumë fjalëmblën nënë Azbije.

Në gjurmët e nënës ecën edhe djali i saj i vetëm Bardhi Xhamallati. Me modestinë që e karakterizon dhe edukatën që ka marrë në familje, Bardhi ka punuar me devotshmëri për gjithë jetën në çdo front pune. Ai ka punuar në kombinatin ushtarak të Poliçanit me profesionin mekanik. Në punë ai dallohej për disiplinë e ndërgjegje, i dashur në shoqëri. Sot është në pension pleqërie. Por si pasardhës i LANÇ është aktivizuar në Organizatën e Veteranëve. Në fillim në qytetin e Poliçanit, ku zgjidhet edhe kryetar i organizatës së veteranëve (organizatës nr. 2). Ai është zgjedhur edhe në kryesinë e degës së Organizatës Kombëtare për dëshmorët e LANÇ të qytetit Poliçan. Sot Bardhi është me banim në qytetin bregdetar të Durrësit me gjithë familje. Por edhe këtu ai është aktivizuar në organizatën e veteranëve të LANÇ të këtij qyteti, ku dallohet si aktivist e merr pjesë në aktivitete e ndryshme që organizon kjo shoqatë për të mbajtur gjallë vlerat e luftës së Dytë Botërore e të LANÇ.

Në një dokument lexojmë se: ''Azbije Xhamallati nga fshati Bargullas të rrethit Skrapar, sipas dokumentave arkivore në Muzeun e rrethit, në Historikun e fshatit Bargullas në faqen 73 thuhet: ''Azbije Xhamallati është Anëtare e Këshillit Antifashist të Gruas dhe anëntare e Këshillit krahinor të gruas që Nahijen e Beratit nga marësi I vitit 1943 deri në 1944. Aktiviste e shquar dhe organizatore në ndihmë të luftës antifashiste me grat e tjera të Nahijes në Berat deri në çlirimin e vëndit", (Drejtori Nuri Çuni). Nëntor 1944, nëntor 2014!

Në këtë jubile të 70 vjetorit të çlirimit të Shqipërisë do kujtohet me respekt edhe shqiponja e Nahijes së Beratit, nënë Azbije Xhamallati që mbeti në histori simbol frymëzimi dhe edukimi patriotik për sot e breziat e ardhshëm. Me guxim e sakrifica ajo bëri emër në histori.

Tetor, 2014.

Nafie Bregu shqiponja e Tomorrit

(Kushtuar dëshmores Nafie Bregu (Bako)



Jeta e përditshme plot vuajtje dhe bota që e rrethonte,
shtronin përpara Nafies 20 vjeçare mjaft pyetje për realitetin e zymtë të asaj kohe .
Përgjigjen e këtyre pyetjeve ajo filloi ta gjente në bisedat e ngrohta të partizanëve që
vinin shpesh në shtëpinë e saj . Në fjalën e tyre gjente shpjegimet
dhe qëllimet e larta të luftës për çlirimin e Atdheut . Dëshmorja Nafije Bregu ,(Bako)
lindi në fshatin Burranj të tomorricës së rrethit Skrapar në vitin 1922. I ati i saj Demiri,
një pjesë të jetës i kaloi duke punuar në Kuçovë, atje në mes puntorëve të naftës . Por edhe në
gjolin e Maliqit, Qaf Kërrabë, në Durrës etj. Aty njohu thellë vuajtjet dhe mjerimin e puntorëve
e preknin në shpirt fjalët e babait kur fliste për varfërinë, por
edhe urrejtje për pushtuesit nazifashist. Të nesërmen , kur dëgjonte këto fjalë bisede nga i ati ,
i përhapte në rrethin e shoqeve dhe moshatarëve të saj . Nafia ishte e zgjuar ,
por edhe e shkathët e puntore. Duke shkelur mbi zakonet patriarkale të kohës , lëronte arën ,
mbillte misër, ujiste bimët për të siguruar për pakë kohë bukën e familjes .
Fjalët e nënës e ngrohnin e i jepnin forca të reja . Nafije Bregu ishte e martuar në Rromas ,
në këtë fshat që shtrihet aty rrëzë Tomorrit .
Ajo ishte dhe mbeti në histori,si një shqiponjë në hapsirën e qiellit kaltërosh Tomorrian.
Kur gjëmonte lufta në male, ajo u bë veprimtare e kësaj lufte .
Me formimin e Këshillave Antifashiste Nacionalçlirimtare,
Nafija u bë veprimtare e palodhur në masën e grave dhe të vajzave në fshatrat e zonës .
Shumë shpejtë ra në sy veprimtaria e saj në qarqet armiqësore .
Për ta, ajo u bë një persone e pa dëshirueshme .
Në ditët e para të janarit shtabi i Grupit partizan të Myzeqes bëri një mbledhje në shtëpinë

e saj. Kjo u diktua nga spiunët e bashkëpuntorët e fashizmit . Më 10 janar të vitit 1943 - ës , i rrethojnë shtëpinë . Kërkonin ta kapnin të gjallë . Ajo nuk u dorëzua .
Nafia tradhëtarëve u përgjigj më pushkë, kështu në pamundësi për ta kapur të gjallë , e vrasin . Nafija derdhi gjakun për të mbetur e gjallë. . Tradhtarët morën turpin me vete .
Historia do i dënojë për jetë. Kurse , populli u thur këngë trimave të vatanit;
atyre që sakrifikuanë edhe me jetë e tyre. Dhe ja, si thotë kënga për dëshmoren e perë grua të kësaj treve :

" Tradhëtarët të vranë
Bijë Tomorrice ,
Je dëshmore e parë
E kësaj krahine .....".

Nafie Bregu (Bako) derdhi gjakun për lirinë e Shqipërisë.Shqiponja e malit të Tomorit,kujtohet në këtë 70-vjetor të çlirimit të Skraparit dhe në 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarsisë,si një lule që rritet në shkëmb e që çel vetëm petale të kuqe në përjetësinë e pavdekësisë.

Durrës, 31.08.2012

Tomorrica

(Monografi)

Këto ditë doli në qarkullim libri me titull: ''Tomorrica'' (monografi) me autor të Enver Cakaj. Libri u botua nga shtypshkronja ''Medaur'' Durrës. Përmbledhja monografike e këtij libri ka 522 faqe, të pasqyruarë

edhe me foto brënda tij. Autori ka bërë një punë të kujdesshme,duke qëmtuar nëpër arkiva dhe ka sjellë fakte të reja që lexuesi nuk është njohur më parë, por tani me botimin e kësaj monografie e ka më lehtë të gjejë vetëveten nëpër labirinthet e historisë. Tomorrica, si kryeqëndra e bashkimit të mendimit të shqiptarëve me emrin''Baba Tomorr'',shquhet për atdhedashuri. Edhe tomorricarët ,si gjithë shqiptarët shquhen për kontribute patriotike dhe vllazërore në çështjen tonë kombëtare. Janë të shumtë patriotë,luftëtarë, shkenctarë, shkrimtarë, njerëzit e thjeshtë të kësaj treve që kanë dhënë e japin kontributet e tyre në dobi të Atdheut tonë. Kur lexon librin,aty zbulon se nëpër shekuj Tomorricarët kanë dhënë kontribute të çmuara atdhetare e patriotike. Këto kontribute,lexuesi i gjenë lehtësishtë në faqet e këtij libri. Në trevën e Tomorricës kanë gjetur mikëpritjen dhe strehën e ngrohtë shqiptarët e të gjthave trevave,që nga veriu e jugu i Shqipërisë. Për nga vetë pozita gjeografike që shtrihet kjo trevë e Shqipërisë,historia e saj është e mbushur me plotë ngjarje që lexuesi do befasohet kur të ç'fjetojë fletët e këtij libri. Libëri monografik që botohet nga autori Enver Cakaj,është udhërrëfyes edhe për të tjerët që të shkruajn,sepse siç thotë ky autor''Historia e trevës së tomorricës nuk mbaron këtu me këtë monografi''. Për këtë punë të lodhshme e voluminoze që ka bërë autori, ai duhet përkëzuar që solli vlerat përmbledhëse nëpër shekuj të Tomorricarëve dhe kontributet e tyre në monografinë që lexuesit kanë në dorë tashmë librin e botuar. Ky libër është i 17-ti që ka botuar autori në serinë e botimeve të veta.

Durrës,31.05.2012

FUND, 2018

Pasqyre e lëndës

faqe

1. Hurje…….
2. ‘’Drenica e Durrësit’’,- djepi I histories dhe lirisë së kosovës……..
3. Njeriu që udhëton drejt shekullit……
4. Doktor Ilir Shani- duararti që sfidin sëmundjet…….
5. Poet I vargut që ndriçon si gur Xhevahiri……..
6. Historia e djeshme, sot udhërrëfyese për zhvillim e përparim ……
7. Atje ku ëndrrat zgjohen me nektarin e vendlindjes……..
8. Krijuesit kudo ndodhur në gjithë globin janë të parët
   që mbjellin në zemrat e njerëzve dashurijete……
9. Lulja e lirisë me rrënjë tek gjaku i dëshmorëve të atdheut……
10. Mesazhi i jetës dhe veprës Sokratike në përjetimin tim……..
11. Petrit Bako, djali nga Burranj që kapërceu oqeanin atlantik……..
12. Djali i Zhepovës, Agron Dragoj mbeti një dragua
    në pavdekësinë e historisë…….
13. Piktori Nuri Jaupllari- mjeshtër i penelit dhe i ngjyrave jetësore……
14. Asllan Refati (Zylyftari – një jetë mbi medalionin e fjalës ……..
15. O moj shqipe që na linde, nga ty mos u ndafsha kurrë……..
16. Një kafe me pedagog Astritin……..
17. ‘’Drenica’’ e Durrësit dhe 15 vjetori I çlirimit të kosovës……..
18. Tomorr Tora- drugdhendësi nga Mokra……
19. Ggazeta ‘’Muzgu’’ një yll polar e fjalës letrare shqipe……
20. Malet e Skraparit pëllumbat e paqes…….
21. Guri e fjala përjetësisht në rrugën e historisë……..
22. Jehona e këngës Skraparase vallzon me kaltërsinë e valëve
    adriatikase në qytetin e Durrësit……
23. Burrat e kombit flakërojnë nëpër histori…….
24. Udhëtim nëpër vargun kryeneç të poetit Adem Zaplluzha…….
25. Njeriu Legjend……
26. E djeshmja sot na bën edhe më krenarë…….
27. Nëpër udhëkryqet e historisë mbetën gurë diamantësh……
28. Atje mes piktorëve të vegjël Durrësakë……
29. Monografia ‘’Lulëkuqet e Kastriotit’’ udhërrëfyese e fjalës së shkruar
    me pika gjaku……..
30. Kuvendim me diellin e vendlindjes Shqipëri…….
31. Nga qielli pikonin diamante liodhimbje……

32. Kush vdes për atdhe, s'ka vdekje kurrë……
33. Gurë stralli Shqipëria, mbirë në buzë te ty liria……..
34. Atje ku jeta ël si lule shkëmbi mes malesh skraparase……
35. Shqiponja e Bargullasit nënë Azbije Xhamallati mbeti në histori……..
36. Nafie Bregu s hqiponja e tomorrit……
37. Tomorrica (Monografi)……..
38. Fotogaleri……

CIP Katalogim në botim BK Tiranë

Cirongu, Xhevahir
Tomorri, qiell perëndie/ Xhevahir Cirongu: rend.

Skënder Kapiti, -Durrës: Jozef, 2018

242 f. : me foto: 14,5 x 21 cm

1. Letërsia shqipe. 2. Reportazhe. 3. Shkrime.
Korospondenca për shtypin.

821.18- 92

242

FOTO GALERI

- Tomorri qiell perëndie -